




# Strategjia për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkinë Lezhë

Nëntor, 2020





# Strategjia për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkinë Lezhë

Nëntor, 2020

### **Autorë, MetroPOLIS Sh.p.k & Co-Plan**

Dritan Shtina, Expert Institucional dhe Qeverisje

Rudina Toto, Drejtues Projekti

Ledio Allkja, Ekspert Planifikim Territori

Kejt Dhrami, Eksperte Planifikim Territori

Imeldi Sokoli, Ekspert Planifikim Territori

Merita Toska, Ekspert Zhvillimi Ekonomik dhe Financa

Edlira Xhafaj, Ekspert GIS

Gerti Delli, Ekspert GIS

Rodion Gjoka, Ekspert Mjedis

Merita Guri, Ekspert Inxhinier Ndërtimi (Universiteti POLIS)

Endri Duro, Ekspert Inxhinier Ndërtimi (Universiteti POLIS)

Skënder Allkja, Ekspert Gjeologji dhe Hidro-gjeologji (A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000)

Shyqyri Aliaj, Ekspert Sizmiolog (A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000)

### **Kontribues**

Pjerin Ndreu, Kryetar *Bashkia Lezhë*

Ermal Pacaj, Nën-kryetar *Bashkia Lezhë*

Bardhyl Kaçorri, Drejtor *Emergjencat Civile*

### **PNUD**

Vladimir Malkaj, Specialist Programi- Qeverisja Demokratike, UNDP

Maksimiljan Dhima, Ekspert i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile

Jak Gjini, Ekspert Lokal

*Strategjia për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkinë Lezhë është porositur nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), dhe përgatitur nga Co-PLAN-Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Pikëpamjet e shprehura në raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të PNUD, apo partnerëve të saj.*

# PËRMBAJTJA

<b>1.</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
<b>2.</b>	<b>BAZA LIGJORE</b> .....	<b>12</b>
	2.1 Ligjet sektoriale.....	17
<b>3.</b>	<b>DOKUMENTE STRATEGJIKE DHE STUDIME TË MËPARSHME</b> .....	<b>24</b>
	3.1 Dokumente Strategjike në Nivel Kombëtar.....	25
	3.2 Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Lezhë .....	29
	3.3 Plane të mëparshme Emergjencash.....	30
	3.4 Studime në Bashkinë Lezhë .....	31
<b>4.</b>	<b>VLERËSIMI I RREZIKUT DHE RISKUT NË BASHKINË LEZHË</b> .....	<b>35</b>
<b>5.</b>	<b>VIZIONI DHE OBJEKTIVAT</b> .....	<b>41</b>
	5.1 Objektivat dhe Masat për ZRF.....	46
	5.2 Masat dhe Veprimet për Jetësimin e Strategjisë .....	37
	5.3 Masat OS1- Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për ZRF.....	52
	5.4 Masat për OS2- Ngritja e kapaciteteve institucionale, qeverisëse për ZRF.....	54
	5.5 Masat për OS3- Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente .....	56
	5.6 Masat për OS4- Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente .....	65
<b>6.</b>	<b>ZHVILLIMI I SKENARËVE</b> .....	<b>66</b>
	6.1 Përmytjet.....	67
	6.2 Rreziqet meteorologjike .....	70
	6.3 Rreziqet gjeologjike .....	72
	6.4 Zjarri.....	75
	6.5 Sizmika.....	77
<b>7</b>	<b>MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË</b> .....	<b>80</b>
<b>8</b>	<b>REFERENCA</b> .....	<b>87</b>

## FIGURAT

<b>FIG 1</b>	Skema e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive .....	10
<b>FIG 2</b>	Struktura e Strategjisë.....	11
<b>FIG 3</b>	Rreziqet e Sistemit Urban .....	27
<b>FIG 4</b>	Sistemi Ujor dhe Rreziku i Përmbytjes.....	28
<b>FIG 5</b>	Vizioni i Bashkisë Lezhë .....	29
<b>FIG 6</b>	Vizioni Territorial.....	29
<b>FIG 7</b>	Vlerësimi bazuar në tregues .....	36
<b>FIG 8</b>	Metodologjia për Vlerësimin me shumë rreziqe .....	37
<b>FIG 9</b>	Konkluzione të analizës së cënueshmërisë sipas njësive administrative dhe rrezikut.....	38
<b>FIG 10</b>	Harta multi-rrezik në territor, ekspozimi dhe elementët e riskuar.....	39
<b>FIG 11</b>	Harta multirisk .....	40
<b>FIG 12</b>	Skenari 1 Përmbytjet–Nuk ndodh asgjë .....	67
<b>FIG 13</b>	Skenari 2 Përmbytjet– Ndërhyrje afatmesme- kosto e ulët.....	68
<b>FIG 14</b>	Skenari 3 Përmbytjet– Ndërhyrje afatgjatë – kosto e lartë.....	69
<b>FIG 15</b>	Skenari 1 Rreziqet meteorologjike – Nuk ndodh asgje.....	70
<b>FIG 16</b>	Skenari 2 Ndërhyrje afatmesme- kosto e ulët.....	71
<b>FIG 17</b>	Skenari 1 Rreziqet gjeologjike – Nuk ndodh asgjë.....	72
<b>FIG 18</b>	Skenari 2 Rreziqet gjeologjike - Ndërhyrje afatmesme- kosto e ulët.....	73
<b>FIG 19</b>	Skenari 3 Rreziqet gjeologjike - Ndërhyrje afatgjata – Kosto e lartë .....	74
<b>FIG 20</b>	Skenari 1 Rreziku nga zjarri – Nuk ndodh asgjë.....	75
<b>FIG 21</b>	Skenari 2 Rreziku nga zjarri – Ndërhyrje afatmesme – Kosto e ulët.....	76
<b>FIG 22</b>	Skenari 1 Rreziku sizmik – Nuk ndodh asgjë.....	77
<b>FIG 23</b>	Skenari 2 Rreziku sizmik – Ndërhyrje afatmesme – Kosto e ulët.....	78
<b>FIG 24</b>	Skenari 3 Rreziku sizmik – Ndërhyrje afatgjata – Kosto e lartë .....	79

## TABELAT

<b>Tabela 1</b>	Tabela finale e pikëzimit për secilin rrezik, nisur nga indikatorët dhe 4 komponentët e riskut ....	38
<b>Tabela 2</b>	Plani i Veprimit .....	42
<b>Tabela 3</b>	Rreziqet e Zbatimit të Strategjisë.....	46
<b>Tabela 4</b>	Indikatorët e Monitorimit .....	81
<b>Tabela 5</b>	Indikatorët për raportimin e kuadrit Sendai .....	84

## SHKURTESAT

AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (Albanian School of Public Administration)
BE	Bashkimi Evropian
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
GIS	Sistem Informimi Gjeografik (Geographic Information System)
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit
ITUN	Impiant i Trajtimin të Ujrave të Ndotura
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)
OS	Objektiv Strategjik
PDyV	Plan i Detyruar Vendor
PIK	Plani i Investimeve Kapitale
PINS	Plani i Integruar Ndërsektorial
PKEC	Plani Kombëtar i Emergjencave Civile
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PPEC&K	Planifikimi dhe Përbalimi i Emergjencave Civile dhe Krizave
PPKT	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
UNDRR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (United Nations Office for Disaster Risk Reduction)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VSM	Vlerësim Strategjik Mjedisor
ZRF	Zvogëlim i Riskut të Fatkeqësive
ZRZH	Zonë e Re për Zhvillim

# HYRJE

**Aftësia ripërtëritëse (Resilience) tashmë është kthyer në një koncept drejtues për politikëbërjen e lidhur me zhvillimin hapësinor dhe veçanërisht për sa i përket riskut të fatkeqësive.**

Koncepti i aftësisë ripërtëritëse ka evoluar në kohë dhe ka përkufizime të ndryshme, por një gjë e cila është konvergjente në të gjitha rastet është aftësia e një vendi, autoriteteve dhe sistemeve socio-ekologjike për t'u rimëkëmbur pas një krize (Davoudi, 2019). Në këtë sens, koncepti është gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional duke përfshirë jo vetëm rimëkëmbjen fizike në territor por edhe faktorë të shumtë socialë dhe ekologjikë. Aftësia ripërtëritëse dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kanë marrë një vemendje të rëndësishme në nivel global. Kjo gjë vërehet në prioritetet e Kuadrit Sendai, në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në Anxhendën e Re Urbane (UN Habitat, 2016) dhe Axhendën Urbane të Bashkimit Evropian (Informal Meeting of EU Ministers Responsible for Urban Matter, 2016). Të gjitha këto dokumente strategjike globale vendosin një theks të rëndësishëm dhe tek autoritetet vendore duke qënë se impakti më i madh i krizave është gjithmonë në nivel lokal.

Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030 u miratua në Konferencën e tretë Botërore të KB në Sendai, Japoni, më 18 Mars 2015. Kuadri Sendai artikulon nevojën për të kuptuar më mirë riskun e fatkeqësive në të gjitha dimensionet si ekspozimi, ndjeshmëria dhe karakteristikat e rrezikut. Gjithashtu advokon për forcimin e qeverisjes duke përfshirë platformat kombëtare si dhe rritjen e përgjegjësisë për menaxhimin e gatishmërinë për të «Ndërtuar më mirë» pas një fatkeqësie. Njohja e palëve të interesit dhe rolet e tyre është një faktor i rëndësishëm për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut. Kuadri Sendai i kërkon autoriteteve mobilizimin e investimeve të ndjeshme ndaj riskut për të shmangur krijimin e risqeve të reja si dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës shëndetësore, trashëgimisë kulturore dhe vendeve të punës. Gjithashtu, kërkon forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneritetit global, politikave dhe programeve të donatorëve të informuar për risqet duke përfshirë edhe mbështetjen financiare dhe huatë nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Kuadri SENDAI propozon disa parime bazë mbi të cilin zhvillohen politikat dhe strategjitë e ZRF:

- Secili shtet ka përgjegjësinë kryesore për të parandaluar dhe zvogëluar riskun e fatkeqësive, gjë e cila mund të arrihet edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal, nënrajonal, ndërkufitar dhe dypalësh. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është një shqetësim i përbashkët për të gjitha shtetet dhe shkalla në të cilën vendet në zhvillim janë në gjendje të zhvillojnë dhe zbatojnë në mënyrë efektive politikat dhe masat e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në kontekstin e rrethanave dhe aftësive të tyre përkatëse mund të përmirësohen më tej përmes sigurimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërkombëtar;
- Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kërkon që përgjegjësitë të ndahen nga qeveritë qendrore dhe autoritetet përkatëse, sektorët dhe palët e interesit, siç është e përshtatshme për kontekstet e tyre kombëtare dhe sistemet e qeverisjes;
- Menaxhimi i riskut të fatkeqësive ka për qëllim mbrojtjen e personave dhe pasurisë së tyre, shëndetit, mjeteve të jetesës, si dhe pasurive kulturore dhe mjedisore, duke promovuar dhe mbrojtur të gjitha të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën për zhvillim;

- Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kërkon një angazhim dhe partneritet të të gjithë shoqërisë. Ai gjithashtu kërkon fuqizim dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe jodiskriminuese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë njerëzve të prekur në mënyrë disproporcionale nga fatkeqësitë, veçanërisht më të varfërit. Një perspektivë gjinore, moshe, paaftësie dhe kulturore duhet të integrohet në të gjitha politikatat dhe praktikatat, ku udhëheqja e grave dhe të rinjve duhet të promovohet. Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të punës së organizuar vullnetare të qytetarëve;
- Zvogëlimi dhe menaxhimi i riskut të fatkeqësive varet nga mekanizmat e koordinimit brenda dhe ndërmjet sektorëve dhe me palët e interesuara në të gjitha nivelet. Kërkon angazhimin e plotë të të gjitha institucioneve shtetërore në nivelet kombëtare dhe lokale dhe një artikulum të qartë të përgjegjësive të publikut dhe aktorët privatë, përfshirë biznesin dhe akademinë, për të siguruar komunikim të ndërsjellë, partneritet, plotësim të roleve dhe përgjegjshmëri;
- Roli mundësues, udhëzues dhe koordinues i qeverive në nivel qendror është thelbësor, gjithashtu është e nevojshme të fuqizohen autoritetet dhe komunitetet vendore për të zvogëluar riskun e fatkeqësive, përfshirë përmes burimeve, stimulujve dhe përgjegjësive të vendimmarrjes, sipas rastit;
- Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kërkon një qasje me shumë rreziqe dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse të informuar mbi riskun bazuar në shkëmbimin e hapur dhe shpërndarjen e të dhënave të ndara, përfshirë sipas gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar, si dhe të jenë lehtësisht të arritshme, të azhurnuara, të kuptueshme. Gjithashtu, kjo duhet të përfshijë si informacion të bazuar në shkencë ashtu dhe atë lloj informacioni, të ndjeshëm ndaj riskut, të plotësuar me njohuri komunitare;
- Zhvillimi, forcimi dhe zbatimi i politikave, planeve, praktikave dhe mekanizmave përkatëse duhet të synojnë të krijojnë koherencë, midis zhvillimit të qëndrueshme, sigurisë ushqimore, kujdesit të shëndetit dhe sigurisë, ndryshimit të klimës, menaxhimit të mjedisit dhe risqeve të fatkeqësive. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është thelbësor për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm;
- Ndërsa faktorët kryesorë të riskut të fatkeqësive mund të jenë lokalë, kombëtarë, rajonalë ose globalë, risqet e fatkeqësive kanë karakteristika lokale dhe specifike që duhet të kuptohen për përcaktimin e masave për të zvogëluar riskun;
- Adresimi i faktorëve themelorë të riskut të fatkeqësive përmes investimeve publike dhe private të informuara për riskun është me kosto më efektive sesa mbështetja kryesore në reagimin dhe rimëkëmbjen pas fatkeqësisë dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm
- Në fazën e rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit pas fatkeqësisë, është thelbësore për të parandaluar krijimin dhe për të zvogëluar riskun duke "Ndërtuar më mirë" dhe duke rritur informimin publik dhe ndërgjegjësimin për riskun e fatkeqësive;
- Një partneritet global efektiv dhe kuptimplotë dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë përmbushjen e angazhimeve përkatëse të ndihmës të zhvillimit nga vendet e zhvilluara, janë thelbësore për menaxhimin efektiv të riskut të fatkeqësive.

Kuadri Sendai gjithashtu, propozon 4 prioritetet për të përkatësit ZRF:

**Prioriteti 1:** Kuptimi i riskut të fatkeqësisë

**Prioriteti 2:** Forcimi i qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të menaxhuar riskun


**Prioriteti 3:** Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për të rritur aftësinë ripërtëritëse dhe qëndrueshmërinë

**Prioriteti 4:** Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për reagim efektiv dhe për "Ndërtimi më mirë"



Një element tjetër shumë i rëndësishëm në përgatitjen e strategjive dhe politikave të ZRF është cikli i menaxhimit të fatkeqësive. Skema e mëposhtme, ofron një mënyrë të sintetizuar ciklin në të cilat kalojnë fatkeqësitë dhe mënyrat e ndryshme sesi ndërhyhet në secilën fazë:

FIG 1. Skema e Ciklit të Menaxhimit të Fatkeqësive



Burimi: Autorët

Kjo skemë është e rëndësishme përse i përket marrjes së masave nga ana e Bashkisë Lezhë, duke marrë në konsideratë nivelin e ulët të përgatitjes dhe aftësitë e bashkisë për tu përshtatur. Cikli i menaxhimit të fatkeqësive është shumë i rëndësishëm për rastin konkret të Bashkisë Lezhë. Në një kontekst ku risqet e fatkeqësive janë shumë të mëdha, të shumë-llojshme, dhe të vazhdueshme, ku komuniteti ka një vulnerabilitet të lartë dhe bashkia një kapacitet të ulët në të katër hallkat e ciklit, atëherë ndërhyrjet për përmirësimin e situatës duhet të zhvillohet në të gjitha hallkat e ciklit.


Një tjetër parim shumë i rëndësishëm përse i përket strategjive të ZRF në nivel lokal është integrimi i politikave dhe kulturës së ZRF në të gjithë sektorët, e veçanërisht në sektorin e planifikimit të territorit. Integrimi i strategjive të ZRF në planet e zhvillimit të territorit vjen me sfida të veçanta, por gjithashtu gjeneron mundësi për zhvillim të qëndrueshëm, duke sjellë potencialisht përfitime ekonomike. Ndikimet e fatkeqësive ndjehen menjëherë dhe intensivisht në nivelin lokal. Fatkeqësitë shpesh ndodhin, dhe risku shpesh shfaqet, në nivel lokal, kështu që shumë nga mjetet më efektive për të zvogëluar ekspozimin dhe cenueshmërinë ekzekutohen këtë nivel. Këto instrumenta përfshijnë rregulloret e përdorimit dhe zhvillimit të tokës, zbatimin e standarteve të ndërtimit, si dhe menaxhimin mjedisor që janë thelbësore për ZRF efektive. Qeveritë dhe komunitetet duhet të angazhohen dhe të punojnë së bashku në nivelin vendor për ZRF.

Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive dhe zhvillimi i aftësisë ripërtëritëse duhet të krijojnë një trashëgimi të udhëheqjes ku shfaqet besimi i rritur dhe legjitimiteti i strukturave të autoritetit vendor. Këto duhet të bazohen në kompetenca të decentralizuara dhe optimizimin e burimeve. Zvogëlimi i humbjeve nga fatkeqësitë duke mbështetur në të njëjtën kohë rritjen ekonomike dhe zhvillimin social-kulturor mund të ofrojë siguri edhe për investitorët. Zhvillimi i komuniteteve të jetueshme, me ekosisteme të ekuilibruara, planifikim dhe dizajn më të mirë urban, dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve krijojnë një platformë të suksesshme për qeverisjen territoriale.

Lloje të ndryshme dhe shkallët e planeve të territorit, nga ato më strategjike tek ato të përdorimit të tokës, mund të ndihmojnë në mbrojtjen e zonave të ndjeshme mjedisore duke rritur qëndrueshmërinë. Planet e Përgjithshme Vendore dhe Kombëtare ndihmojnë në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive përmes infrastrukturës së planifikuar më mirë dhe krijimit të hapësirave të hapura. Ato gjithashtu ndihmojnë në zvogëlimin e cenueshmërinë përmes përcaktimit të vendndodhjes së përshtatshme të funksioneve të strehimit dhe shërbimeve të tjera kritike për komunitetin. Gjithashtu, planifikimi i territorit, si një instrument i qeverisjes, është një proces i cili ndihmon në zbutjen e ndikimeve nga ndryshimet klimatike, tranzicionin energjitik dhe reduktimin e emetimeve nga gazrat serë. Nëpërmjet politikave të rigjenerimit urban mund të garantohet rindërtimi i tyre dhe përmirësimi i hapësirave komunitare, por këto gjithmonë duhet të zhvillohen nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje për të zvogëluar riskun e krijimit të krizave sociale apo të gjentrikimit. Për më tepër, aplikimi i koncepteve që kanë një qasje miqësore ndaj mjedisit si qasje të bazuara në ekosistem, infrastruktura e gjelbër dhe infrastruktura blu ndihmojnë në zvogëlimin e riskut në zona urbane dhe njëkohësisht përmirësojnë cilësinë e jetesës dhe garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm territorial. Gjithësesi, një faktor i rëndësishëm për integrimin e politikave të ZRF në planifikimin e territorit është nevoja për të pasur një kuptim më të gjerë dhe të thelluar të risqeve. Kjo gjë duhet të bazohet në të dhëna të përditësuara dhe të gjera në mënyrë që politikatat të përshtaten me dinamikat e zhvillimit lokal. Monitorimi duhet të jetë një faktor thelbësor dhe të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme.

Strategjia e ZRF të Bashkisë Lezhë bazohet në dy analiza thelbësore të rreziqeve dhe të riskut. Pas kësaj ngrihen vizioni dhe objektivat. Për secilin objektiv hartohen një sërë masash të cilat më pas testohen e prioritarizohen nëpërmjet skenarëve të ndryshëm. Skema e mëposhtme jep një këndvështrim të kapituve të strategjisë dhe të hapave metodologjik të ndjekur për hartimin e saj.

FIG 2. Struktura e Strategjisë




Burimi: Autorët

Siç mund të dallohet nga skema e mësipërme, një tjetër element thelbësor i strategjisë është dhe monitorimi. Ky element është i përbërë nga dy lloje monitorimi, fillimisht përsa i përket monitorimit të zbatimit të strategjisë dhe përbushjes së aktiviteteve e masava të parashikuara dhe më pas për monitorimin e ZRF në tërësi.

# BAZA LIGJORE

---



Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, “Subsidiaritet” është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë.

Në nenet 23-29 të ligjit, përcaktohen funksionet e bashkive në fushat e:

- *Infrastrukturës dhe shërbimeve publike*
- *Shërbimeve sociale*
- *Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese*
- *Mbrojtjes së mjedisit*
- *Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit*
- *Zhvillimit ekonomik vendor*
- *Sigurisë publike*

Në veçanti, sipas nenit 29; Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:

1. *Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*
2. *Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

Sipas Raportit vjetor të Riskut Botëror të Universitetit të Kombeve të Bashkuara, i cili llogarit Indeks të Riskut të Fatkeqësive për shkak të tërmeteve, stuhive, përmbytjeve, thatësirave dhe ngritjes së nivelit të detit për 181 vende në botë bazuar në ekspozimin dhe cenueshmërinë (ndjeshmëria, dhe aftësitë e përballimit dhe përshtatjes), Shqipëria ka një indeks të riskut të lartë dhe renditet e para në Evropë dhe e 60-ta në botë.

Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, kishte hedhur baza kryesisht në fushën e planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, por ai kishte mangësi thelbësore në shumë përcaktime të tij për fusha, siç ishin: paralajmërimi i hershëm, edukimi, trajnimi, asistencë ndërkombëtare, monitorimi, njoftimi, alarmi dhe inspektimi.

Në ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001, i ndryshuar sikurse në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile/PKEC, nuk ishin reflektuar politikat ndërkombëtare të asaj kohe mbi Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive/ZRF edhe pse në kohën e përgatitjes së tyre ka qenë një kuadër ndërkombëtar respektiv - Strategjia dhe Plani i Veprimit Yokohama për një Botë më të Sigurt, 1995-2005<sup>1</sup>

Ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ka si qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, gjësë së gjallë, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Referuar ligjit, mbrojtja civile ka si mision krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

<sup>1</sup> Strategjia e Yokohama dhe plani i veprimit për një botë më të sigurt u miratua në vitin 1994 pas Konferencës Botërore të Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore, mbajtur në Yokohama, Japoni. Është dokumenti i parë që ofron udhëzime në nivel ndërkombëtar për përgatitjen dhe parandalimin dhe zbutjen e impakteve të fatkeqësive. Strategjia e Yokohama ishte një produkt i Dekadës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore (1990-2000) dhe më konkretisht, i Konferencës Botërore për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore të mbajtur në vitin 1994.

Ligji është në linjë me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive/SFDRR 2015-2030<sup>2</sup> dhe për këtë ka një kapitull të dedikuar me titull, “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë”. Si i tillë, ai synon integrimin e prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave të Kuadrit Sendai, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet:

- Hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare<sup>3</sup> dhe strategjive vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë,
- Vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë në nivelin qendror, qarku, vendor dhe për infrastrukturën kritike,
- Planeve të emergjencave civile në nivelin qendror; ministrie; qarku; vendor; infrastrukturë kritike; institucione shtetërore dhe subjekte private në sektorët kryesorë<sup>4</sup> sikurse për subjektet që operojnë me materiale të rrezikshme<sup>5</sup>.
- Sanksionimit të detyrimit ligjor për krijimin e Bazës së të dhënave të Fatkeqësive në AKMC, ministri, Prefekturë dhe bashki sikurse detyrimit të vlerësimit të humbjeve nga fatkeqësitë në ministri dhe bashki.
- Organizimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në ministri, qark dhe bashki.
- Detyrimit për arsimimin në nivelin parauniversitar që të sigurojë njohuri mbi mbrojtjen dhe parandalimin e fatkeqësive, në përputhje me profilin e tyre.
- Kahas detyrave, dhe përgjegjësive të institucioneve qendrore dhe vendore, ligji sanksionon edhe detyrat, përgjegjësitë por edhe të drejtat e subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve<sup>6</sup>

Ligji përfaqëson disa direktiva dhe vendime shumë të rëndësishme të BE-se në fushën e ZRF dhe mbrojtjes civile sikurse ka një kapitull të detajuar të dedikuar asistencës ndërkombëtare çka do të ndikojë në përshpejtimin e anëtarësimit sa më të shpejtë të vendit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane. Nëpërmjet implementimit të Kuadrit Sendai, ligji ndikon edhe për plotësimin e detyrimeve të tjera ndërsektoriale që burojnë nga Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimin e klimës dhe Agjenda e Re Urbane.

Ligji siguron rritjen e kapaciteteve administrative të:

- Institucioneve qendrore të Mbrojtjes Civile, së pari nëpërmjet ngritjes së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile/AKMC, e cila do të zëvendësojë Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile. AKMC do të ketë kapacitete shumë më të mëdha administrative, përgjegjësi dhe kompetenca më të gjera, duke u transformuar në këtë mënyrë, në një organizatë lider, të denjë dhe të krahasueshme edhe me të gjitha strukturat homologe ndërkombëtare<sup>7</sup>.

2 Kuadri Sendai u miratua në Konferencën e 3-të Botërore të OKB-së për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive, të zhvilluar në 18.03.2015 në Sendai, Japoni dhe u miratua në 3.06.2015 nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së A/RES/69/283 në Takimin e 92-të Plenar të saj.

3 Objektivi i pestë i Kuadrit Sendai është: Rritja në mënyrë thelbësore e numrit të vendeve me strategji të zvogëlimit të riskut kombëtar dhe lokal të fatkeqësive deri në vitin 2020.

4 Sipas ligjit 45/2019 “*Institucionet shtetërore dhe subjektet private në sektorët e shëndetësisë, të arsimit, mirëqenies sociale, kulturës, mjedisit dhe turizmit miratojnë planin për emergjencat civile*”

5 Sipas ligjit 45/2019 “*subjektet me aktivitet prodhimin, përdorimin, trajtimin dhe magazinimin e substancave të rrezikshme, janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar aksidente të mëdha dhe për të kufizuar pasojat e tyre për shëndetin e njeriut dhe mjedisin*”.

6 Parimi Udhëzues nr.4 i Kuadrit Sendai “Për një angazhim të të gjithë shoqërisë” ( Engagement from all of society)

7 Ngritja e AKMC-së është në mënyrë të veçantë edhe reflektim i pjesshëm ndaj rekomandimit të Raportit të Komandës Amerikane në Evropë të korrikut 2014: “*Kalimi i DPEC në një Agjenci Kombëtare të Emergjencave Civile që vepron nën Kryeministrin ose Këshillin e Ministrave dhe identifikimin e kërkesave të fuqisë punëtore*”

- Ministrive, duke sanksionuar ngritjen e strukturave të mbrojtjes civile në ministri<sup>8</sup> duke korigjuar kështu problemin e madh të sistemit që vinte si pasojë e mungesës së strukturave në ministri me pasojë paralizimin e funksionimit të tij horizontal në nivelin qendror.
- Nivelit të qarkut dhe atij vendor me ngritjen për herë të parë të Qendrave Rajonale të Mbrojtjes Civile që do të jenë janë degë territoriale në varësi të AKMC-së. Përveç komisioneve të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie, ligji nuk ka ndonjë reference specifike në lidhje me strukturat e mbrojtjes civile në Institucionin e Prefektit të qarkut dhe as në bashki. Gjithsesi, dispozitat përkatëse për këto dy struktura janë të përcaktuara në VKM nr.965, datë 2.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”, rishikimi i të cilës, në frymën e ligjit 45/2019<sup>9</sup>, do të sjellë edhe rikonceptimin e mundshëm të strukturave të ZRF dhe Mbrojtjes Civile në Prefektura dhe në bashki.

Ligji siguron gjithashtu rritjen e kapaciteteve financiare si më poshtë:

- Për ministritë ai sanksionon detyrimin e planifikimit të buxhetit vjetor për ZRF dhe Mbrojtjen Civile, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore nga 2 % deri në 4 % e totalit të buxhetit vjetor.
- Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Përvoja e menaxhimit të fatkeqësive në vite, kanë venë në dukje mangësi të mëdha në nivelin vendor ku bashkitë kanë pasur mangësi thelbësore në tërësinë e kapaciteteve të nevojshme për menaxhimin e fatkeqësive dhe si rrjedhim nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor në ciklin e menaxhimit të tyre. Për arsye të kuptueshme, kjo ka qenë më tepër e evidente në fazën e përgjigjes ndaj fatkeqësive por kontributi i bashkive ka qenë edhe më i papërfillshëm në drejtim të masave parandaluese, të gatishmërisë dhe të rimëkëmbjes ndaj tyre. Ka pasur një mungesëtë përgjithshme të kuptimit të politikave të ZRF në nivelin vendor, çka ka sjellë si pasojë edhe një zhvillim të pa informuar rreth riskut të fatkeqësive.

Duhet theksuar fakti që ligji nr. 8756, datë 26.03.2001, i ndryshuar, e ngarkonte Kryetarin e Bashkisë me përgjegjësinë për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashkinë përkatëse. Kjo përgjegjësi u përforcua edhe më tej me ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” me parimin e subsidiaritetit por edhe me sanksionimin e përgjegjësive së garantimit të funksionimit të mbrojtjes civile, të cilat, të gjitha sëbashku nuk sollën ndonjë impakt të qenësishëm në angazhimin e bashkive në fushën e menaxhimit të emergjencave e aq më pak pastaj në kuptimin dhe implementimin e politikave të ZRF në nivel vendor.

Risqet e Fatkeqësive kanë specifika që janë më së shumti vendore, që janë rreziku, ekspozimi, cenueshmëria dhe kapacitetet përballuese ndaj tyre<sup>10</sup>. Nga ana tjetër bashkitë janë “porta e parë” ku qytetarët “do të trokasnin” për shqetësimet e tyre për rrezikun dhe cenueshmërinë pasi ato janë përgjegjëset kryesore për sigurinë e komuniteteve të tyre.

8 Sipas pikës 4 të nenit 23 të ligjit; *Çdo ministri ka pozicione pune deri në nivel sektori për mbrojtjen civile, përbërja dhe detyrat e të cilëve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit*

9 Sipas VKM nr.965, datë 2.12.2015:  
 23. Në përbërje të strukturës së administratës së Prefektit ngrihet sektori i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe krizave.  
 24. Në përbërje të organikës së bashkive planifikohen struktura të përhershme të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile dhe krizave, si më poshtë vijon:  
 - për bashkitë qendër qarku, ngrihet strukturë në nivel drejtorie;  
 - për bashkitë e tjera, ngrihet strukturë në nivel sektori.

10 Sipas Kuadrit Sendai bashkitë janë autoriteti përgjegjës kryesor në fatkeqësi.

Prandaj, me qëllim ndryshimin rrënjësor të mentalitetit të krijuar, me qëllim angazhimin e duhur dhe proporcional të bashkive në ZRF dhe Mbrojtjen Civile dhe orientimin e zhvillimit të tyre drejt një zhvillimi të qendrueshëm të informuar rreth riskut, ligji 45/2019 përmban përcaktime të qarta për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në ZRF dhe Mbrojtjen Civile. Më konkretisht sipas ligjit:

Sanksionohet parimi i subsidiaritetit çka kupton angazhimin gradual të kapaciteteve duke filluar nga ato të bashkisë - *kapacitete shitesë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore fqinje -kapaciteteve të tjera shtetërore*<sup>11</sup>:

Prefekti i qarkut ka gjithashtu rol parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin 107/2016 "Për prefektin e qarkut", në vijim të detyrave të sipërpermendura Prefekti i qarkut ka detyra specifike që i referohen ligjit 45/2019 siç janë; Koordinimi i veprimtarive të organeve, institucioneve dhe strukturave që veprojnë në nivel qarku; grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku; koordinimi i shpërndarjen së asistencës ndërkombëtare në rastet e fatkeqësive; kontrolli i zbatimit të masave të marra nga bashkitë e qarkut për ZRF dhe mbrojtjen civile etj.

Edhe bashkitë, përveç detyrave të permendura më lart, sipas ligjit 45/2019 kanë edhe detyra të tjera siç janë: Informojnë publikun dhe komunitetin e rrezikuar; organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre; sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përbalimin e fatkeqësive; kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë; caktojnë drejtuesin e operacionit në nivel bashkie etj.

Si konkluzion mund të themi se ligji 45/2019 përbën një hap shumë të rëndësishëm përpara për implementimin e politikave të ZRF dhe Mbrojtjes Civile në Shqipëri, në linjë me Kuadrin Sendai, në të gjitha nivelet dhe të gjitha sektorët. Gjithsesi implementimi i këtij ligji kaq modern dhe bashkëkohor, për kushtet e Shqipërisë, përbën një sfidë që do të duhet të përballohet së pari nga AKMC me mbështetjen edhe të institucioneve të tjera qendrore dhe vendore. Në fund të fundit kjo është në linjë me Kuadrin Sendai i cili nënvizon faktin se shteti ka rolin kryesor për ZRF, por gjithsesi, kjo përgjegjësi duhet të ndahet me të gjitha grupet e interesit, duke përfshirë qeveritë vendore dhe sektorin privat.

Suksesi i implementimit të ligjit ka parakusht të tij, funksionimin e vetë AKMC-së dhe plotësimin e gjithë bazës ligjore në zbatim të ligjit, për të vijuar pastaj me udhëheqjen e procesit aspak të lehtë të implementimit të këtij ligji me impakt domethënës në të gjithë shoqërinë shqiptare.

Por para së gjithash, duhet që politikat e ZRF dhe Mbrojtjes Civile të jenë pjesë e rëndësishme e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar dhe këtu përmendim SKZHI-në 2021-2025 që është në proces konsultimi mes Kryeminitrisë dhe institucioneve sikurse duhet të përgatitet sa më shpejt Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive.

11 Sipas parimit të subsidiaritetit (ligji 45/2019): 1. Kur në një fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjetër kërkohet mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, fillimisht përdoren kapacitetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore të prekur nga fatkeqësia. 2. Nëse kapacitetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të pamjaftueshme për të përballuar situatën e krijuar nga fatkeqësia, kërkohen kapacitete shitesë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore fqinje. 3. Nëse kapacitetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të prekur nga fatkeqësia dhe të atyre fqinje, janë të pamjaftueshme për të përballuar situatën e krijuar nga fatkeqësia, kërkohet angazhimi i kapaciteteve të tjera shtetërore, duke përfshirë Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Dhe së fundmi, është shumë e rëndësishme që të sigurohet një vijueshmëri e implementimit të politikave të ZRF në nivel kombëtar dhe nivel vendor për të cilën është e domosdoshme udhëheqja e të gjithë procesit të ZRF nga një forum i nivelit të lartë që do ishte Platforma Kombëtare dhe Platforma Vendore e ZRF<sup>12</sup> për nivelin vendor.

## 2.1 LIGJET SEKTORIALE

Kuadri i ri ligjor mbi Mbrojtjen Civile në Shqipëri kërkon një koordinim të zgjeruar sektorial me fusha të ndryshme si planifikimi dhe zhvillimi i territorit, mjedisi, bujqësia, infrastruktura, ujërat e energjitika. Ligji 45/2019, Për “Mbrojtjen Civile” sanksionon në nenin 12 se Planet e Përgjithshme Vendor dhe Planet e Përgjithshme Kombëtare duhet të jenë të harmonizuara me dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë dhe strategjitë për reduktimin e riskut. Ndërkohë, neni 13 shton një tjetër element të ndërlidhur me zhvillimin e territorit që është vërtetimi i riskut. Ky vërtetim kërkon që si pjesë e procedurave për marrjen e lejeve zhvillimore e të ndërtimit, si ato të cilat lëshohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit ashtu dhe ato në nivel vendortë pajisen me një vërtetim të riskut.

Bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, instrumentat e planifikimit në nivel qendror janë Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, Planet Sektorial dhe Planet e Detajuara të Zonave të Rëndësisë Kombëtare. Ndërkohë, në mënyrë analogjike, në nivel vendor, instrumentat e planifikimit janë Plani i Përgjithshëm Vendor i Territorit, Planet Sektoriale Vendore dhe Planet e Detajuara Vendore. Në nivel qarku, duke qënë se kompetencat për planifikimin e territorit janë të kufizuara operohet vetëm me plane sektoriale qarku, të cilat synojnë të koordinojnë politikat sektoriale kombëtare me ato vendore.

Ndërkohë, VKM 686, 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” e ndryshuar, përcakton përmbajtjen dhe procedurat e hartimit e miratimit të instrumentave të planifikimit të territorit. Neni 19, përcakton përmbajtjen e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, që është dhe dokumenti më i lartë i planifikimit të territorit në Shqipëri. Në të përcaktohet që PPKT duhet të përmbajë analizën metabolike të flukseve. Kjo është një analizë multi-dimensionale e cila duhet të përfshijë dhe riskun nga fatkeqësitë natyrore. PPKT gjithashtu, përcakton edhe infrastrukturën e rëndësisë kombëtare në territor dhe zgjerimin e përmirësimit të tyre. Këto infrastruktura, konsiderohen gjithashtu edhe si infrastruktura kritike, bazuar nga përcaktimet e ligjit 45/2019. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i PPKT është edhe përcaktimi i masave për mbrojtjen e sistemeve të ndryshme territoriale, duke përfshirë edhe risqet natyrore. Ndërkohë, neni 22, përcakton se, si pjesë e Planeve Kombëtare Sektoriale mund të jenë dhe planet për sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore të lidhura me sizmicitetin, hidrografinë, hidrogeologjinë, gjeologjinë e ndryshimet klimatike.

Nenet 54 dhe 55 të VKM 686, përcaktojnë përmbajtjen e Planeve të Përgjithshme Vendore. Në analizën e PPV është e parashikuar që duhet të përmbahen dhe analizat përkatëse gjeologjike, gjeografike, hidro-gjeologjike e sizmike të cilat shërbejnë si pararendëse për zvogëlimin e riskut në territor. Përsa i përket aspektit sizmik, neni 55, pika 2b, përcakton se përtej makrozonimit sizmik, është i nevojshëm dhe mikrozonimi. Ndërkohë, neni 57, përcakton se si pjesë e planit të Zhvillimit të Territorit, duhet të përcaktohen dhe infrastrukturën inxhinierike të cilat garantojnë mbrojtjen civile dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore.

<sup>12</sup> Sipas Kuadrit Sendai: Të krijohen dhe forcohen forume koordinuese qeveritare të përbëra nga palët e interesuara në nivel kombëtar dhe lokal, të tilla si platforma kombëtare dhe lokale për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, dhe një pikë e caktuar kombëtare qendrore për zbatimin e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030



Gjithashtu, të gjitha instrumentat e planifikimit, si në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, të përgjithshme ose sektoriale, duhet të shoqërohen me Vlerësime Strategjike Mjedisore. Ky instrument, ka një qasje të madhe mjedisore, dhe parashikohen gjithashtu masat për mbrojtjen ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike. Këto masa ndikojnë në një përshtatje më të mirë të planeve në lidhje me mjedisin dhe zbutjen e ndikimeve negative. Së fundmi, Neni 11, parashikon se planet e përgjithshme vendore ose kombëtare mund të rishikohen në raste të fatkeqësive natyrore si tërmete, përmytje, zjarre masive ose për harmonizimin me dokumente planifikimi ose strategjike të niveleve më të larta.

Përsa i përket kuadrit ligjor mbi zhvillimin e territorit, VKM 408, dt 13/05/2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton rregullat bazë dhe procedurat për zhvillimin e territorit. Në këtë rregullore, parashikohen procedurat për lejet zhvillimore, lejet e ndërtimit të cilat përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe leje ndërtimi të cilat jepen nga autoritetet në nivel vendor. Për të gjitha procedurat, është e nevojshme që lejet të bazohen në parashikimet e instrumentave të zhvillimit. Gjithashtu, çdo leje ndërtimi, duhet të shoqërohet me projektet përkatëse për mbrojtjen nga zjarri ose nga rreziqet. Edhe pse nuk shpjegohet në mënyrë eksplicite në këtë VKM, të gjitha aplikimet për leje ndërtimi duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës gjeologjik dhe sizmik. Ndërkohë, përsa i përket punimeve të ndërtimit, ato disiplinohen nëpërmjet ligjit 8402, 10/09/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit". Neni 4, i ligjit, përcakton se të gjitha ndërtesat, duhet të projektohen duke zbatuar parimet dhe standartet e mbrojtjes kundra zjarrit, plotësimin e kërkesave për rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike, plotësimin e standarteve për shëndetin, higjienën dhe mjedisin, si dhe sigurinë në përdorim, mbrojtjen nga zhurmët dhe kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.

Siç u përmend dhe më sipër, të gjitha instrumentat e planifikimit të hartuara në nivel kombëtar e vendor duhet të shoqërohen me Vlerësim Strategjik Mjedisor. Ligji, 91/2013, dt 28/02/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", përcakton rregullat, përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të VSM-ve. Në dokumentin e VSM, është e rëndësishme që të analizohet gjendja ekzistuese e mjedisit, duke përfshirë identifikimin e problematikave mjedisore. Gjithashtu, në këtë kontekst analizohen dhe faktorët e ndryshëm klimatike dhe ndryshimet klimatike. Masat e VSM, ndikojnë në zbutjen e ndikimeve të PPV-së si dhe informojnë këtë të fundit për vendime të rëndësishme të cilat mund të bihen ndesh me objektivat mjedisore.

Në kuadër të procesit të rindërtimit pas tërmetit të Nëntorit të 2019, në kuadrin e instrumentave të planifikimit u shtuan dhe Planet e Detyruara Vendore. Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", parashikon paraprirjen e procesit të rindërtimit nga planifikimi i territorit përmes Planit të Detyruar Vendor (PDyV). Ky instrument hartohet për një zonë të vecantë, e shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave, si Zonë e Re për zhvillim (ZRZH), e cila mund të jetë një zonë e dëmtuar, ose një territor i lirë nga ndërtimet, apo i përshtatshëm për procesin e rindërtimit.

Nga kuadri ligjor sektorial i mjedisit, një ligj i rëndësishëm është edhe ligji Nr. 111/2012 :Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar. Ky ligj, ndër objektivat e tij (neni 3, pika dh) ka edhe marrjen e masave për zbutjen efektive rrezikut nga përmytjeve dhe thatësirave. Ligji, përcakton se për secilin basen ujor duhet të hartohen dhe Strategjitë dhe Planet e Menaxhimit të Basenit. Bazuar në nenin 24, strategjitë dhe planet e basenit duhet të përmbajnë edhe kushtet dhe masat për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet. Gjithashtu, neni 68, sanksionon se organet përgjegjëse për menaxhimin e ujërave, në bashkëpunim me zyrat

e mbrojtjes civile në nivel vendor, qarku ose kombëtar, menaxhojnë situatën në rast përmbytje. Ato kanë kompetencën për zbatimin e projekteve të emergjencave. Gjithashtu, neni 68, pika 2, thotë që “Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me strukturat dhe organet e qeverisjes vendore, janë përgjegjëse për parandalimin, përbalimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar”. Ndërkohë, neni 70, përcakton se Agjencitë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me zyrat e administrimit të baseneve, harton planet e parandalimit, mbrojtjen, gatishmërinë, duke përfshirë dhe parashikimin e vërshimeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm të cilin e bashkërendon me strukturat përgjegjëse të mbrojtjes civile në nivel vendor. Gjithashtu, përsa i përket menaxhimit të ujërave, neni 40, pika 5, përcakton se *“organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore kanë të drejtë që gjatë periudhave të mungesës së ujit dhe thatësirave apo kur cilësia e ujit është cenuar, kur përhapen ose ka rrezik të përhapen sëmundje të shkaktuara nga uji, të kufizojnë përdorimin e lirë të ujit në të gjithë vendin ose në zona të veçanta”*.

Përsa i përket mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, ligji 9385, dt 4/05/2005, i ndryshuar, përcakton kuadrin institucional dhe procedurat për mbrojtjen dhe menaxhimin e situatave të zjarreve në pyje. Shërbimi pyjor, si organi kryesor në menaxhimin e pyjeve organizohet në nivel qendror, pranë ministrisë përgjegjëse dhe pranë bashkive. Policia pyjore ndërkohë, bazuar në nenit 7 të ligjit, kryen funksionin kontrollues. Bashkia, ngre gjithashtu strukturën e saj për menaxhimin e pyjeve dhe përbërja e saj duhet të jetë jo më pak se një punonjës për 750-1000 ha pyje të larta, 1500-2000 ha për pyjet e ulëta dhe shkurret, 4000-6000 ha kullota dhe livadhe. Këto struktura kanë për detyrë, në bashkëpunim me ministrinë e linjës që të hartojnë planet përkatëse për mbarështimin e pyjeve si dhe të organizojnë mbrojtjen ndaj zjarrit, përgjigjen në raste zjarri dhe më pas rehabilitimin e pyjeve.

Bujqësia, është gjithashtu një fushë e rëndësishme e cila cënohet në rastet e fatkeqësive natyrore. Ligji 9244, dt. 17/06/2004, “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”, i ndryshuar, përcakton në nenin 16, se pronarët e tokës bujqësore ose posedues të saj, janë të detyruar për të kryer administrimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen, brenda territorit të tokës se tyre në pronësi, të sistemit të kullimit, sistemit të ujitjes, të veprave të artit dhe të mbrojtjes së tokës bujqësore nga përmbytjet, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr.24/2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”. Gjithashtu, ligji 24/2017 përcakton se Ministria përgjegjëse, ka si detyrë që të kryejë kontrollet fizike të infrastrukturave të mbrojtjes nga përmbytjet si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme në raste përmbytje ose thatësire të zgjatur. Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit, në varësi të ministrisë, shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në administrim të tyre, brenda zonave përkatëse të shërbimit Bashkitë gjithashtu luajnë një rol në këtë fushë përsa i përket infrastrukturave të cilat janë transferuar në pronësi të tyre. Përtej kësaj, bashkitë, mbikëqyrin sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe, kur është e nevojshme, kryejnë ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre.

Ligji Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Shërbimi i MZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme dhe misioni i tij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Shërbimi i MZSH-së organizohet me Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së në nivelin qendror, strukturat e shërbimit të MZSH-së në bashki, Shërbimi i MZSH-së në objektet me rëndësi ekonomike, strategjike dhe Shërbimi vullnetar i MZSH-së.

Drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSH-së në bashki, të cilat në vitin 2016 kaluan nga institucioni i Prefektit në varësi të kryetarit të bashkisë, përfaqësojnë strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion. Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse.

Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë. Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se 14 zjarrfikës, personel profesionist.

Kryetari i bashkisë ka të gjitha përgjegjësitë për MZSH-në si:

- për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve
- planifikon fondet e shërbimit të MZSH-së
- siguron gatishmërinë e përhershme të stacioneve të dhe i vë ato në dispozicion të emergjencave
- merr masa për mbajtjen në gjendje funksionimi të rrugëve të kalimit, për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse
- kërkon instalimin dhe kompletimin me sisteme hidrike funksionale për shërbimin e MZSH-së, konform normave dhe standardeve në fuqi, në gjithë territorin e bashkisë
- jep leje zhvillimi/ndërtimi dhe akte shfrytëzimi të strukturave ndërtimore vetëm pas plotësimit të rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin
- planifikon fonde për trajnimin, kualifikimin periodik dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit zjarrfikës
- siguron, edukimin e komunitetit me njohuritë dhe masat e mbrojtjes kundër zjarrit

Sipas nenit 38 “Detyrimet e personave fizikë e juridikë” të ligjit. Të gjithë personat fizikë e juridikë:

- marrin masa për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktim-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre e i kontrollojnë e paktën 1 herë në vit.
- planifikojnë fonde financiare për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin dhe për ngritjen e grupeve zjarrfikëse dhe trajnimin periodik të tyre;
- pajisin strukturat e tyre me sisteme sinjalizimi, ndërlidhjeje, sisteme stacionare automatike, me hidrantë zjarrfikës për MZSH sipas normave teknike dhe i mbajnë ato në gatishmëri;
- hartojnë rregullat e brendshme për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me rrezikshmërinë e proceseve teknologjike;

Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve dhe administrimin e zonave të mbrojtura etj., përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Ligji sanksionon edhe sanksionet përkatëse për ndërtimet sikurse për veprimtarinë e të gjithë personave fizikë e juridikë.

Përtej ligjeve të sipërpërmendura të cilat kanë implikime të drejtpërdrejta në fushën e zvogëlimit të riskut ndaj fatkeqësive, janë dhe disa ligje të tjera sektoriale, si në fushën e ndërtimit apo dhe në atë të energjistikës, të cilat kanë në fokus të tyre mbrojtjen ndaj burimeve mjedisore dhe zbutjen e impaktit të ndryshimeve klimatike. Pra, edhe pse jo drejtpërdrejtë, ato ndikojnë në zvogëlimin e risqeve, veçanërisht atyre të ndikimeve klimatike. Në këtë kontekst, Ligji Nr. 9290, Dt 7.10.2004 “Për Produktet e ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr.9825, datë 1.11.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, ka për qëllim

që të përcaktojë në nivel kombëtar kriteret bazë për produktet të cilat përdoren në fushën e ndërtimit. Ligji aplikohet si për produkte të cilat janë të prodhuara në Shqipëri ashtu dhe për ato të cilat importohen. Në parashikimet e përgjithshme, pra në nivel kombëtar, ligji në nenin 4, saktëson se përtej faktit që produktet duhet të jenë rezistente dhe të qëndrueshme nga pikëpamja mekanike dhe fizike, ato duhet të plotësojnë dhe kriterin për Kursimin e Energjisë dhe Ruajtjen e Ngratjes. Nga kjo pikëpamje, mund të thuhet se ligji ofron një kusht të rëndësishëm në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimin e konsumit energjistik, si një nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë çështje.

Ligji Nr. 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike është një ndër ligjet kryesore përsa i përket Prodhimit të Energjisë Elektrike. Ai strukturon procedurat për rritjen e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike si dhe mënyrat e menaxhimit të tyre. Një ndër aspektet e rëndësishme që promovohet nga ligji është që ndërtimi i kapaciteteve prodhuese të reja të energjisë elektrike duhet të mbrojtë mjedisin dhe të promovojë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike. Promovimi i energjisë së rinovueshme është një aspekt i rëndësishëm, por nga ana tjetër, burimet hidrike, vazhdojnë të konsiderohen si burime energjitike të rinovueshme. Kjo krijon një ngërç ligjor që duhet marrë në konsideratë në vijim duke qënë se tashmë është e vërtetuar se shfrytëzimi i burimeve hidrike shkakton dëme në mjedis nga njëri krah, por edhe për faktin se si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike dhe ndryshimit të regjimit të rreshjeve, ky do të jetë një nga sektorët kryesorë që do të preket. Përsa i përket aftësive vetëripërtëritëse dhe situatave emergjente, ligji ka dy parashikime të rëndësishme. Neni 52, përcakton që prodhuesit e energjisë elektrike duhet të jenë të detyruar të mbajnë rezerva të veçanta të lëndëve djegëse ose kapacitete rezervë prodhuese të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm të klientëve dhe se sasia rezervë miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndërkohë, që neni 90, i lejon Këshillit të Ministrave që të shpallë gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike në rast të:

- a) një force madhore, përfshirë edhe një thatësi, e cila redukton prodhimin e hidrocentraleve në Shqipëri;
- b) masave të marra nga strukturat shtetërore për garantimin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e vendit;
- c) aksidenteve dhe avarive në pajisjet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së sistemit të energjisë elektrike;
- ç) mungesave afatgjata të burimeve parësore energjetike për prodhimin e energjisë elektrike. Ky ligj nuk ka implikime në nivel vendor.

Ligji Nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë” është i rëndësishëm dhe sanksionon parimet bazë mbi të cilat duhet të ngrihet politikat kombëtare e rrjedhimisht ato lokale për përdorimin efiçent të energjisë. Në qëndër të vëmendjes është edhe reduktimi i impaktit negativ në mjedis dhe mbështetjen e kërkimeve në fushën e përmirësimit të efiçencës energjitike.

Gjithashtu, ligji promovon faktin që autoritetet publike duhet të shërbejnë si model në tranzicionin energjistik. Kjo vlen si për nivelin kombëtar ashtu dhe për nivelin vendor. Pra në këtë rast, bashkitë duhet të angazhohen dhe investohen në hartimin e projekteve model të cilat mbështetin nisma të cilat zhvillohen në kuadër të efiçencës energjitike. Gjithashtu, autoritetet, përtej hartimit të politikave dhe projekteve mbështetëse duhet të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në edukimin e publikut dhe qytetarëve në këtë fushë.

Ligji Nr. 116/2016 Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave saktëson kriteret bazë dhe procedurat për rritjen e performancës energjitike të ndërtesave. Në vijim të akteve ligjore

të tjera të përshkuara në këtë dokument, ligji gjithashtu jep një kontribut të drejtpërdrejtë përsa i përket çështjeve të resilience apo përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Neni 8 i ligjit përcakton qartë se për ndërtesat e reja, është e nevojshme që gjatë periudhës së projektimit duhet të hartohen studime fizibiliteti të cilat marrin në konsideratë sisteme alternative të prodhimit dhe përdorimit të energjisë në ndërtesa. Kjo gjë mund të aplikohet si për çështje të prodhimit të energjisë, ashtu dhe për sistemet e ngrohjes dhe freskimit, duke marrë në konsideratë që konsumi kryesor në ndërtesa vjen si rezultat i këtyre sistemeve.

Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Bazuar në kompetencat nga ligji i planifikimit të territorit përsa i përket lejeve të ndërtimit, bashkitë duhet të luajnë një rol kyç në kontrollin e dokumentacionit të lejeve të ndërtimit dhe në sigurimin që zhvilluesit marrin në konsideratë sisteme alternative të përdorimit të energjisë. Kjo është një hallkë thelbësore në zbatimin e ligjit dhe rritjen e performancës energjitike në ndërtesa duke garantuar kështu dhe një proces të qëndrueshëm të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Ligji Nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”, është një hap i rëndësishëm përsa i përket çështjeve të resilience duke qënë se mbështet përdorimin e energjisë nga Burimet e Rinovueshme. Bazuar në këtë ligj, neni 3, pika dh, energji të rinovueshme janë nga burime të rinovueshme jofosile, konkretisht era, dielli, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia hidrotermike dhe energjia e oqeanëve, energjia hidrike, biomasa, gazi i grumbulluar në landfille, gazi, që grumbullohet nga trajtimi i ujërave të zeza dhe biogazet.

Siç përmendet dhe në ligjin e mësipërm, energjia hidrike vijon të klasifikohet si energji e rinovueshme, edhe pse do të ketë një ndikim të fortë nga ndryshimet klimatike. Nga ana tjetër, ligji është pozitiv duke qënë se ndihmon në diversifikimin e prodhimit të energjisë dhe në decentralizimin e tij. Ky ligj, është në përputhje me traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Ligji gjithashtu të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse organike, emetimin e gazeve me efekt serrë dhe të mbrojtë mjedisin, në zbatim të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare. Ligji përcakton procedurat për mbështetjen e prodhimit të energjisë nëpërmjet burimeve të rinovueshme. Gjithësesi, vlen të përmendet se ligji ka një qasje të centralizuar në këtë aspekt. Nuk ka parashikime të qënësishme për prodhimin e energjisë në shkallë të vogël dhe kryesisht orientohet tek investime madhore në energji të rinovueshme.

Ndërkohë, kjo gjë vërehet edhe në rolin e marginalizuar që bashkitë kanë në procesin e promovimit të energjive të rinovueshme. Ato nuk kanë kompetenca në këtë fushë dhe kështu i mungojnë dhe mekanizmat për mbështetjen e këtyre nismave.

Në fushën e ujë-sjellës kanalizime, Ligj Nr.8102, datë 28.3.1996 datë 28.3.1996, “Për Kuadrin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i azhurnuar me: Ligjin nr.9352, datë 03.03.2005; Ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 (i ndryshuar me ligjin nr.9845, datë 17.12.2007); Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008, nuk ka ndonjë specifikim përsa i përket aftësisë ripërtëritëse, resilience apo çështjeve të ndryshimeve klimatike. E vetmja gjë që mund të vërehet është tek standartet dhe kushtet teknike ku Enti Rregullator duhet të garantojë ndër të tjera dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndërkohë, VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sanksionon krijimin e AKUM. Përgjegjësia e AKUM-it në fushën e mbetjeve urbane lidhet me planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas fushës

së përgjegjesisë të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, e përcaktuar me vendimin nr. 504/2017, të Këshillit të Ministrave. AKUM-i ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndërmarrjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.


AKUM ndër të tjera ka si kompetencë përgatitjen dhe planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) edhe për sa i përket planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, si dhe për implementimin e tyre, bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale.

Gjithashtu, orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellëskanalizimeve, të ITUN-eve, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre.

AKUM shërben si koordinues dhe asistues i qeverisë, kur kërkohet, dhe i njësisve të qeverisjes vendore për nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe në planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, si dhe ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në këto fusha. Asistenca e AKUM-it në fushën e planifikimit territorial dhe të infrastrukturës së mbetjeve jepet, ndërmjet të tjerave, por pa u kufizuar në, për qendrat e transferimit, investimet në impiantet e incenerimit, në përcaktimin e venddepozitimeve (urbane dhe inerte), për impiantet e riciklimit, të kompostimit dhe të trajtimit të ujërave të ndotura të lëndfillit, për impiantet e trajtimit të gazit, për rehabilitimin dhe mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese etj.

# DOKUMENTE STRATEGJIKE DHE STUDIME TË MËPARSHME

---



### 3.1 DOKUMENTE STRATEGJIKE NË NIVEL KOMBËTAR

#### **Strategjia e Sigurisë Kombëtare /SSK e miratuar me Ligjin nr.103, datë 31.07.2014**

Është dokumenti i parë strategjik në të cilin nënvizohet çështja e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në Shqipëri e lidhur kjo madje edhe me pasojat e ndryshimeve klimatike. Në SSK janë analizuar rreziqet e ndryshme që kërcënojnë RSH-në duke shqyrtuar dy parametra kryesorë: gjasat e shfaqjes së rrezikut dhe pasojat që mund të shkaktojnë për sigurinë kombëtare. Në bazë të kombinimit të këtyre dy parametrave rreziqet janë klasifikuar në tri nivele.

**Në nivelin e parë** janë grupuar rreziqet që kanë gjasa të larta shfaqjeje dhe pasoja të larta në rast se materializohen. Në këtë nivel janë përfshirë *Degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut.*

**Në nivelin e dytë** janë grupuar rreziqet, të cilat ndërthurin gjasa të ulëta dhe pasoja të larta. Në këtë nivel janë përfshirë: *Shfaqje e një pandemie që kërcënon në masë shëndetin publik të popullsisë;*

**Në nivelin e tretë** janë ato rreziqe për sigurinë e vendit, gjasat e shfaqjes së të cilave vlerësohen më të ulëta se niveli i mësipërm ndërsa pasojat për sigurinë kombëtare më të ulëta se niveli i mësipërm.

Në këtë nivel janë përfshirë: *Pasojat e ndryshimeve klimaterike në ekuilibrat natyrorë të RSH-së; Është për tu theksuar se njëri nga objektivat e domosdoshmërisë strategjike 5 – “konsolidimi i sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë”, është Miratimi i Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut ndaj Fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile.*

Ajo çfarë theksohet në SSK për rolin e pushtetit vendor është tek domosdoshmëria strategjike 1 - përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Konkretisht, roli i sanksionuar për pushtetin vendor në objektivin e forcimit të kontrollit të territorit për pushtetin vendor, është ai mbështetës.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim/SKZHI 2015-2020** miratuar me VKM Nr. 348, datë 11.5.2016. SKZHI i cili është dokumenti kryesor strategjik në RSH ka aktualisht kapitullin 8.5 të tij “Forcimi i rendit publik dhe përgatitjes për emergjencat civile” të dedikuar pjesërisht për emergjencat civile/mbrojtjen civile.

SKZHI thekson cenueshmërinë e lartë të Shqipërisë nga fatkeqësitë sikurse shkaqet që kanë përkeqësuar situatën sikurse janë *shpyllëzimet pa kriter, administrimi i dobët i baseneve lumore, niveli i papërshtatshëm i përgatitjes së popullsisë dhe mekanizmat e pamjaftueshme të paralajmërimit dhe monitorimit.* Në veçanti ajo thekson faktin se *ndryshimi i klimës paraqet rreziqe për Shqipërinë në lidhje me shpeshësinë, intensitetin, shkallën hapësinore, kohëzgjatjen dhe kohën e ndodhive ekstreme të motit.* Komunikimi Kombëtar i Shqipërisë, sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës (UNFCCC), identifikon zonat bregdetare dhe burimet ujore, ekosistemet, bujqësinë, energjinë dhe turizmin si sektorët më të prekshëm nga ndryshimi i klimës.

#### **SKZHI identifikon sfidat që konsistojnë në nevojën:**

1. Për transformimin e të gjithë sistemit nga reargues në sistem parandalues në qasjen e tij ndaj emergjencave dhe fatkeqësive.
2. Për integrimin e çështjes së të qenit të përgatitur në strategji dhe plane sektoriale në nivel qendror dhe vendor.



3. Për të forcuar legjislacionin dhe rregulloret që mbulojnë këto fusha.
4. Për të përgatitur një dokument strategjik për përgatitjen për emergjencat.
5. Për të forcuar aftësitë teknike, organizative dhe menaxhuese të institucioneve të ndryshme të përfshira në përgatitjet për emergjencat.
6. Për të forcuar aftësitë reaguese të entiteteve ndaj emergjencave.
7. Për të ngritur në një nivel më të lartë standardet e ndërtimit dhe sigurisë në ndërtesa dhe struktura të tjera.
8. Për të siguruar sigurimin e një tregu sigurimesh të mjaftueshëm dhe me kapital të mirë në rast katastrofash dhe fatkeqësish.

## **Objektivat strategjike në lidhje me uljen e rrezikut të fatkeqësive dhe menaxhimin e mbrojtjes civile**

### **5. Forcimi i uljes së rrezikut të fatkeqësive dhe menaxhimi i mbrojtjes civile nëpërmjet:**

- 5.1. Përgatitjes dhe miratimit të Planit Kombëtar Operacional për menaxhimin e integruar të emergjencave civile.
- 5.2. Përditësimit dhe forcimit të legjislacionit dhe rregullave të lidhura me të, në përputhje me standardet e BE-së.
- 5.3. Forcimit të kapaciteteve të entiteteve të përgatitjes për emergjencat dhe reagimit ndaj fatkeqësive në gjithë Shqipërinë.
- 5.4. Mbledhjes dhe organizimit të informacionit për rreziqet dhe forcimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm.
- 5.5. Rishikimit të tregut të sigurimeve të lidhur me katastrofat.

Aktualisht SKZHI është në process rishikimi, prandaj edhe në kushtet e reja, pas miratimit të ligjit 45/2019 por edhe situatat dhe mësimet e nxjerra pas fatkeqësive të njëpasnjëshme që e kanë goditur Shqipërinë së fundmi, pritet që edhe pasqyrimi i politikave të ZRF dhe mbrojtjes civile të jenë edhe më të qarta, me sfida dhe objektiva të evidentuar qartë në të gjitha sektorët dhe në të gjitha nivelet duke respektuar qasjen e Kuadrit Sendai që çështja e ZRF është çështje e të gjithë shoqërisë. Në SKZHI do të duhet të përcaktohet më mirë parimi i angazhimit të gjithë shoqërisë sikurse dimensionet vendor i politikave të ZRF dhe mbrojtjes civile.

### **Plani Kombëtar i Emergjencave Civile/PKEC i miratuar me VKM Nr.835, datë 3.12.2004**

PKEC është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile i hartuar me asistencën e PNUD në vitin 2004. Sipas vetë PKEC-së; *Në kushtet kur ekziston një bazë ligjore, një strukturë në ngritje dhe përmirësim dhe ku burimet shtetërore janë të kufizuara, planifikimi i përdorimit të kapaciteteve, ndarja mirë e përgjegjësive, identifikimi i boshllëqeve dhe shmangia e mbivendosjeve është mjaft e nevojshme. Këto kërkesa bëhen realitet nëpërmjet PKEC-së, që ofron mundësi për menaxhim efektiv të strukturave shtetërore dhe joshtetërore për përballimin e emergjencave civile. PKEC-ja duhet të shihet si dokument praktik, i hartuar nëpërmjet një procesi të gjatë konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët me një numër të gjerë institucionesh qeveritare dhe joqeveritare, për ta mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur me ndryshimet e mjedisit shqiptar, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar: mbrojtjen e popullsisë, të pronës dhe të trashëgimisë kulturore nga emergjencat civile.*

PKEC, edhe pse i hartuar vite më parë dhe i papërditësuar asnjëherë deri më sot, përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve në të gjitha fazat e menaxhimit të fatkeqësive që janë parandalim - parapërgatitje/gatishmëri - përgjigje/reagim - riaftësim/ rimëkëmbje.

Fatkeqësisht, në PKEC sikurse edhe në ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001, i ndyshuar, nuk janë reflektuar politikat ndërkombëtare të asaj kohe mbi zvogëlimin e riskut të fatkeqësive edhe pse në kohën e përgatitjes së tyre ka qenë një kuadër ndërkombëtar respektiv- Strategjia dhe Plani i Veprimit Yokohama për një Botë më të Sigurt, 1995-2005<sup>13</sup>.


Një ndër problemet që hasen në zbatimin e PKEC-së janë referencat ndaj institucioneve apo strukturave qendrore dhe vendore, një pjesë e të cilave kanë ndryshuar emërtim, nuk ekzistojnë më apo janë çvendosur nga pozicioni i mëparshëm. Gjithësesi, testimi i PKEC-së gjatë situatave reale të emergjencave nuk ka rezultuar me ndonjë problematikë të veçantë të shkaktuar prej faktit që ai është dokument i papërditësuar.

Është për tu theksuar fakti, që në të gjithë përmbajtjen e tij, PKEC i jep rëndësi të veçantë rolit të pushtetit vendor, duke respektuar në fakt parimin e subsidiaritetit në menaxhimin e emergjencave civile. Në të kaluarën është evidentuar qartë nevoja për rishikimin e PKEC-së me qëllim përditësimin e përgjithshëm të tij me kushtet e reja të krijuara. Aktualisht, sipas ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, PKEC miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Rishikimi i PKEC është evidentuar si prioritet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe si i tillë ai është përfshirë në masat afatmesme dhe afatshkurtra të buta dhe teknike të Rimëkëmbjes së Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zvogëlimin të Riskut të Fatkeqësive, të Raportit të Nevojave pas Fatkeqësisë 2019<sup>14</sup>

### Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit është dokumenti më i lartë në hierarkinë e planifikimit bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Ky plan, është hartuar për herë të parë në Shqipëri në periudhën 2014-2016 dhe është miratuar nga KKT në 14.12.2016. Plani bazohet në objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB dhe i përkthen ato në territorin Shqiptar. Vizioni i PPKT është “Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor European, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkurruese në hapësirën ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Siguron mbrojtje të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin

FIG 3. Rreziqet e Sistemit Urban



Burimi: AKPT & MZHU, (2016, faqe 73)

13 Strategjia e Yokohama dhe plani i veprimit për një botë më të sigurt u miratua në vitin 1994 pas Konferencës Botërore të Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore, mbajtur në Yokohama, Japoni. Është dokumenti i parë që ofron udhëzime në nivel ndërkombëtar për përgatitjen dhe parandalimin dhe zbutjen e impakteve të fatkeqësive. Strategjia e Yokohama ishte një produkt i Dekadës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore (1990-2000) dhe më konkretisht, i Konferencës Botërore për Zvogëlimin e Fatkeqësive Natyrore të mbajtur në vitin 1994.

14 Faqe 112 e Volumit B, Albania Post Disaster Needs Assessment

për t'u shndërruar në një destinacion autentik". PPKT ka një analizë të përgjithshme të rreziqeve që i kanosen kryesisht sistemit urban nga përmbytjet, tërmetet dhe fenomene të tjera gjeologjiko-inxhinierike apo klimatike:


PPKT gjithashtu identifikon se një ndër problematikat kryesore përse i përket përmbytjeve është amortizimi dhe mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit të kullimit. Përtej kësaj identifikohen edhe çështje të tjera si shpyllëzimet, erozioni dhe nxjerrja e pakontrolluar e inerteve. Gjithashtu, PPKT ka dhe një kapitull të dedikuar përse i përket çështjeve të ndryshimeve klimatike. Ky kapitull, kryesisht është i bazuar në të dhëna nga komunikimi i III-të i ndryshimeve klimatike i Shqipërisë. Në përgjithësi, PPKT propozon disa masa të cilat mund të ndërmerren për zbutjen e impaktit të ndryshimeve klimatike dhe kryesisht mbrojtjen ndaj përmbytjeve të tilla si përmirësimi i fashave ripariane të lumenjve, disiplina e nxjerrjes së inerteve, pyllëzime dhe mbjellje bimësie, si dhe përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës së kullimit dhe mbrojtjes ndaj përmbytjeve me kushtet e reja.

### Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin

PINS Bregdeti është hartuar në paralel me PPKT në periudhën 2014-2016. Ky plan mbulon të gjitha bashkitë të cilat kanë dalje në bregdet dhe rrjedhimisht edhe Bashkinë Lezhë. PINS Bregdeti është një detajim i politikave të PPKT për territorin bregdetar i cili ka karakteristika të veçanta dhe shihet si një hapësirë prioritare për zhvillimin e ekonomisë e veçanërisht turizmit. Vizioni i PINS Bregdeti është *"Bregdeti si binomi det-tokë, aset i rëndësishëm kombëtar dhe pjesë e integruar e rrjetit mesdhetar. Hapësirë e mirëmenaxhuar, ku harmonizohen nevojat për zhvillim ekonomik dhe nevojat lokal me domosdoshmërinë e mbrojtjes së aseteve kulturore, natyrore dhe historike destinacion autentik, shumëllojshëm dhe i pastër"*.

Përse i përket rreziqeve, ai i përmbytjes është thelbësori i përmendur edhe në PINS. Në këtë rast, edhe për bashkinë Lezhë, përse i përket përmbytjeve identifikohen rreziqet nga Drini e Mati si dhe nga kripëzimi i tokave në Shëngjin dhe Ishull Lezhë si rrjedhojë e avancimit të detit. Ndër masat e propozuara në këtë aspekt janë pyllëzimet si dhe ndërgjegjësimi i banorëve dhe autoriteteve ndaj këtyre rreziqeve. Gjithashtu, PINS Bregdeti, udhëzon bashkitë, që gjatë hartimit të PPV-ve të shmangin alokimin e përdorimeve të tokës për qëllime ndërtimi në zona të rrezikuara. Gjithashtu, PINS Bregdeti udhëzon bashkitë që në PPV-të e tyre të marrin masa për zbutjen e impaktit të ndryshimeve klimatike. Këto masa fokusohen sa në reduktimin e emetimeve të gazrave serë, në përdorimin e energjiive të rinovueshme dhe në rritjen e efikasitetit energjitike, si dhe në pyllëzime, dhe në kufizimin e zgjerimit të zonave urbane drejt hapësirave të rrezikuara.

FIG 4. Sistemi Ujor dhe Rreziku i Përmbytjes



### 3.2 PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë, me financim nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe me mbështetje teknike nga UTS-01 ka hartuar planin e përgjithshëm vendor gjatë periudhës 2016-2018. Ky plan më pas është miratuar në Këshill Bashkiak dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit. PPV Lezhë është i përbërë nga tre dokumente thelbësore si Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Plani i Zhvillimit të Territorit dhe Rregullorja. Përtej këtyre tre dokumenteve, janë hartuar dhe Plani i Investimeve Kapitale dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor. Vizioni i gjerë i PPV e shikon zhvillimin e territorit të Bashkisë Lezhë të ndarë në pesë fasha kryesore si zona bregdetare, ultësira bujqësore, korridori infrastrukturor, sistemi urban përgjatë rrzës së maleve, zona malore përballë detit dhe ajo e brendshme:

Vizioni është konceptuar në mënyrë të tillë ku secila fashë përkufizohet si një peizazh me karakteristika homogjene, ndërkohë që qëllimi është integrimi dhe zhvillimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme. Integrimi në këtë rast mund të jetë ekonomik, ekologjik ose infrastrukturor. Rritja e bashkëveprimit dhe njëkohësisht ruajtja e karakteristikave përkatëse e plotësuese të peizazheve do të garantonte një zhvillim të qëndrueshëm të territorit:

Përsa i përket objektivave strategjike dhe ndërhyrjeve të lidhura me rreziqet natyrore, mund të përmenden:

- Mbrojtja dhe zgjerimi i biodiversitetit të territorit;
- Reduktimi dhe zbutja e impaktit të vendbanimeve urbane ekzistuese në brendësi të zonave të mbrojtura natyrore, veçanërisht në afërsi të rezervatit natyror Kune-Vain; Zvogëlimi progresiv dhe shuarja në harkun e 15 viteve e niveleve aktuale të ndotjes së lumenjve dhe bregdetit;
- Fuqizimi dhe përmirësimi i sistemeve aktuale të funksionimit dhe menaxhimit

FIG 5. Vizioni i Bashkisë Lezhë



Burimi: Bashkia Lezhë & UTS-01 (2016)

FIG 6. Vizioni Territorial



Burimi: Bashkia Lezhë & UTS-01 (2016)

- të ciklit të mbetjeve urbane;
- Fuqizimi dhe përmirësimi i rrjeteve teknike urbane, në veçanti rrjeti i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;
  - Rimëkëmbja e funksionalitetit të rrjeteve të kanaleve të ujitjes dhe vaditjes së tokave bujqësore dhe hidrovoreve. Kjo edhe si masë mbrojtëse ndaj fenomeneve përmbytëse;
  - Shtimi i sipërfaqeve pyjore në zonat kodrinore, malore dhe bregdetare;
  - Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjetit ekologjik territorial, si lidhje strukturale mes zonave me vlera dhe pasuri të madhe biodiversiteti;
  - Ulja dhe, me kohën, eliminimi total i aktiviteteve të nxjerrjes së inerteve përgjatë lumenjve;
  - Fuqizimi i sistemeve të menaxhimit dhe të shpërndarjes së ujërave publike, si të mira të përbashkëta;
  - Rikuperimi dhe fuqizimi i hidrovoreve në shërbim të rrjetit kullues të ultësirës bujqësore;
  - Rikuperimi dhe fuqizimi i rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese të ultësirës bujqësore;
  - Krijimi i kadastrës së puseve ujore, publike dhe private, për një kontroll më të mirë të aktivitetit të tyre.
  - Përshtatja sipas standardeve të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar të pajisjeve urbanistike primare (ujë, kanalizime, energji elektrike etj.) në zonat urbane dhe në vendbanimet informale të legalizuara
  - Përshtatja sipas standardeve të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar të pajisjeve urbanistike dytësore (kopshte, shkolla, gjelbërim, parkime etj.);
  - Hartimi në një kohe të shkurtër i Planit të Emergjencave Civile në përputhje me standardet bashkëkohore ndërkombëtare
  - Fuqizimi dhe zhvillimi i rrjeteve të transportit energjetik, duke pasur kujdes në impaktet e prodhuara (ndotja elektromagnetike) dhe duke pasur parasysh zhvillimin e burimeve të energjisë së rinovueshme;
  - Zhvillimi i sistemeve të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme në fushën urbane dhe në mbështetje të impianteve industriale ekzistuese dhe të aktiviteteve kryesore ekonomike (hidrocentralet, energjia e erës, panelet fotovoltaike dhe diellore, gjeotermia etj.);

### 3.3 PLANE TË MËPARSHME EMERGJENCASH

Përveç Planit Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me VKM nr.835, datë 3.12.2004, ekzistojnë edhe:

- Planet e emergjencave në 12 prefekturat e vendit të cilat kanë qenë të miratuara shumë vite më parë dhe janë rishikuar në vite nga ekspertët e sektorëve përkatës të emergjencave civile. Hera e fundit që planet e 12 prefekturave u rishikuan është periudha 2017-2018 në kuadër të nënkomponentit “B2” “Rritja e kapaciteteve të planifikimit të menaxhimit të emergjencave” të Projektit “Përmirësimi i Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimit të Përmbytjeve” të financuar nga BE. Në kuadër të aktiviteteve të PRO NEWS, në datën 26.09.2018, në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë u organizua një ëorkshop mbi “Udhëzimet dhe planifikimin e emergjencave” me pjesëmarrjen e përgjegjësve të Sektorëve të PPEC&K në Institucionët e Prefektit të Qarqeve Shkodër, Kukës, Dibër e Lezhë, si dhe Drejtorët e Përgjegjës të Sektorëve të PPEC&K të Bashkive në këto qarqe.
- Plani i Emergjencave Civile i Qarkut Lezhë analizon dhe trajton këto rreziqe: tërmetet; përmbytjet dhe çarjet e digave; rreshjet e dëborës; zjarret në pyje, kullota dhe banesa; rrëshqitjet e tokës; rreziqet teknologjike; epidemitë; baticat detare(erozionin) dhe rreziqet

nga aktet terroriste dhe të dhunshme. Ai analizon gjithashtu ekspozimin ndaj rreziqeve, vulnerabilitetin sikurse kapacitetet ekzistuese dhe masat që duhen marrë në parandalim dhe lehtësim, parapërgatitje dhe mbrojtje, përgjigje dhe rikthim në gjendje normale. Plani analizon edhe një skenar përmbajtjeje në territorin e qarkut i cili shkaktohet nga reshjet me intensitet të lartë. Skenari zhvillohet me përcaktimin e detyrave konkrete të institucioneve vendore dhe degëve territorial në gatishmëri dhe përgjigje.

- Plani i Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, Bashkia Lezhë. Ky plan ka ndjekur përgjithësisht strukturën e Planit të Emergjencave Civile të Qarkut Lezhë. Si i tillë a analizon rreziqet kryesore prezente në territorin e bashkisë që janë të njëjtat si në rastin e qarkut, ekspozimin ndaj rreziqeve, vulnerabilitetit sikurse kapacitetet ekzistuese dhe masat që duhen marrë në parandalim dhe lehtësim, parapërgatitje dhe mbrojtje, përgjigje dhe rikthim në gjendje normale. Plani nuk ka trajtuar ndonjë skenar rreziku nga fatkeqësitë.

### 3.4 STUDIME NË BASHKINË LEZHË

Dokumentat kryesor me karakter studimor, strategjik e planifikues që kanë lidhje direkte me territorin e Bashkisë së Lezhës dhe që janë hartuar në 20 vitet e fundit po i paraqesim në mënyrë të përmbledhur sipas kronologjisë së hartimit të tyre.

#### A. DOKUMENTA QË I TRAJTONË ÇESHTJET NË NIVEL RAJONAL NË TË CILËN PËRFSHIHET BASHKIA E LEZHËS

##### Plani i Zhvillimit Rajonal Shkodër – Lezhë (2005 -2020)<sup>15</sup>

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë pothuajse paralel dhe në harmoni me “Projektin e Legjislacionit dhe Planifikimit të Mjedisit” të përfunduar nga KE (ELPA). Dokumenti shërben si udhëzues për planet lokale. Ky plan propozon 67 projekte që përfshijnë një larmi temash. Ky plan ka karakterin e një plani strategjik dhe përfshin territorin e Qarkut Shkodër dhe Lezhë dhe gjithashtu trajton korridoret kryesore rajonale, kryesisht me Kosovën dhe Malin e Zi. Plani rajonal për zhvillimin e rajonit Shkodër - Lezhë për periudhën 2005 - 2020, është aprovuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë. Në përputhje me këtë dokument janë bërë ndërtimi i rrugëve, furnizimi me ujë, administrimi i mbeturinave, forcimi institucional, përgatitja e planit lokal, etj.

##### Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis, Delta e Lumit Drin<sup>16</sup>, Shkodër – Lezhë, 2006

Plani bën një analizë të gjendjes së mjedisit si dhe të ndërveprimit të të gjithë faktoreve mjedisor në këtë zonë. Pjesë e këtij plani janë dhe masat e parashikuara për zbutjen e ndikimeve në mjedis duke përcaktuar në detaje të dhëna për zbatimin e tyre. Ky plan ka shërbyer dhe si studim strategjik mjedisor për disa masterplane zhvillimi që kanë të bëjnë me zonën e deltës së Lumit Drin. Është miratuara nga Këshilli i Qarkut Lezhë.

<sup>15</sup> Plani rajonal Shkodër-Lezhë (2005-2020) është hartuar nga kompania konsulente EPTISA në vitin 2005. Ky plan rajonal strategjik u porositi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe u financua nga Komisioni Europian.

<sup>16</sup> Mbeshtetur nga Komisioni Europian, Projekti ELPA,

### Plani i Menaxhimit të Basenit të Lumit Mat<sup>17</sup> (8 Maj 2010).

Për përshtatjen e ardhëshme me kërkesat e Direktives Kuader të Ujit (DKU) të BE, Shqipëria duhet të përgatisë planet e menaxhimit për qarqet e baseneve lumore që janë ngritur në vend. Plani pilot për menaxhimin për basenin e lumit Mat është përgatitur si pjesë e projektit për Implementimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri. Ky plan menaxhimi, si çështje kryesore ka përshkrimin e programit të masave që nevojiten për të arritur statusin e gjëndjes së mirë ekologjike sipas objektivave gjithëpërfshirëse të direktives dhe objektivave specifike për trupat ujorë dhe zonat e mbrojtura. Rëndësi të veçantë i kushtohet dhe analizës së rrezikut të mos arritjes së statusit të mirë ekologjik dhe verifikimit nëpërmjet monitorimit, para se të sigurohet marrja e vendimit për programin e masave.

### Ndryshimet klimatike në Deltat e Lumit Drin dhe Mat<sup>18</sup>

Projekti "Identifikimi e zbatimi i masave përshtatëse në deltat e lumejve Drin e Mat", ka si produkt dy dokumenta kryesore:

- Përshtatja me ndryshimet klimatike në deltat e lumit Drin dhe Mat (Dokument i Politikave), 2013;
- Identifikimi dhe zbatimi i masave përshtatëse në deltat e lumenjve Drin - Mat (Projekt Raporti i përmbledhur), 2013.

Dokumenti i politikave ka si objektiv kryesor përfshirjen e ndryshimeve klimatike në strategjitë e politikave kombëtare dhe integrimin në kuadrin e planifikimit të territorit. Ky dokument është bazuar kryesisht në konsultime me ministritë dhe agjencitë në nivel qendror dhe pavarësisht se fokusohet në deltat e lumenjve Drin dhe Mat, jep rekomandime strategjike për të gjithë zonat e rrezikuara në vendin tonë. Zbatimi i rekomandimeve të këtij dokumenti, veç të tjerave, mbetet mjaft kritik për të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme, përshtatjen pro-aktive ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

Raporti përmbledhës përfshin të gjitha produktet e ekspertizës së realizuar në kuadrin e këtij projekti në lidhje me identifikimin e rreziqeve nga efektet e ndryshimeve klimatike në zonën e Deltave të Lumejve Drin e Mat, vlerësimin, trajtimin e tyre dhe marrjen e masave përshtatëse ndaj këtyre rreziqeve, analizuar në të gjithë spektrin mjedisor e social ekonomik. Rëndësi të veçantë paraqesin dhe zhvillimi i skenarëve të ndryshimeve klimatike e projeksionet që paraqesin ato për të ardhmën.

### Koncepti i Zhvillimit Rajonal Lezhë<sup>19</sup>, 2010

Dokumenti e trajton konceptin bazuar në idetë e Zhvillimit Rajonal European për të bërë sa më eficientë përdorimin maksimal të burimeve lokale, aseteve dhe kapaciteteve që ndihmojnë në zhvillimin e ekonomise lokale si dhe nëpërmes saj të kontribohet në ndalimin e eksodit rural të popullsisë.

17 Ky raportu përgatit nga udheheqesi i grupit të punës për Grontmij/CarlBromeinisiativen dhe financimin e Bashkimit European CARDS 2006.

18 Projekti "Identifikimi e zbatimi i masave përshtatëse në deltat e lumejve Drin e Mat", financuar nga PNUD (Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara) dhe GEF (Global Environment Fund - Fondi Global i Mjedisit) me mbështetjen e Qarkut Lezhë, në vitin 2009 - 2013. Dy dokumentet e prodhuar nga ky projekt nuk janë miratuar në ndonjë institucion lokal apo qendror. Ato kanë thjesht karakter orientues për sfidat kryesore me të cilat përballet vendi ynë nga ndryshimet klimatike

19 Koncepti i Zhvillimit Rajonal Lezhë, është një dokument strategjik i hartuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë, me mbështetjen GTZ, në periudhën 2009-2010. Ekspertiza teknike, përveç Zyrës së Programim-Zhvillimit pranë Qarkut Lezhë, është siguruar edhe nga ekspertë ndërkombëtarë kryesisht Gjermania dhe Sllovenia.

**Strategjia e Turizmit dhe agroturizmit në Qarkun Lezhë<sup>20</sup> (2013)**

Dokumenti vlerëson në mënyrë analitike resurset njerëzore, natyrore, historiko – kulturore, për t'i kthyer ato në produkte turistike për tregun rajonal dhe synon ngritjen e kapaciteteve njerëzore në funksion të rritjes së kulturës së shërbimit në nivelin e standarteve ndërkombëtare. Po ashtu dokumenti synon thithjen e investitorëve të huaj e vendas për përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e punësimit, rritjen ekonomike, përmirësimin e jetesës dhe uljen e varfësisë. Nepermes këtij dokumenti synohet dhe nxitja e bashkëpunimit mes sektorit privat e publik për zhvillimin e turizmit dhe për ta bërë rajonin e Lezhës një potencial konkures në tregun turistik kombëtar.

**Plani Rajonal i administrimit të pyjeve e kullotave për Qarkun e Lezhës<sup>21</sup> (2013)**

Plani rajonal i administrimit të pyjeve dhe kullotave për Qarkun e Lezhës, bëhet në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave në Shqipëri. Qëllimi i këtij dokumenti është që fondi pyjor të mos i lihet zhvillimit spontan, por në procesin e manaxhimit dhe të administrimit të tij, të përdoren metodat bashkëkohore, të cilat kanë dhënë rezultate edhe në vendet e tjera, në ruajtjen, përmirësimin e shtimin e këtij fondi.

**B. DOKUMENTA KRYESORË PËR BASHKIA E LEZHËS****Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, Komuna Shëngjin<sup>22</sup>, 2006.**

Dokumenti, pasi analizon situatën social ekonomike e mjedisore, përcakton problematikat për çdo sektor, vlerëson mundësitë dhe kapacitetet dhe përcakton masat për zgjidhjen e përmirësimin e situatës. Në këtë kuadër, dokumenti ka si qëllim të ndihmojë këtë komunë me vlera të larta natyrore për tu zhvilluar drejt zhvillimit në mënyrë të qëndrueshme dhe për të imponuar menaxhimin e atyre vlerave natyrore, që kanë të bëjnë me rreziqet dhe pengesat që ngadalsojnë këtë zhvillim.

**Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur Kune Vainit, 2009<sup>23</sup> (Për periudhën 2010-2010).**

Qëllimi i përgjithshëm i planit të menaxhimit Kune – Vain, është ruajtja dhe mbrojtja e integritetit të peizazheve, habitateve dhe biodiversitetit të një ekosistemi mesdhetar ligatinor. Në këtë plan janë përcaktuar zonat e menaxhimit që perfaqesojnë njesitë e sipërfaqes të klasifikuara sipas planeve të përdorimit të tokës duke respektuar objektivat e konservimit dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm. Si kategori të menaxhimit të zonuar janë përdorur ato të Medëet, modelet e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe parashikimeve të legjislativës. Në planin e menaxhimit për këtë zonë janë përcaktuara dhe të gjitha veprimet për tu realizuar të ndara në 12 kapituj.

20 Ky plan është hartuar e publikuar nga Keshilli i Qarkut të Lezhës, nga specialistet e grupe pune në nivel Qarku.

21 Ky plan është hartuar e publikuar nga Keshilli i Qarkut të Lezhës, nga specialistet e grupe pune në nivel Qarku.

22 Dokumenti është përgatitur në kuadër të projektit CARDS "ELPA" (Environmental Legislation and Planning Project), financuar nga Komisioni Europian, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyetjeve dhe Administrimit të Ujrave, në vitin 2006 nga Jacobs&Louis Berger S.A., Regional Environmental Center (REC) – Tirana, Albania.

23 Mbeshtetur nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare, hartuar nga Qendra e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis, Tiranë 2009.

Ky plan është parashikuar për periudhën 2010-2010



### *Planit i Zhvillimit Lokal, Shënkoll<sup>24</sup>, 2009.*

Plani paraqet nevojave afatgjatë të një komuniteti dhe identifikon strategjinë më të mirë për t'i adresuar këto nevoja. Në mënyrë strategjike ky plan vlerëson burimet, dhe shpërndarjen më të mirë të këtyre burimeve në funksion të zgjidhjes së problemeve që shqetësojnë komunitetin.

### *Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm<sup>25</sup> 2013-2030*

Dokumenti përbëhet nga një kornizë politikash multi sektoriale që i mundësojnë qytetit, komunitetit dhe partnerëve, koordinimin e përpjekjeve dhe burimeve për të siguruar rritje të qëndrueshme sociale e konkurrueshmëri rajonale. Po kështu ky dokument ofron politika për një integrim të shpejtë në hapësirën kombëtare e evropiane, zhvillimin e një qyteti kulturalisht të integruar, ekologjikisht të qëndrueshëm dhe një komuniteti shoqërisht gjithëpërfshirës.

### *Zona Funktionale Lezhë<sup>26</sup>*

Dokumenti analizon potencialet e zhvillimit të zonës funksionale, duke identifikuar tiparet e përgjithshme të zhvillimit të saj ekonomik dhe mundësive të krijimit të vlerës së shtuar në zhvillim nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkimit të burimeve midis njësive vendore ekzistuese. Koncepti i zonës funksionale sipas reformes territoriale të kryer në Shqipëri gjatë vitit 2014, ndërtohet mbi strukturën ekonomike dhe sociale të territorit dhe identifikohet kryesisht nëpërmjet lëvizjeve për punësim, potencialit ekonomik dhe zinxhirit të vlerës, disponibilitetit të shërbimeve dhe rrjetit të infrastrukturës fizike.

### *Vlerësimi Strategjik Mjedisor, 2016, (Planit i Përgjithshëm Vëndor, Bashkisë – Lezhë)*

Ky dokument është hartuar paralelisht me procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vëndor, proces i cili ka filluar në Janar 2016. Në këtë raport janë marrë parasysh të gjitha ndikimet që mund të kenë në mjedis propozimet e bëra nga Plani i Përgjithshëm Vëndor (PPV) për të gjithë territorin që administron Bashkia Lezhë. Hartimi i këtij raporti është mbështetur mbi bazën e konsultimeve të kryera me specialistë të institucioneve përkatëse dhe me grupet e interesit, siç është parashikuar nga legjislacioni në fuqi (Ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”). Ky dokument shërben si instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik.

24 Është mbështetur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit e realizuar nga grupi lokal i punes

25 Është hartuar nga Bashkia Lezhë me mbështetje metodologjike nga Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG), dhe me mbështetje financiare nga LGI/SOROS, Budapest dhe Programi i Kombeve të Bashkuara, UNDP, Tiranë

26 Ky dokument është hartuar në kuadrin e programit dldp 3 të zbatuar nga Helvetas me mbështetje të Qeverisë Zvicerane, hartuar Tetor - Shkurt 2014.

# VLERËSIMI I RREZIKUT DHE RISKUT NË BASHKINË LEZHË



## Ky kapitull bën një përmbledhje të analizës së rrezikut dhe vlerësimit të riskut, të kryer në dokumentin respektiv.

Risku i fatkeqësive është humbja e mundshme e jetës, lëndimi ose pasuritë e shkatërruara ose të dëmtuara që mund t'i ndodhin një sistemi, shoqërie ose një komuniteti në një periudhë specifike kohore, të përcaktuar në mënyrë të mundshme si një funksion i riskut, ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit. (Raporti i Grupit të Hapur Ndërqeveritar të Punës së Ekspertëve për treguesit dhe terminologjinë në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, 2016).


Kjo strategji ka marrë në konsideratë një kombinim metodash vlerësimi të riskut, po duke u bazuar kryesisht në metodën me bazë treguesish:

Ky sistem lejon që të zhvillohet një vlerësim më gjithëpërfshirës, duke përfshirë vulnerabilitetin dhe kapacitetin social, ekonomik dhe mjedisor. Procesi i vlerësimit është ndarë në 4 komponentë, si:

- Rreziku
- Ekspozimi ndaj rrezikut
- Vulnerabiliteti
- Kapaciteti

Për secilin element, është caktuar një numër indikatorësh që do përbëjnë bazën e vlerësimit, psh për rrezikun, tipi, probabiliteti dhe shkalla e madhësisë së rrezikut, për ekspozimin: numri i ndërtesave, popullsia, etj, e kështu me rradhë. Për secilin indikator bëhet një vlerësim nga 0 në 1, bazuar mbi të dhëna sasiore, ose cilësore / subjektive. Në fund bëhet pikëzimi i riskut dhe hartëzimi respektiv i tij.

FIG 7. Vlerësimi Bazuar në Tregues



Burimi: Përshtatur nga autorët

Si fillim është kryer analiza e rreziqeve, duke konsideruar intensitetin e tyre, frekuencën dhe probabilitetin e ndodhjes, kalendarin historik e sezonal, etj. Më tej, nëpërmjet vlerësimit shumë-rrezik dhe shumë-sektorë, është kryer nëpërmjet metodës GIS analiza e cënueshmërisë dhe elementëve në risk (pra sa ndikohen nga rreziku elemente të ndryshëm, dhe sa të cënueshëm janë ata). Ky vlerësim është kryer në bazë të 5 kriterëve:

- ndikimit fizik (ndikimi në ndërtesa, mjedis të ndërtuar, struktura socio-ekonomike; infrastruktura etj)
- ndikimi social (analizë e vulnerabilitetit social kundrejt riskut nga një rrezik i caktuar)
- ndikimi ekonomik (ndikimi që një fatkeqësi e caktuar natyrore/ biologjike mund të ketë mbi strukturat që zhvillojnë aktivitete ekonomike në Lezhë)
- ndikimi mjedisor (ndikimi që një fatkeqësi e caktuar mund të ketë në zona mjedisore, zona të mbrojtura, monumente natyre, brigje ujore, trupa ujqorë, dhe çdo element tjetër mjedisor)
- ndikimi kulturë (ndikimi në trashëgiminë kulturore dhe historike)

Studimi trajton rreziqet sipas skemës së mëposhtme:





FIG 9. Konkluzione të Analizës së Cënueshmërisë sipas Njësive Administrative dhe Rrezikut



Burimi: Co-PLAN, PNDU, Bashkia Lezhë (2020)

Siç mund të dallohet nga më sipër, ekspozimi më i lartë nga përmytjet është në njësitë administrative Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldren dhe në qytet Lezhë. Rreziku më i lartë nga rrëshqitjet e tokës është në zonën e njësive administrative Kolsh, Zejmen, Lezhë dhe në Shëngjin e Balldren përveçse i përket rënies së gurëve. Rreziku më i madh nga zjarret është në njësitë administrative Kallmet e Ungrej. Kjo vjen si rezultat i masiveve të mëdha pyjore dhe duke faktorizuar rritjen e thatësirave e të temperaturave si rezultat i ndryshimeve klimatike. Vulnerabiliteti më i madh nga rreziku i erës gjendet në njësitë administrative Balldren, Shënkoll e Shëngjin, ndërkohë që nga dëborat është në njësinë administrative Ungrej. Përveçse i përket rrezikut të pandemisë, cënueshmëria më e madhe është në njësitë administrative Ungrej, Kolsh, Zejmen si rezultat i kombinimit të faktorëve moshë popullore, aksesueshmëri dhe ndihmë ekonomike.

Për secilin risk, është vlerësuar pikëzimi total sipas formulës së përdorur në metodologji, dhe është hartuar matrica e riskut, e cila shërben si bazë për hartëzimin.

TABELA 1. Tabela finale e pikëzimit për secilin rrezik, nisur nga indikatorët dhe 4 komponentët e riskut


	Rreziku (probabiliteti /frekuenca)	Ekspozimi (elementet ne risk)	Cënueshmëria	Kapacitetet
Permytje	1.50	1.28	<b>1.79</b>	<b>1.27</b>
Gjeorrezije	1.67	0.79	<b>1.83</b>	1.58
Rrezik sizmik	<b>2.00</b>	1.06	1.28	1.39
Rrezik meteorologjik	<b>2.17</b>	0.92	2.06	1.92
Rrezik zjarri	2.17	<b>2.33</b>	1.83	1.67
Pandemi	2.60	0.58	1.90	2.67
Ndryshimet klimatike	<b>1.92</b>	1.17	1.51	<b>1.00</b>

Burimi: Co-PLAN, PNUD, 2020

Sic shihet nga tabela e mësipërme, për pjesën më të madhe të rreziqeve problemi kryesor është frekuenca e shpeshtë e ngjarjes së tyre. Ekspozimi është mjaft i lartë në rastin e rrezikut nga zjarri, i cili konsideron skenarin kur ka zjarrvënje në gjithë sipërfaqet pyjore. Ndërkaq, në çështje kapacitetesh, duket se ndryshimet klimaterike shfaqin nivel shumë të ulët parapërgatitjeje, bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi mes komuniteteve dhe autoriteteve vendore. Ndërkaq, duke u bazuar edhe në matricën e mëposhtme, risku është konsideruar si produkt i impaktit me probabilitetin. Kapaciteti konsiderohet si faktor ndikues vetëm në disa raste.

Si përfundim, në këndvështrimin multi-risk, efektet në territor paraqiten në figurën më poshtë:

FIG 10. Harta multi-rrezik në territor, ekspozimi dhe elementët e riskuar




Burimi: Co-PLAN,2020

Sakaq, në aspekt të riskut vërehet mbivendosje e sipërfaqeve të riskut shumë të lartë, me ato të riskut të lartë. Këto tre risqe (zjarret, përmytjet dhe efektet meteorologjike) evidentohen në Njësinë Balldren, Shëngjin dhe Shënkoll.

Edhe qendra e Lezhës ndikohet nga disa rreziqe të njëhershme, me risk të lartë, të moderuar, shumë të lartë dhe të ulët. Kjo pasqyre e risqeve në Bashki tregon se hapat e ndjekur më tej, për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve, si dhe për hartimin e zbatimin e një plani masash efektiv, janë thelbësore për zhvillimin 'resilient' të bashkisë në periudhën afatgjatë.

FIG 11. Harta multirisik



Burimi: Co-PLAN, PNUD, 2020

# VIZIONI DHE OBJEKTIVAT





Vizioni i Strategjisë së ZRF për Bashkinë Lezhë është hartuar në bashkëpunim me Komisionin e Mbrojtjes Civile në bashki, dhe në konsultim me grupet e ndryshme të interesit. Ky vizion, edhe pse afatgjatë, synon të përmirësojë dhe udhëzojë politikatat e ZRF si dhe politikatat e tjera sektoriale.

**“ Bashkia Lezhë një bashki me një zhvillim të qëndrueshëm dhe e aftë për të përballuar fatkeqësitë natyrore dhe të tjera. Një komunitet i informuar dhe i angazhuar, i cili bashkëvepron në mënyrë ndër-institucionale e ndër-komunitare për të zvogëluar riskun e fatkeqësive. Një bashki e mirë-koordinuar, me sensibilizim dhe ndërgjegjësim të lartë për parapërgatitjen, zvogëlimin, përballimin dhe rimëkëmbjen pas fatkeqësive. Bashkia Lezhë, si një model i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbatimit të Kuadrit Sendai në Shqipëri. ”**

Në përputhje me vizionin e përgjithshëm të strategjisë së ZRF, me parimet e kuadrit SENDAI, dhe me ciklin e menaxhimit të fatkeqësive, Bashkia Lezhë ka hartuar objektivat strategjike të mëposhtme:

- OS1** *Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për ZRF*
- OS2** *Ngritja e kapaciteteve institucionale e financiare të Bashkisë Lezhë për ZRF*
- OS3** *Zbutja e Riskut të Fatkeqësive nëpërmjet ndërhyrjeve dhe masave në territor*
- OS4** *Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente*

Siç u përmend dhe më sipër, objektivat strategjike janë të lidhura drejtpërdrejt me ciklin e menaxhimit të fatkeqësive. Tabela e mëposhtme, tregon lidhjen e objektivave me fazat e ndryshme të ciklit të menaxhimit të fatkeqësive:

**TABELA 2.** Lidhja e objektivave strategjike me fazat e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive

	OS1	OS2	OS3	OS4
Parandalimi				
Gatishmëria				
Përgjigjja				
Rimëkëmbja				

## 5.1 OBJEKTIVAT DHE MASAT PËR ZRF

### **OS1: Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për ZRF**

Të kuptuarit të risqeve nga komuniteti dhe bashkëveprimi me komunitetin për ZRF është një ndër hallkat kryesore.

#### **OS1.1 Informimi i Komunitetit**

Në këtë rast, duke marrë në konsideratë nivelin e ulët të kuptimit dhe angazhimit të komunitetit, është e nevojshme një fushatë e vazhdueshme, koherente dhe e madhe nga ana e bashkisë. Gjatë hartimit të ZRF, procesi i planifikimit me pjesëmarrje ka qënë një hallkë e rëndësishme edhe për informimin e ndërgjegjësimin e komunitetit, por kjo punë duhet të jetë e vazhdueshme nga bashkia. Komuniteti duhet të informohet e ndërgjegjësohet për risqet e shumta me të cilat përballlet territori i Bashkisë Lezhë.

**OS1.2 Ndërgjegjësimi i Komunitetit**

Një pjesë e rëndësishme e ndërgjegjësimit të komunitetit lidhet edhe me veprime të cilat mund të kryhen nga qytetarët dhe që garantojnë një zvogëlim të riskut nga fatkeqësi të ndryshme. Për shembull, pastrimi i kanaleve tretësore të bujqësisë është detyrë e komunitetit. Shpesh, bllokimi i tyre shkakton përmytje të vogla, por në raste të përmytjeve të mëdha, ato mund të kenë një impakt të rëndësishëm. Në mënyrë të ngjashme, shumë prej zjarreve në pyje vijnë si rezultat i pakujdesisë së qytetarëve ose tentativave për të pastruar (nëpërmjet zjarrit) livadhe. Në këto raste, bashkia duhet të luajë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e tyre.

**OS1.3 Ngritja e grupeve të vullnetarëve dhe ngritja e kapaciteteve të tyre**

Bashkia Lezhë, edhe pse është ndihmuar shpesh nga grupe vullnetarësh në raste fatkeqësish, këto ndihma kanë qënë rastësore dhe jo të mirë strukturuara. Grupet vullnetare jo gjithmonë janë të trajnuara dhe kanë njohuri mbi mënyrën si duhet të veprojnë në raste të fatkeqësive të ndryshme. Kësisoj, në bashkëpunim me organizata të ndryshme lokale, bashkia duhet të fillojë të krijojë e trajnojë grupet e ndryshme vullnetare.

**OS1.4 Ngritja e kapaciteteve komunitare dhe procedurave për angazhim në ZRF**

Përtej krijimit të grupeve vullnetare, duhet të krijohen procedura të qarta për angazhimin e komunitetit në reduktimin e ZRF. Pra, nisma duhet të shpërndahet në mënyrë kapilare nga administrata e bashkisë deri tek niveli komunitar.

**OS2: Ngritja e kapaciteteve institucionale e financiare të Bashkisë Lezhë për ZRF**

Qeverisja territorit luan një rol të rëndësishëm në ZRF. Bashkia Lezhë duhet të ngrejë kapacitet e saja institucionale dhe duhet të rrisë ndërveprimin midis sektorëve të ndryshëm. Koncepti i ZRF duhet të bëhet pjesë e të gjithë sektorëve dhe shërbimeve të cilat ofrohen nga bashkia, dhe jo vetëm të trajtohet si një çështje sektoriale tradicionale dhe me diapazon të ngushtë në përgjigjen pasi fatkeqësia të ketë ndodhur.

**OS2.1 Integrimi i ZRF si pjesë e instrumentave strategjike sektoriale**

Në këtë rast, është e rëndësishme që stafi i bashkisë të trajnohet dhe ZRF të bëhet pjesë (integrohet) në planifikimin strategjik të bashkisë. Kësisoj, dokumente të rëndësishme si Plani i Përgjithshëm Vendor, apo strategji të ndryshme sektoriale të cilat mund të lidhen me mjedisin, kulturën dhe trashëgiminë historike, zhvillimin ekonomik, arsimin etj duhet të kenë të integruar konceptet e ZRF.

**OS2.2 Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të Komisionit të Mbrojtjes Civile**

Një aspekt shumë i rëndësishëm i ngritjes së kapaciteteve institucionale është edhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të Komisionit të Mbrojtjes Civile si dhe mbajtja në funksion e këtij komisioni. Roli i tij është shumë i rëndësishëm jo vetëm në rastin që ndodhin fatkeqësitë por edhe në ndërlidhjen, ndërveprimin dhe koordinimin e nismave të bashkisë me komunitetin dhe palëve të tjera të interesit të cilat operojnë në Bashkinë Lezhë.

**OS2.3 Krijimi i databazave për ZRF**

Së fundmi, bashkia duhet të rrisë kapacitet e saj dhe të fillojë të krijojë databaza të sakta në lidhje me fatkeqësitë natyrore, ndërhyrjet në territor në funksion të ZRF. Kjo gjë do të lejojë monitorimin e politikave dhe suksesit të tyre, si dhe rishikimin e strategjive e planeve në përgjigje të nevojave komunitare e evolimit të situatës së riskut të fatkeqësive. Veçanërisht, ndryshimet klimatike të cilat kanë një impakt të ngadaltë e të shtrirë në kohë, kanë nevojë për monitorim të vazhdueshëm në mënyrë që të merren masat e nevojshme për zbutjen. Aktualisht, Bashkia Lezhë, si pjesa më e madhe e bashkive në Shqipëri ka një mangësi të theksuar përsa i përket të dhënave e

databazave të cilat janë të përditësuara, të shtrira për të gjithë territorin si dhe të dhënave të besueshme. Kjo gjë vjen si rezultat i problematikave të trashëguara, por dhe të mungesës së koherencës në mbajtjen e të dhënave nga bashkitë e komunat përpara reformës territoriale administrative. Në kuadër të hartimit të analizave, vlerësimit të riskut dhe cënueshmërisë si dhe hartimit të strategjisë së ZRF, është ngritur një databazë e qënësishme në GIS (Sistem Informimi Gjeografik) për Bashkinë Lezhë. Kjo databazë duhet të mirëmbahet e të shërbejë për vlerësime të mëtejshme dhe të monitorimit të zbatimit të masave.

### **OS3: Zbutja e Riskut të Fatkeqësive nëpërmjet ndërhyrjeve dhe masave në territor**

Ky objektivi strategjik fokusohet në mënyrë të drejtpërdrejtë tek ndërhyrjet që bashkia duhet të kryejë ose angazhojë aktorë të ndryshëm në harkun kohor afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë për ZRF. Këto ndërhyrje janë të ndara sipas rreziqeve nga fatkeqësitë e ndryshme të cilat prekin territorin e Bashkisë Lezhë. Ato janë të ndara në masa strukturore si edhe masa jostrukturore (sipas përkufizimeve të ligjit 45/2019) në formën e studimeve të mëtejshme apo studimeve të fizibilitetit. Disa prej ndërhyrjeve zhvillohen nga Bashkia Lezhë, ndërkohë që disa të tjera mund të zhvillohen në bashkëpunim me autoritete qendrore ose në bashkëpunim me donatorë apo institucione të tjera ndërkombëtare.

#### **OS3.1 Zbutja e Riskut të Përmbytjeve**

Përsa i përket ndërhyrjeve në lidhje me rrezikun e përmbytjeve disa nga ndërhyrjet parësore për ZRF janë pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve parësore bujqësore, kanaleve dytësore. Një tjetër element i rëndësishëm është mirëmbajtja e argjinaturave kryesore në territorin e Bashkisë Lezhë. Përsa i përket kanaleve parësore dhe argjinaturave kryesore, Bashkia Lezhë duhet të punojë me autoritetet përkatëse kombëtare dhe rajonale duke qënë se janë jashtë kompetencës së saj. Në këtë vazhdë, duhet kryer mirëmbajtja e hidrovorëve dhe kontrolli i herëpashershëm i tyre në mënyrë që të jenë funksional. Digat e revervuarëve janë një element shumë i rëndësishëm. Këto diga duhen studiuar dhe më pas riparuar. Përsa i përket përmbytjeve, është e rëndësishme që të riparohen dhe aty ku mungojnë të ndërtohen më tej digat malore veçanërisht në njësitë administrative Kallmet dhe Kolsh.

#### **OS3.2 Zbutja e Riskut Sizmik**

Përsa i përket riskut sizmik, Bashkia Lezhë aktualisht ka një kapacitet të vogël për të ndërhyrë. Një ndër elementët më të rëndësishëm, është integrimi i studimeve gjeologjike dhe sizmike në procesin e marrjes së lejes. Ky lloj dokumentacioni duhet të jetë gjithmonë prezent dhe bashkia duhet të sigurohet që ndërtimet e reja janë konform standarteve. Aspekti i dytë i rëndësishëm është kryerja e studimeve të thelluara për të gjitha ndërtesat të cilat kanë një moshë mbi 30 vjet, ndërtesave informale dhe ndërtesave të cilat gjenden në toka me potencila të lartë lëngëzimi në lidhje me rrezikun individual të tyre. Ky lloj studimi do të garantonte një bazë për ndërhyrje përforcuese dhe rritjen e sigurisë së ndërtesave. Më pas bashkia së bashku me komunitetin mund të ndërmarrin masa për përforsimin e ndërtesave sipas rastit.

#### **OS3.3 Zbutja e Gjeo-rreziqeve**

Bashkia Lezhë përballet me disa gjeo-rreziqe të tilla si rrëshqitje toke apo rënia e shkëmbinjve dhe gurrëve. Përsa i përket rrëshqitjeve të tokës, aktualisht është e pamundur të kryhen pa pasur një studim të detajuar të gjendjes ekzistuese. Ky lloj studimi do të kërkojë një monitorim të vazhdueshëm për një periudhë kohore minimalisht 1 vjeçare përpara marrjes së masave specifike inxhinierike. Gjithashtu, përsa i përket rrënies së shkëmbinjve është e rëndësishme që të kryhet një studim për secilin shkëmb paraprakisht përpara marrjes së masave për largimin ose përforsimin me rrjeta të tyre në zonën e Torovicës. Ndërkohë, në rrugën e Shëngjinit duhen riparuar dhe mirëmbajtur rrjetat pritëse, si dhe shtuar aty ku është e nevojshme. Përsa i përket

kodrave të Zejmenit, është e rëndësishme që të shtohen rrjetat pritëse në mënyrë që të mos rrezikohet kalimi në rrugë. Gjithashtu, edhe pranë kodrave në mbi qytetin e Lezhës, (kodra e Kalasë) është e nevojshme që të shtohen disa rrjeta për të ulur rrezikun e rënies së gurëve.

#### **OS3.4 Zbutja e Riskut të Zjarreve**

Ngritja e Kapaciteteve për menaxhimin e pyjeve është një aspekt shumë i rëndësishëm në Bashkinë Lezhë duke marrë në konsideratë numrin e rreshjeve vjetore të cilat ndodhin gjatë periudhave Maj-Shtator. Në këtë rast, shumica e zjarreve janë shkaktuar nga pakujdesi nga komuniteti dhe amplifikohen nga kushtet atmosferike dhe thatësitat. Bashkia duhet të rrisë ndërgjegjësimin e strukturave të saj dhe të qytetarëve për të administruar hapësirat pyjore. Një element shumë i rëndësishëm në këtë rast është mirëmbajtja e rrugëve të kalimit në zonat pyjore në mënyrë që të garantohet aksesimi në rast zjarri. Një ndërhyrje e nevojshme është rehabilitimi dhe pyllëzimi i zonave të djegura. Kjo do të garantonte që fondi pyjor të mbahet dhe të restaurohet.

#### **OS3.5 Zbutja e Riskut të Bllokimit nga Bora**

Rreziku nga Bora është kryesisht evident në njësinë administrative Ungrej. Në këtë rast është e rëndësishme që të mirëmbahet rruga lidhëse midis fshatrave të Ungrej dhe qytetit të Lezhës. Kjo gjë do të kërkojë hedhjen e kripës gjatë stinës së dimrit ose në rastet e parashikimeve të rënies së dëborës. Gjithashtu në rast bllokimi, bashkia duhet të sigurojë rezerva të nevojshme dhe shpërndarjen e tyre nëpërmjet mjeteve alternative në raste bllokimi të zgjatur.

#### **OS3.6 Zbutja e Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike**

Ndryshimet Klimatike janë një ndër sfidat më të mëdha të Bashkisë Lezhë. E pozicionuar në ultësirën perëndimore, hapësira bregdetare e Lezhës është në rrezik nga rritja e nivelit të detit si dhe shtimi i stuhive detare. Ndryshimi i regjimit të rreshjeve parashikohet që të shtojë riskun e përmytjeve. Përtej përmytjeve, thatësitat dhe risku i zjarreve pritet të shtohet. Bashkia aktualisht ka një buxhet të limituar për të kryer ndërhyrje të qënësishme në zbutjen e impaktit të ndryshimeve klimatike në territor. Disa masa të cilat parashikohen në këtë rast mund të lidhen me studime fizibiliteti për zbutjen e ndikimit të rritjes së nivelit të detit dhe parandalimin e zgjerimit të detit në drejtim të tokës. Gjithashtu, në forma të studimeve, është e rëndësishme që të kryhet dhe një studim për rritjen e kapaciteteve të rezervuarëve, apo krijimit të ujëmbledhësave të rinj. Kjo është një ndërhyrje shumë e rëndësishme në optikën e rritjes së nivelit të thatësirave në vitet e ardhshme. Elementë të tjerë në lidhje me ndryshimet klimatike lidhen me zonat urbane ku bashkia duhet të rrisë gjelbërimin. Kjo gjë impakton drejtpërdrejt në zvogëlimin e riskut të ishujve të nxehtësisë urbane. Po ashtu, koncepti i "zgjidhjeve të bazuara në natyrë" (nature based solutions) duhet të fillojë të aplikohet në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha projektet e rigjenerimit që ndërmerren në territorin e Bashkisë Lezhë, si në hapësira urbane, ashtu dhe në ato natyrore, bujqësore e ujore. Pra duhet të zvogëlohet impakti i ndërhyrjeve në territor.

### **OS4: Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente**

Ky objektivi është drejtpërdrejt i lidhur me përballimin e një situatave emergjente. Në kuadër të këtij projekti, bashkia do të hartojë dhe Planin e Emergjencave Civile. Një dokument shumë i rëndësishëm i cili duhet të jetë udhëzuesi bazë në rast të ndonjë fatkeqësie dhe duhet të drejtojë veprimet e bashkisë. Gjithësesi, është e rëndësishme që bashkia të jetë e përgatitur dhe disa nga elementet kryesore të cilat duhet të jenë në gatishmëri janë rezervat ushqimore, rezervat me pajisje akomoduese të tipit çadra, batanije ej, pajisjet e nevojshme për grupet vullnetare etj. Një tjetër hap i rëndësishëm është edhe përgatitja e planeve të evakuimit të të gjitha institucioneve të tilla si bashkia, shkolla, cerdhe, qendra kulturore, muze etj. Ngritja e një sistemi alarmi dhe njohfimi të hershëm është gjithashtu një aspekt shumë i rëndësishëm. Ky lloj sistemi duhet të jetë i thjeshtë dhe i aksesueshëm për të gjithë banorët.

## 5.2 MASAT DHE VEPRIMET PËR JETËSIMIN E STRATEGJISË

TABELA 3. Plani i Veprimit

Objektivi	Masa	Kosto (Lek)	Faza 1 2021- 2023	Faza 2 2023- 2025	Faza 3 2025- 2027	Përgjegjësia Institucionale	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë	Rreziku
<b>OS1</b>  Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për ZRF	1.1 Ngritja e Grupeve Vullnetare	-	X	X	X	Bashkia Lezhë, Kryqi Kuq, Karitasi, WorlVision etj	X		x	Mungesë vullnetarësh; fondacionet humanitare menaxhojnë vullnetarët e tyre dhe nuk bashkëpunojnë me bashkinë; mungesë eksperiencë në menaxhimin e vullnetarëve
	1.2 Trajnimi i Grupeve Vullnetare	1,200	X	X	X	B. Lezhë, Donatorë, Kryqi i Kuq, Karitasi, World Vision etj				Mungesë Vullnetarësh; mungesë fondesh
	1.3 Trajnimi i Komunitetit	1,200	X	X	X	B. Lezhë, Komisioni i Mbrojtjes Civile, Kryqi Kuq, Karitasi, World Vision etj	x		x	Mungesë eksperiencë për trajnimin e komunitetit; mungesë përfshirje nga komuniteti; mungesë besimi në procese të tilla
	1.4 Fushata Informimi Komuniteti	1,500	X	X	X	B. Lezhë, Agjencia Kombëtare Mbrojtjes Civile, Donatorë, Media Lokale	x		x	Mungesë interesi nga komuniteti; mungesë bashkëpunimi me media lokale
	1.5 Fushata Ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve tretësore nga fermerët	600	X	X	X	B. Lezhë, Bordi Kullimit, Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Donatorë, etj				Mungesë bashkëpunimi nga fermerët; mungesë angazhimi në pastrimin e kanaleve;
	1.6 Fushata Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj zjarrit në pyje	600	X	X	X	B. Lezhë, Drejtoria Rajonale Mjedisit, Sektori Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Lezhë	X			Mungesë kapaciteti për menaxhimin e pyjeve; mungesë interesi nga komuniteti;
	1.7 Trajnim i Komunitetit për Shërbimet e Ekosistemit	1,200	X	X	X	B. Lezhë, Drejtoria e Rajonale e Mjedisit	X		X	Mungesë njohurie dhe eksperiencë nga Bashkia Lezhë; mungesë interesi nga komuniteti për t'u përfshirë;
	1.8 Menaxhimi i Ekonomive Pyjore nga komuniteti	-	X	X	X	B. Lezhë, Komuniteti, Donatorë				Mungesë eksperiencë; informaliteti; mungesë interesi nga komuniteti

Objektivi	Masa	Kosto (Lek)	Faza 1 2021-2023	Faza 2 2023-2025	Faza 3 2025-2027	Përgjegjësia Institucionale	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë	Rreziku
<b>OS2</b> Ngritja e kapaciteteve institucionale, qeverisëse për ZRF	2.1 Trajnim i vazhduar Stafi i bashkisë për ZRF	1,200	X	X	X	B. Lezhë, ASPA, Donatorë, AKMC	X		X	Mungesë fondesh; ndryshime të vazhdueshme në stafin e bashkisë; mungesë interesi në trajnime
	2.2 Trajnim i vazhduar i Komisionit të Mbrojtjes Civile	1,200	X	X	X	B. Lezhë, ASPA, Donatorë, AKMC	X		X	Mungesë fondesh; mungesë interesi nga komisioni; ndryshime në përbërjen e komisionit; mungesë eksperience në mbarëvajtjen e komisionit
	2.3 Rishikimi i PPV me fokus përshtatjen për ZRF	-	X			B. Lezhë, AKPT	X	X		Mungesë eksperience në integrimin e ZRF në PPV; interesat e zhvillimit mund të prevalojnë mbi ZRF; mungesë kuptimi e ZRF si çështje gjithëpërfshirëse dhe jo sektoriale
	2.4 Rishikimi i Strategjive dhe Planeve Sektoriale me fokus ZRF	-	X	X		B. Lezhë	X		X	Strategjitë nuk janë hartuar; mungesë eksperiencë; mungesë vullneti për rishikimin e strategjive
	2.5 Ngritja dhe mirëmbajtja e databazës së ZRF në Bashkinë Lezhë	50,000	X	X	X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC	X	X	X	Mungesë eksperiencë; mungesë kapaciteti; mungesë infrastrukturë (kompjuter/ programe); mungesë bashkëpunimi midis sektorëve
	2.6 Trajnimi i Stafit të Drejtorisë së Mbrojtjes Civile në përdorimin e GIS dhe mirëmbajtjen e databazës	600	X	X	X	B. Lezhë, ASPA, Donatorë	X	X	X	Mungesë fondesh për trajnime; mungesë bashkëpunimi me donator; mungesë ndërgjegjësimi për rëndësinë e databazës
<b>OS3</b> Reduktimi i Riskut ndaj Fatkeqësive	3.1 Pastrimi i Kanaleve Parësore	-	X	X	X	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, B. Lezhë		X		Mungesë fondesh; mungesë mjetes; mungesë bashkëpunimi midis nivelit qendror dhe atij vendor
	3.2 Pastrimi i Kanaleve Dytësore	-	X	X	X	B. Lezhë, Donatorë	X			Mungesë fondesh; mungesë mjetes

Objektivi	Masa	Kosto (Lek)	Faza 1 2021- 2023	Faza 2 2023- 2025	Faza 3 2025- 2027	Përgjegjësia Institucionale	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë	Rreziku	
OS3  Reduktimi i Riskut ndaj Fatkeqësive	3.3 Pastrimi i Kanaleve Tretësore	-	X	X	X	B. Lezhë, Komuniteti				Mungesë mjetesh; mungesë sensibilizimi; mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi	
	3.4 Studim për Reabilitimin dhe Ndërtimi i Pritave Malore	12,000	X	X		B. Lezhë, Donatorë,	X	X		Mungesë fondesh;	
	3.5 Reabilitimi dhe Ndërtimi i Pritave Malore	-		X	X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC	X	X		Mungesë fondesh	
	3.6 Studim mbi gjendjen e digave	5,000	X	X		B. Lezhë, Donatorë, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha/KKDM	X	X	X	Mungesë fondesh	
	3.7 Përmirësimi i gjendjes së digave sipas studimit	Sipas Studimit			X	X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC, KM	X	X	X	Mungesë fondesh
	3.8 Studim mbi rivitalizimin e rezervuarëve për ujitje dhe për mundësinë e hapjes së rezervuarëve të rinj	13,000			X	X	B. Lezhë, Donatorë	X	X	X	Mungesë fondesh
	3.9 Përmirësimi i gjendjes së rezervuarëve dhe krijimi i rezervuarëve të rinj	Sipas Studimit				X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC, KM	X	X	X	Mungesë fondesh
	3.10 Mirëmbajtja e Argjinaturave të Lumenjve	-	X	X	X		B. Lezhë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Donatorë, AKMC, KM		X		Mungesë fondesh; mungesë bashkëpunimi
	3.11 Mirëmbajtja e Argjinaturave Detare	-	X	X	X		B. Lezhë, Ministri e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Donatorë, AKMC, KM		X		Mungesë fondesh; mungesë mjetesh; mungesë bashkëpunimi
	3.12 Blerja e Pajisjeve për pastrimin e kanaleve	15,000		X	X	X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC, KM	X		X	Mungesë fondesh

Objektivi	Masa	Kosto (Lek)	Faza 1 2021- 2023	Faza 2 2023- 2025	Faza 3 2025- 2027	Përgjegjësia Institucionale	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë	Rreziku
OS3  Reduktimi i Riskut ndaj Fatkeqësive	3.13 Studim sizmik për ndërtesat me moshë mbi 30 vjet	854,250	X	X	X	B. Lezhë, Instituti i Ndërtimit, Donatorë, IGJEUM, SHGJSH	X	X	X	Mungesë fondesh; mungesë pajisjesh të specializuara; bashkëpunimi me komunitetin; rreziku i spekulimit
	3.14 Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë	18, 750	X	X	X	B. Lezhë, IN, Donatorë, IGJEUM, SHGJSH	X	X	X	Mungesë fondesh; mungesë pajisjesh të specializuara
	3.15 Studim sizmik për ndërtesat informale	215, 375	X	X	X	B. Lezhë, IN, ALUIZNI, ASHK, Donatorë, IGJEUM, SHGJSH	X	X	X	Mungesë fondesh; mungesë pajisjes të specializuara
	3.16 Studim sizmik për ndërtesat në zona me rrezik lëngëzimi	274,750	X	X	X	B. Lezhë, IN, ALUIZNI, Donatorë, SHGJSH, IGJEUM	X	X	X	Mungesë kapaciteti; mungesë fondesh; mungesë pajisjesh
	3.17 Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes së strukturave bazuar në studimet e mësipërme	-			X	B. Lezhë, Komuniteti, Donatorë, AKMC, KM				
	3.18 Studim dhe Monitorim i Zonave me rrezik Rrëshqitje	11, 250	X	X	X	B. Lezhë, SHGJSH, Donatorë, SHGJSH, IGJEUM	X	X	X	Mungesë kapaciteti; mungesë pajisjesh; mungesë fondesh
	3.19 Marrja e masave për stabilizimin e rrëshqitjeve	-			X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC, KM				
	3.20 Studim mbi largimin e Shkëmbinjve/ Gurrëve me rrezik	10,750	X	X	X	B. Lezhë, ShGjSh, Ministria e Mbrojtjes,	X	X		Mungesë bashkëpunimi; mungesë fondesh
	3.21 Marrja e masave për largimin e shkëmbinjve dhe gurrëve me rrezik	Sipas studimit			X	B. Lezhë, AKMC, Ministria e Mbrojtjes				
	3.22 Studim mbi menaxhimin e lagunës së Kune-Vain dhe menaxhimin e lagunës së Knallës	7, 500	X	X	X	B. Lezhë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Donatorë	X	X	X	Mungesë prioriteti; mungesë bashkëpunimi



Objekti	Masa	Kosto (Lek)	Faza 1 2021-2023	Faza 2 2023-2025	Faza 3 2025-2027	Përgjegjësia Institucionale	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë	Rreziku
OS3 Reduktimi i Riskut ndaj Fatkeqësive	3.23 Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes në Laguna	-		x	x	B. Lezhë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Donatorë				
	3.24 Pyllëzimi i Zonave Pyjore të Djegura	200,000	X	X	X	B. Lezhë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	X	X	X	Mungesë bashkëpunimi; mungesë fondesh
	3.25 Mirëmbajtja e Rrugës Lezhë- Ungrej	1,000	X	X	X	B. Lezhë, MIE	X			Mungesë fondesh
	3.26 Zgjerimi i Hapësirave të Gjelbra në Qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin	60,000	X	X	X	B. Lezhë, FZSH, MMT	X			Mungesë toke; mungesë kapacitetesh për përdorimin e infrastrukturave financiarë të zhvillimit të tokës; mungesë bashkëpunimi me komunitetin
	3.27 Studim fizibiliteti për zvogëlimin e riskut nga rritja e nivelit të detit	250,000	X	X	X	B. Lezhë, MMT, Donatorë		X	X	Mungesë fondesh
	3.28 Studim inxhinierik për gjendjen e infrastrukturave kritike (ura)	11,250	X	X	X	B. Lezhë, ARRSH, MIE, Donatorë, Instituti i Ndërtimit	X	X		Mungesë fondesh
	3.29 Marrja e masave për nderhyrje inxhinierike në ura	-	X	X	X	B. Lezhë, ARRSH, MIE, Donatore, AKMC				
	3.30 Rehabilitimi i Fashës Ripariante të Lumit Mat	-	X	X	X	B. Lezhë, MMT, Donatorë	X	X	X	Mungesë sensibilizimi; interesat e industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të zhavorrit
	3.31 Rehabilitimi i Fashës Ripariante e Lumit Drin	-	X	X	X	B. Lezhë, MMT, Donatorë	X	X	X	Mungesë sensibilizimi
3.32 Mirëmbajtja e Vazhdueshme e Hidrovorëve	-	X	X	X	MBZHR		X		Mungesë fondesh	

Objektivi	Masa	Kosto (Lek)	Faza 1 2021- 2023	Faza 2 2023- 2025	Faza 3 2025- 2027	Përgjegjësia Institucionale	Bashkia	Qeveria Qendrore	Donatorë	Rreziku
<b>OS4</b>	4.1 Hartimi, Monitorimi dhe Përditësimi i Planit të Emergjencave Civile	-	X	X	X	B. Lezhë, PNUD	X			Mungesë sensibilizimi; mungesë kapaciteti; mos përditësimi i databazës; mungesë kapaciteti monitories
Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente	4.2 Hartimi i Planeve të Evakuimit në ndërtesa të rëndësishme të veçantë dhe vendosja e sinjalistikës së nevojshme	56,250	X	X	X	B. Lezhë, AKMC, Donatorë	X	X		Mungesë kapaciteti për hartimin e planeve
	4.3 Plotësimi i nevojave me pajisje për rastet e emergjencave	-	X	X	X	B. Lezhë, AKMC, Donatorë	X	X	X	Mungesë fondesh
	4.4 Ngritja e Sistemeve të Alarmit	150,000	X	X	X	B. Lezhë, Donatorë, AKMC	X	X	X	Mungesë fondesh; mungesë eksperience

## 5.3 MASAT OS1: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE KOMUNITARE PËR ZRF

### 5.3.1 Ngritja e Grupit të Vullnetarëve

Aktualisht në Bashkinë Lezhë operojnë grupe të ndryshme vullnetarësh. Një pjesë e vullnetarëve janë të lidhur me organizata humanitare si Kryqi i Kuq, Karitasi, World Vision, si dhe me komunitetet e ndryshme fetare. Gjithashtu, bashkia, në raste emergjencash dhe me masa 'ad hoc' ka bërë thirrje për vullnetarë si në rastin e tërmetit dhe në rastin e pandemisë. Është e rëndësishme që grupet vullnetare të formalizohen. Duhet të ketë një listë të qartë të vullnetarëve, kapaciteteve të tyre dhe gatishmërisë për të marrë pjesë në raste emergjencash. Për këtë, bashkia duhet të krijojë një databazë të qartë e cila të ketë dhe pikat e kontaktit të anëtarëve. Listat e vullnetarëve duhet të plotësohen e përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, të paktën 1 herë në 6 muaj. Databaza e vullnetarëve duhet të menaxhohet nga Drejtoria e Emergjencave Civile pranë Bashkisë Lezhë.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.3.2 Trajnimi i Grupeve Vullnetare

Grupet vullnetare të konfirmuara duhet të trajnohen të paktën 2 herë në vit në lidhje me ndërhyrjet dhe menaxhimin e rasteve të ndryshme emergjencash. Trajnimet mund të përfshijnë simulime të rasteve të emergjencave. Ata duhet të njohin në detaj planin e Emergjencave Civile dhe Strategjinë e ZRF në Bashkinë Lezhë. Grupet vullnetare duhet të kenë të qartë mënyrën e operimit, pikat e sigurta në Bashkinë Lezhë etj. Trajnimi i grupeve vullnetare mund të kryhet në bashkëpunim me organizata humanitare si Kryqi i Kuq, Karitasi, World Vision, si dhe me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

**Kosto:** 1,200,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.3.3 Trajnimi i Komunitetit

Trajnimi i Komunitetit për të reaguuar në raste të emergjencave është shumë i nevojshëm. Bashkia, duhet të krijojë një sërë trajnimesh, të shpërndara sipas njësive administrative dhe tipologjive të rrezikut. Këto trajnime duhet të jenë të vazhdueshme dhe të marrin në konsideratë grupe të ndryshme. Trajnimet mund të organizohen nga vetë Bashkia Lezhë ose në bashkëpunim me shoqata humanitare apo donatorë. Trajnimet e komunitetit mund të përfshijnë edhe simulime të reagimit në raste të emergjencave, mënyra të evakuimit, apo të sjelljes në rast të ndonjë fatkeqësie. Gjithashtu, trajnimet mund të përfshijnë edhe çështje të lidhura me aksesin ndaj informacionit në rast fatkeqësie dhe mënyrën e përdorimit të tij. Bashkia duhet të ketë të paktën 2 fushata trajnimi në vit të komunitetit. Këto fushata shërbejnë edhe në sensibilizimin e komunitetit ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndërgjegjësimin e tij për masa që duhet të ndërmerren.

**Kosto:** 1,200,000 LEK

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

#### **5.3.4 Fushata Informimi Komuniteti**

Bashkia Lezhë duhet të zhvillojë aktivitete të ndryshme dhe të vazhdueshme për informimin e komunitetit në lidhje me risqet e fatkeqësive. Informimi mund të kryhet nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit si rrjete sociale, media audio-vizive, media të shkruara, takime me komunitetin etj. Përtej trajnimit të vazhdueshëm, informimi është njëelement thelbësor në lidhje me ZRF. Të paktën dy herë në vit, bashkia duhet të zhvillojë fushata informimi. Këto mund të përfshijnë publikimin e broshurave si dhe mund të jenë të lidhura me ndryshimet stinore dhe rreziqet të lidhura me to. Fushatat e informimit duhet të lidhen dhe me veprime ose investime të kryera nga bashkia për ZRF. Informimi duhet të jetë transparent.

**Kosto:** 1,500,000 LEK

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

#### **5.3.5 Fushata Ndërgjegjësimi për Pastrimin e Kanaleve Tretësore nga Fermerët**

Një ndër faktorët i cili ka një ndikim të madh në ZRF dhe ku komuniteti mund të luajë një rol të madh është pastrimi i kanaleve tretësore. Në këtë rast, bashkia duhet të zhvillojë fushata të ndryshme ndërgjegjësimi me fermerët për të garantuar që kanalet tretësore mirëmbahen dhe janë në gjendje funksionale. Bashkia mund të ofrojë dhe incentiva për pastrimin e kanaleve duke vendosur në përdorim pajisjet për pastrimin e kanaleve. Fushatat e ndërgjegjësimit mund të zhvillohen në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu, ato mund të shoqërohen dhe me kritere plotësuese për dhënien e fondeve mbështetëse për fermerët. Bashkia duhet të ketë të paktën 1 fushatë ndërgjegjësimi në vit e cila duhet të përkojë me periudhën në të cilën kryhen punimet për mirëmbajtjen e kanaleve parësore e dytësore.

**Kosto:** 600,000 LEK

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

#### **5.3.6 Fushata Ndërgjegjësimi për Rrezikun ndaj Zjarrit në Pyje**

Zjarret në pyje zakonisht shkaktohen nga pakujdesia e komunitetit. Në këtë rast, bashkia mund të luajë një rol të rëndësishëm përsa i përket ndërgjegjësimit. Edhe në këtë rast, në periudhën Maj-Shtator, bashkia duhet të zhvillojë fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi. Këto fushata duhet të lidhen dhe me kontrolle të vazhdueshme. Fushatat e ndërgjegjësimit mund të kryhet duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi qoftë këto nëpërmjet mediave qoftë me takime të drejtpërdrejta me komunitetin. Këto fushata ndërgjegjësimi mund të kryhen në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, me drejtoritë rajonale mjedisore si dhe me shërbimin pyjor.

**Kosto:** 600,000 LEK

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

### **5.3.7 Trajnimi i Komunitetit për Shërbimet e Ekosistemit**

Shërbimet e ekosistemit janë një element thelbësor në ZRF. Në këtë aspekt, është e nevojshme që komuniteti të ndërgjegjësohet e të trajnohet për shërbimet e ekosistemit. Në këtë mënyrë, duhen zhvilluar trajnime të ndryshme me komunitetin për të ndërgjegjësuar e për të rritur kapacitetin e tyre në përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit si dhe në mirëmbajtjen e tyre. Këto trajnime duhet të jenë të vazhdueshme e të targetuara sipas nevojave dhe specifikave të komunitetit e të territorit.

**Kosto:** 1,200,000 LEK

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

### **5.3.8 Menaxhimi i Ekonomive Pyjore Nëpërmjet Komunitetit**

Bashkia Lezhë ka një kapacitet të reduktuar për menaxhimin e pyjeve. Kjo problematikë shpesh shoqërohet edhe me rritjen e zjarreve në pyje. Një nga mënyrat për të rregulluar këtë çështje është nëpërmjet përfshirjes së komunitetit në menaxhimin e tyre. Në këtë mënyrë, komuniteti merr një përgjegjësi më të madhe në reduktimin e riskut të zjarreve duke qënë se ka një interes të drejtpërdrejtë. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që bashkia të nënshkruajë kontrata me komunitetin.

**Kosto:** -

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

## **5.4 MASAT PËR OS2: NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, QEVERISËSE PËR ZRF**

### **5.4.1 Trajnim i Vazhduar Stafit i Bashkisë për ZRF**

Stafi i bashkisë duhet të trajnohet dhe jetë i përditësuar me qasjen e ZRF. Përtej drejtorisë së emergjencave civile, të gjithë sektorët e ndryshëm duhet të trajnohen të paktën 1 herë në vit në lidhje me integrimin e ZRF në punën e tyre. Gjithashtu, kjo është shumë e rëndësishme për të krijuar sinergji dhe për të garantuar që ZRF kthehet në politikë gjithëpërfshirëse në të gjithë sektorët. Trajnimet e stafit të bashkisë mund të zhvillohen në bashkëpunim me donatorë, me ASPA, apo dhe duke ngritur vetë kapacitetet e bashkisë. Pra staf kyç i bashkisë trajnohet e më pas kthehet në trajner për pjesën tjetër të stafit. Gjithashtu, inkurajohet dhe shkëmbimi i eksperiencave me vende të tjera. Një pjesë e stafit mund të shkojnë në vizita në institucione të tjera në rajon ose më gjerë për të marrë eksperimente dhe eksperiencë.

**Kosto:** 1,200,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.4.2 Trajnim i Vazhduar i Komitetit të Mbrojtjes Civile**

Komiteti i Mbrojtjes Civile është një hallkë shumë e rëndësishme për ZRF. Komiteti duhet të përditësohet (me anëtarë të rinj, nëse është e nevojshme), dhe të mbledhet në mënyrë periodike. Gjithashtu, Komiteti i Mbrojtjes Civile duhet të trajnohet në mënyrë të vazhdueshme. Të paktën dy herë në vit, me tematika të ndryshme trajnimi në mënyrë që të jetë i përditësuar me qasjen e ZRF. Trajnimi i Komitetit mund të kryhet me ekspertë të ndryshëm nga donatorë, me mbështetje të AKMC. Gjithashtu, anëtarë të ndryshëm të komitetit mund të kthehen në trajnues për çështje specifike sipas fushave të ekspertizës.

**Kosto:** 1,200,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.4.3 Rishikimi i PPV me Fokus Përshtatjen për ZRF**

PPV-ja e Bashkisë Lezhë duhet të rishikohet për të integruar në mënyrë të qënësishme faktorët e riskut. Rishikimi duhet të prekë të gjitha dokumentat duke nisur nga Strategjia, Plani i Përdorimit të Tokës, Rregulloren, Vlerësimin Strategjik Mjedisor si dhe Planin e Investimeve Kapitale. Është e rëndësishme që të rishikohen me vëmendje përcaktimet e planit për zhvillim në zona të cilat preken nga fatkeqësi të ndryshme natyrore. Përcaktimet mund të ndryshohen në formën e përdorimeve të lejuara ose të kufizuara, kushtet e ndërtimit, si dhe rregulla shitesë për të zvogëluar riskun e fatkeqësive. Veçanërisht zona bregdetare, e cila është me e prekura nga përmbytjet, rreziku i ndryshimeve klimatike dhe nga fenomeni i lëngëzimit të tokave duhet të rishikohet duke marrë një qasje të planifikimit adaptues. Po ashtu, një dokument i rëndësishëm i cili duhet të rishikohet është edhe PIK, duke qënë se bën lidhjen midis projekteve dhe buxhetit. Rishikimi i PPV-së mund të kryhet në bashkëpunim me AKPT-në. Kjo proces mund të shërbejë si model për përshtatjen e PPV-ve duke përfshirë ZRF.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2020-2022

#### **5.4.4 Rishikimi/ Hartimi i Strategjive dhe Planeve Sektoriale me Fokus ZRF**

Planet e ndryshme sektoriale duhet të rishikohen, ose të hartohen nga e para duke integruar qasjen e ZRF. Planet/ Strategjitë për mbrojtjen mjedisore, trashëgiminë kulturore, zhvillimin ekonomik, turizmin, strehimin etj, duhet të rishikohen dhe ose hartohen duke marrë në konsideratë ZRF. Kjo është e një ndër mënyrat kryesore për të future logjikën e ZRF në të gjithë sektorët. Të gjitha planet, të cilat prekin territorin ose mund të ndihkojnë/ ndikohen nga fatkeqësitë, duhet të kalojnë për mendim tek Komisioni i Mbrojtjes Civile në Bashkinë Lezhë në fazat e konsultimit dhe përpara miratimit.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2025

#### **5.4.5 Ngritja dhe Mirëmbajtja e Databazës së ZRF në Bashkinë Lezhë**

Databaza e ZRF në Bashkinë Lezhë është një instrument thelbësor për monitorimin e fatkeqësive, zbatimin e strategjisë dhe ZRF. Databaza duhet të menaxhohet nga drejtorja e emergjencave civile, dhe duhet të integrohet në sektorin e ndryshëm. Databaza duhet të përditësohet, mirëmbahet dhe plotësohet me të dhëna të reja nga bashkia. Ajo duhet të përmbajë fatkeqësitë e ndodhura, dëmet e shkaktuara, parashikimet si dhe planet për ndërhyrje. Databaza rekomandohet që të jetë në formë GIS dhe në një moment të dytë mund të kthehet online dhe të hapur për publikun. Databaza i shërben bashkisë për përgatitjen e raportimeve të ndryshme, si dhe për të përmbushur detyrimet ligjore për rishikimin e strategjisë së ZRF (çdo 5 vjet), përditësimin e vlerësimit (çdo tre vjet) dhe rishikimin e planit të emergjencave (çdo 3 vjet).

**Kosto:** 50,000,000 Lek

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.4.6 Trajnimi i Stafit të Drejtorisë së Mbrojtjes Civile në Përdorimin e GIS dhe Mirëmbajtjen e Databazës**

Trajnimi i stafit të Drejtorisë së Mbrojtjes Civile në përdorimin e GIS dhe në mirëmbajtjen e databazës është një element thelbësor për vijueshmërinë dhe jetëgjatësinë e përdorimit të saj. Stafit duhet të marrë të paktën 2 herë në vit trajnim në GIS për zhvillimin e analizave, mirëmbajtjen e informacionit në GIS dhe përdorimin e mjeteve të ndryshme që GIS në fushën e ZRF.

**Kosto:** 600,000 Lek

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### **5.5 MASAT PËR OS3: ZVOGËLIMI I RISKUT TË FATKEQËSIVE**

#### **5.5.1 Pastrimi i Kanaleve Parësore**

Në territorin e Bashkisë Lezhë ekzistojnë 151 km linear kanale parësore, nga të cilat rreth 70% janë në gjendje pjesërisht të mirëmbajtur ose jo të mirëmbajtur. Pastrimi i këtyre kanaleve është thelbësor për reduktimin e përmytjeve. Kanalet kryesore duhet të pastrohen të paktën 1 herë në 5 vjet në mënyrë që të jenë funksional. Gjithësesi, vlen të përmendet që këto kanale nuk janë detyrim i bashkisë, por i ministrisë dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit. Si rezultat, në këtë rast, bashkia duhet të koordinohet me institucionet në qark e qendrore për të garantuar mirëmbajtjen e funksionalitetin e këtyre kanaleve. Është e rëndësishme që të hartohet minimalisht një plan 2-vjeçar pastrimi dhe mirëmbajtje kanalesh parësore midis institucioneve. Ndërhyrjet duhet të regjistrohen në databazën e bashkisë për ZRF.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.5.2 Pastrimi i Kanaleve Dytësore

Bashkia Lezhë ka në territorin e saj 342 km linear kanale dytësore, nga të cilat, vetëm 13.5% janë të mirëmbajtur<sup>27</sup>, ndërkohë që pjesa tjetër janë pjesërisht ose totalisht të pamirëmbajtur. Kanalet dytësore janë kompetencë e bashkisë për mirëmbajtje, dhe ato duhet të pastrohen minimalisht 1 herë në 2 vjet për të qënë funksionale. Në mënyrë që të arrijë të mbajë ritmin e ciklit të pastrimit, bashkia duhet të rrisë kapacitetet dhe të arrijë të pastrojë mesatarisht 70km linear në vit për 3 vitet e para, me synim që pas vitit të tretë të arrijë të pastrojë 171 km linear në vit. Padyshim kjo mbetet një sfidë e madhe e bashkisë, por është ndër mënyrat më të rëndësishme për të zvogëluar riskun nga përmytjet. Bashkia synon që këtë funksion ta kryejë me mjetet e veta, si rrjedhojë është e rëndësishme që të rriten kapacitetet me eskavatorë të fuqive të ndryshme.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.5.3 Pastrimi i Kanaleve Tretësore

Kanalet tretësore janë drejtpërdrejt të lidhura me angazhimin e komunitetit. Në këtë rast, bashkia mund të mbështesë komunitetin për pastrimin e kanaleve tretësore, veçanërisht për fermerë të cilët nuk kanë mundësi që të pastrojnë kanalet me pajisjet e tyre. Përtej ndërgjegjësimit, në këtë rast, një ndihmë që mund të jepet nga bashkia është huazimi i pajisjeve, ose bashkëpunimi me fermerët për të kryer pastrimin e kanaleve tretësore në paralel me pastrimin e atyre dytësore. Përsa i përket pastrimit të kanaleve tretësore, bashkia mund të vendosë dhe si kriter i granteve nivelin e pastrimit të kanaleve tretësore. Në këtë rast do të kthehej në një kushtëzim pozitiv dhe konkurues për fermerët.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.5.4 Studim për Rehabilitimin dhe Ndërtimi i Pritave Malore

Vizitat në terren dhe intervistat me banorët tregojnë se Përrenjt malorë janë një problematike e theksuar përsa i përket përmytjeve. Ato, jo vetëm që përmbysin por edhe shkaktojnë dëme në infrastrukturë për shkak të vrullit të ujërave. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të kryhet një studim i thelluar mbi llojin dhe nivelin e ndërhyrjes për prrenjtë malorë, veçanërisht në Kolsh, Zejmen, Kallmet, Blinisht. Kjo zonë ka disa përrenjt malorë të rrëmbyeshëm ku infrastruktura ekzistuese si rrjedhojë e mosmirëmbajtjes është dëmtuar ose shkatërruar, ndërkohë, në raste të tjera mungon. Studimi, përtej gjendjes ekzistuese duhet të përmbajë dhe projektet teknike për rehabilitimin dhe ndërtimin e pritave malore.

**Kosto:** 12,000,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2025

<sup>27</sup> Kjo vlerë është referuar të dhënave të mbledhura nga vizitat në terren, njësitë administrative dhe Bashkia Lezhë deri në Maj 2020, e cila për qëllime të projektit është cilësuar muaji i fundit i mbledhjes së të dhënave. Mbas Majit, situata mund të ketë ndryshuar duke qënë se bashkia ka punuar në pastrimin e kanaleve.



#### **5.5.5 Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Pritave Malore**

Bazuar në studimin e mësipërm, bashkia duhet të kryejë ndërhyrjet për rehabilitimin dhe ndërtimin e pritave malore.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2023-2027

#### **5.5.6 Studim mbi Gjendjen e Digave**

Në bashkinë Lezhë gjënden 5 diga. Në vitin 2011 është kryer një studim nga Mott-Macdonald në lidhje me digat dhe rezervuarët në Shqipëri. Është e rëndësishme që studimi të përditësohet dhe të hartohen projektet teknike për rehabilitimin e tyre sipas nevojave. Digat, përtej rrezikut të përmbytjeve janë një element thelbësor edhe për sigurinë dhe vënien në punë të rezervuarëve për ujitjen e tokave bujqësore. Duke marrë në konsideratë rrezikun e ndryshimeve klimatike dhe shtimin e thatësirave, bashkia duhet të synojë të vendosë sa më parë në punë me kapacitet të plotë rezervuarët. Përpara rivitalizimit të rezervuarëve është e rëndësishme që të garantohet siguria e digave.

**Kosto:** 5,000,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2025

#### **5.5.7 Përmirësimi i Gjendjes së Digave sipas Studimit**

Përmirësimi i gjendjes së digave duhet të kryhet bazuar në projektet e parashikuara në studimin përkatës.

**Kosto:** Sipas studimit

**Periudha e Zbatimit:** 2023-2027

#### **5.5.8 Studim mbi Rivitalizimin e Rezervuarëve për Ujitje dhe për Mundësinë e Hapjes së Rezervuarëve të Rinj**

Ndryshimet klimatike pritet që të sjellin rritjen e thatësirave në të ardhmen dhe të krijojnë kriza përsa i përket ujitjes së tokës bujqësore. Bashkia Lezhë duhet të fillojë të ndërmarrë masa për të garantuar ujitjen. Rehabilitimi i rezervuarëve ekzistues është një element thelbësor në këtë rast. Bashkia duhet të hartojë një studim dhe projekte të detajuara për secilin prej 5 rezervuarëve për rehabilitimin e tyre dhe vënien në funksion. Përtej kësaj, bashkia duhet të studiojë mundësinë e hapjes së rezervuarëve të rinj për të rritur mundësitë e ujitjes në bashkinë Lezhë.

**Kosto:** 13,000,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2023-2027

#### **5.5.9 Marrja e Masave për Rivitalizimin e Rezervuarëve dhe për Hapjen e Rezervuarëve të Rinj**

Pas plotësimit të studimit për rivitalizimin e rezervuarëve dhe për hapjen e rezervuarëve të rinj, bashkia Lezhë duhet të fillojë të zbatojë masat e parashikuara nga studimi. Këto masa duhet të prioritarizohen e më pas të bëhen pjesë e buxhetit si dhe të aplikohet në programe të ndryshme për mbështetje.

**Kosto:** Sipas studimit

**Periudha e Zbatimit:** 2025-2027

**5.5.10 Mirëmbajtja e Argjinaturave të Lumenjve**

Ky funksion është përgjegjësi e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit. Bashkia Lezhë duhet të koordinojë së bashku me bordin dhe ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mirëmbajtjen dhe rehabilitimin (aty ku është e nevojshme) të argjinaturave të lumenjve.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

**5.5.11 Mirëmbajtja e Argjinaturave Detare**

Ky funksion është përgjegjësi e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit. Bashkia Lezhë duhet të koordinojë së bashku me bordin dhe ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mirëmbajtjen dhe rehabilitimin (aty ku është e nevojshme) të argjinaturave detare. Rehabilitimi i argjinaturave detare është shumë i rëndësishëm edhe në optikën e ndryshimeve klimatike.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

**5.5.12 Blerja e Pajisjeve për Pastrimin e Kanaleve**

Pastrimi i kanaleve dytësore është një element thelbësor në zvogëlimin e riskut të përmytjeve në zonat fushore. Për të arritur këtë qëllim është e rëndësishme që bashkia të rrisë kapacitetet e saj me mjete. Në këtë rast, bazuar në diskutime me stafin e bashkisë është e nevojshme pajisja me të paktën 2 traktorë të vegjël dhe një traktor të përmasave më të mëdha dhe me fuqi e kapacitet më të madh.

**Kosto:** 15,000,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

**5.5.13 Studim Sizmik për Ndërtesat me Moshë mbi 30 Vjet**

Nisur nga eksperiencia e tërmetit të Nëntor 2019, është e rëndësishme që bashkia të kryejë një vlerësim të thelluar dhe të detajuar të të gjitha ndërtesave. Kjo gjë do të lejonte një kuptueshmëri më të mirë të gjendjes në realitet dhe marrjen e masave për përforcimin e ndërtesave. Ndërtesat mbi 30 vjet, edhe pse mund të mos kenë pësuar dëme të konsiderueshme nga tërmeti i fundit, mund të jenë të rrezikuara për shkak të projektimit me kushte teknike të ndryshme nga ato të sotmet, materialeve dhe teknikave të ndërtimit të përdorura. Për këtë arsye është e rëndësishme që të kryhet një studim i zgjatur në kohë për të identifikuar problematikat e të gjitha ndërtesave të zhvilluara përpara viteve 1990.

**Kosto:** 854,250,000 LEK<sup>28</sup>

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

28 Kosto është llogaritur duke marrë në konsideratë një vlerë mesatare prej 1500 Euro për studim për secilën ndërtesë.

#### **5.5.14 Studim Sizmik për Ndërtesat me Rëndësi të Veçantë**

Bashkia duhet të ndërmarrë studime të detajuara të ndërtesave me rëndësi të veçantë. Këto ndërtesa mund të cilësohen shkolla, kopshte, çerdhe, spitali, qendra shëndetësore, biblioteka, ndërtesa të trashëgimisë historike e kulturore si dhe në tërësi ndërtesa të cilat janë publike dhe lejojnë për një grumbullim të madh njerëzish. Disa prej këtyre ndërtesave janë vëzhguar nga grupe ekspertësh pas tërmetit, por gjithësesi, në mënyrë që të zvogëlohet risku, është e nevojshme që të kryhen studime më të thelluara.

**Kosto:** 18,750,000 LEK<sup>29</sup>

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.15 Studim Sizmik për Ndërtesat Informale**

Ndërtesat informale, duke qënë se janë ndërtuar pa ndonjë studim të saktë, shpesh në toka me formacione të dobëta, në analogji me ndërtesat të cilat kanë një moshë mbi 30 vjet, është e nevojshme që të kalojnë një verifikim të detajuar në lidhje me cilësinë e ndërtimit dhe përballimit të ngjarjeve të mundshme sizmike në të ardhmen. Këto studime mund të kryhen në bashkëpunim me ALUIZNIN si pjesë e procedurave të legalizimit.

**Kosto:** 215,375,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.16 Studim Sizmik për Ndërtesat në Zona me Rrezik Lëngëzimi**

Në zonën kënetorë (Ishull Lezhë, Tale, Torovicës) në tokat pranë tyre, ka një potencial të lartë të lëngëzimit, siç raportohet nga vëzhgimi gjeologjik i kryer për qëllime të analizës së rreziqeve. Për të rritur sigurinë, dhe marrë masa të nevojshme për reduktimin e rrezikut të lëngëzimit, është e nevojshme që bashkia Lezhë të kryejë një studim të potencialit të lëngëzimit si dhe përshtatshmërisë së themeleve të përzgjedhura në ndërtesat e kësaj zone.

**Kosto:** 274,750,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.17 Marrja e Masave për Përmirësimin e Kushteve të Ndërtesave**

Pas kryerjes së studimeve të mësipërme është e rëndësishme që të merren masat e nevojshme inxhinierike për përmirësimin e kushteve inxhinieriko-sizmike të tyre. Prioritet në këtë rast duhet të kenë ndërtesat për qëllime publike dhe që akomodojnë grupe të mëdha qytetarësh. Gjithashtu, bashkia duhet të punojë ngushtë me komunitetin për të facilituar procesin e ndërgjegjësuar komunitetin për masat që duhen ndërmarrë. Në raste të grupeve në nevojë, ku mund të identifikohen banesa problematike, bashkia mund të shfrytëzojë programet e strehimit social për të përmirësuar gjendjen e tyre.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2023-2027

---

29 Kosto është llogaritur duke marrë në konsideratë një vlerë mesatare prej 1500 Euro për studim për secilën ndërtesë.

**5.5.18 Studim dhe Monitorim i Zonave me Rrezik Rrëshqitje**

Bazuar në vëzhgimin gjeologjik të kryer në kuadër të analizës së rreziqeve natyrore, në bashkinë Lezhë janë evindetuar disa zona të rrezikshme për rrëshqitje toke. Këto zona mund të aktivizohen nga ndërhyrje njerëzore dhe/ose nga rënia e rreshjeve me intensitet të lartë për një kohë të gjatë. Duke marrë në konsideratë tipologjinë e impakteve të ndryshimeve klimatike, ku ndryshimi i regjimit të rreshjeve, me rreshje më intensive dhe në një hark kohor më të shkurtër, mund të krijohen kushtet në të ardhmen për të aktivizuar rrëshqitjen e tokave. Për këtë qëllim, sugjerohet vendosja dhe monitorimi i 3 zonave (Pllanë-Tresh; Kodra e Kalasë; Lezhë-Fishtë) me rrëshqitje, në mënyrë që më pas të merren masa të përshtatshme inxhinierike të cilat do të rrisnin qëndrueshmërinë e shpateve. Monitorimi kryhet me vendosjen e pajisjeve të tipit inklinometës, për një periudhë dy-vjeçare.

**Kosto:** 11,250,000 LEK**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027**5.5.19 Marrja e Masave për Rehabilitimin e Zonave Subjekt Rrëshqitje Toke**

Pas kryerjes së monitorimit të zonave të cilat janë të në rrezik nga rrëshqitja e tokës bashkia Lezhë duhet të ndërmarrë masat për përmirësimin e gjendjes. Këto mund të variojnë nga masa inxhinierike për stabilizimin e shpateve deri në raste ku mund të jetë e nevojshme zhvendosja. Në çdo rast, ky duhet të jetë një vendim i marrë me inxhinierë ekspertë të fushës.

**Kosto:** -**Periudha e Zbatimit:** 2023-2027**5.5.20 Studim mbi Largimin e Shkëmbinjve/Gurrëve me Rrezik**

Janë identifikuar dy zona ku shkëmbinj të bien nga shpatet dhe rrezikojnë rrugët dhe ndërtesat që janë në fund të shpatit. Zonat më të rëndësishme ku është i pranishëm ky fenomen janë në rrugën Balldre-Bushat nga kënetat e Torrovicës për disa vite ka një rënie gurësh në drejtim të shtëpive dhe në rrugë. Nga rënia e gurëve ka pasur dëme materiale dhe njerëzore. Zona ku është ndërtuar qyteza Torrovice dhe rruga janë në fund të shpatit. Pjerrësia është e mbuluar me bimësi, por një pjesë është pa bimësi, e ndërtuar me shkëmbinj gëlqeror. Nga vëzhgimet sipërfaqësore kemi konstatuar se në shpat ka shumë gurë me dimensione të mëdha 1-2m<sup>3</sup> të cilat janë gati të bien. Ky është një fenomen i rrezikshëm që kërcënon jetën e njerëzve që jetojnë atje, është gjithashtu e rrezikshme për automjetet që kalojnë në rrugën për në Torrovicë. Rekomandojmë që të bëhet një studim i detajuar gjeologjik për këtë zonë dhe bazuar në të dhënat e marra nga ky studim, të merren masa inxhinierike për të parandaluar rënien e gurëve dhe për të siguruar rrugën dhe shtëpitë që janë në rrugën Balldre Bushat. Pranë Kënetës së Knallës në rrugën Lezhë-Shëngjin ka patur rënie gurësh të cilët kanë bllokuar rrugën për disa ditë. Janë marrë disa masa inxhinierike të cilat kanë stabilizuar kalimin e automjeteve. Rekomandojmë që për segmentin e rrugës Lezhë-Shëngjin të bëhet një studim i hollësishëm dhe bazuar në të dhënat e marra nga ky studim për të marrë masa inxhinierike për të siguruar rrugën për një kohë të gjatë.

**Kosto:** 10,750,000 LEK**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.21 Marrja e Masave për Largimin e Shkëmbinjve/ Gurrëve**

Pas hartimit të studimit, bashkia Lezhë duhet të fillojë menjëherë që të ndërmarrë masa për largimin e shkëmbinjve/gurrëve. Ndërhyrjet duhet të prioritarizohen sipas nivelit të rrezikut në jetën e banorëve. Ndërhyrjet mund të përfshijnë shpërthime të kontrolluara, mbajtje me masa inxhinierike, si dhe vendosjen e rrjetave gjatë akseve rrugore ku është e pamundur që të përdoren masat e tjera. Disa ndërhyrje mund të kryhen në bashkëpunim me institucionet kombëtare si Ministria e Mbrojtjes (shpërthime të kontrolluara), ARRSH (akse rrugore Nacionale) apo dhe donatorë.

**Kosto:** Sipas studimit

**Periudha e Zbatimit:** 2023-2027

#### **5.5.22 Studim mbi Menaxhimin e Lagunës së Kune-Vain dhe Menaxhimin e Lagunës së Knallës**

Menaxhimi i Lagunës së Kune-Vain dhe Lagunës së Knallës janë një element thelbësor për ZRF. Përtej të qenit një detyrim ligjor, hartimi i planeve të menaxhimit është një mënyrë e rëndësishme për të mirëmbajtur këto dy ekosisteme të rëndësishme kombëtare. Masat e propozuara për menaxhimin e lagunave duhet të bazohen në një qasje të bazuar në ekosistem duke qënë se kemi të bëjmë me hapësira sensitive mjedisore. Planet e menaxhimit duhet të hartohen në koordinim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Drejtoritë Rajonale të Mjedisit si dhe në bashkëpunim me donatorë. Këto plane menaxhimi më pas duhet të harmonizohen me planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë.

**Kosto:** 7,500,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2020-2026

#### **5.5.23 Marrja e Masave për Menaxhimin e Lagunave të Kune-Vain dhe Knallës**

Pas hartimit të planeve të menaxhimit për lagunat dhe zonën e mbrojtur, Bashkia Lezhë, në koordinim me aktorët e tjerë institucionalë duhet të fillojë të ndërmarrë masat e nevojshme. Këto masa janë të nevojshme si në ZRF ashtu edhe përsa i përket ndryshimeve klimatike. Në çdo rast, masat duhet të jenë të kujdeshme e të aplikohen nëpërmjet qasjes së bazuar në ekosistem.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.24 Pyllëzimi i Zonave Pyjore të Djegura**

Çdo vit, bashkia Lezhë ka në territorin e saj sipërfaqe të konsiderueshme pyjesh të djegura. Në këtë rast, është e nevojshme, që çdo vit, bashkia të ndjekë fushatë të vazhdueshme pyllëzimi në mënyrë që të bëjë zëvendësimin e fondit pyjor të djegur. Këshillohet që pyllëzimet të kryhen me pemë autoktone të cilat përshtaten shumë më mirë me kushtet atmosferike, terrenin dhe bimësinë përreth tyre.

**Kosto:** 200,000,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

**5.5.25 Mirëmbajtja e Rrugës Lezhë- Ungrej**

Rruga Lezhë- Ungrej është e vetmja e cila bllokohet për shkak të rreshjeve të borës. Për këtë arsye, për të rritur mundësitë e komunitetit të Ungrejit për të aksesuar shërbimet në periudhat e dimrit, bashkia duhet të kryejë në mënyrë të vazhdueshme mirëmbajtjen e aksit rrugor. Kjo gjë do të përfshijë përdorimi në kripës për raste ngricash, aplikimin e borëpastruesve nëse është e mundur, si dhe në përgjithësi mirëmbajtjen e rrugës.

**Kosto:** 1,000,000 LEK**Periudha:** 2021-2027**5.5.26 Zgjerimi i Hapësirave të Gjelbra në Qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin**

Hapësirat e gjelbra luajnë një rol të rëndësishëm në zonat urbane, veçanërisht në uljen e temperaturave dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Për të shmangur krijimin e fenomenit të ishujve të nxehtësisë urbane është shumë e rëndësishme që të shtohen hapësirat e gjelbra. Gjithashtu, hapësirat e gjelbra luajnë një rol të rëndësishëm në uljen e riskut të përmytjeve në raste të rreshjeve me intensitet të lartë. Bashkia Lezhë duhet të shtojë hapësirat e gjelbra në zonat urbane. Këto hapësira duhet të zhvillohen në konceptin e infrastrukturës së gjelbër dhe të planifikohen duke marrë një qasje të bazuar në ekosistem.

**Kosto:** 60,000,000 LEK**Periudha:** 2021-2027**5.5.27 Studim Fizibiliteti për Reduktimin e Riskut nga Rritja e Nivelit të Detit**

Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me qeverisjen qendrore dhe donatorë, duhet të ndërmarrë një studim për masat për reduktimin e riskut nga rritja e nivelit të detit. Këto studime janë shumë të kushtueshme dhe hartohen nga grupe të specializuara. Për shkak të ndryshimeve klimatike, bregu në bashkinë Lezhë pritet të përballlet me sfida të shumta në vitet në vijim, të cilat nuk mund të përballen nga qasje të lokalizuara e të vogla. Një nga alternativat është dhe vendosja e barrierave në brendësi të detit të cilat ngadalësojnë shpejtësinë e dallgëve.

**Kosto:** 250,000,000**Periudha:** 2021-2027**5.5.28 Studim Inxhinierik për Gjendjen e Infrastrukturave Kritike (ura)**

Bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe të riskut, janë evidentuar një sërë urash të cilat kanë probleme inxhinierike dhe mund të dëmtohen më tej në rast të fatkeqësive natyrore. Urat janë infrastrukturë kritike pasi shkatërrimi i tyre mund të bllokojë lëvizjen e popullatës në rast evakuimi. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që bashkia Lezhë të bëjë një inspektim të thelluar të të gjitha urave të identifikuara si problematike.

**Kosto:** 11,250,000 LEK**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.29 Marrja e Masave Inxhinierike për Përmirësimin e Gjendjes së Infrastrukturave Kritike (ura)**

Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në nivel kombëtar, pas hartimit të studimeve në lidhje me gjendjen e infrastrukturave kritike, duhet të ndër marrë menjëherë ndërhyrjet përkatëse.

**Kosto:** - **Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.30 Rehabilitimi i Fashës Ripariane të Lumit Mat**

Për shkak të ndërhyrjeve të shumta në nxjerrjen e inerteve, fasha ripariane e lumit Mat është dëmtuar. Në këtë rast, për të zvogëluar riskun e përmytjeve si dhe për të parandaluar erozionin, është e nevojshme që të rehabilitohet fasha ripariane. Këto ndërhyrje mund të jenë në mbjellje të bimësisë, si dhe në raste të caktuara ndërhyrje në zhvendosje aktivitetesh, apo dhe ndërtesash.

**Kosto:** - **Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.31 Rehabilitimi i Fashës Ripariane të Lumit Drin**

Për shkak të ndërhyrjeve të shumta, ndërtimeve, apo mungesës së mirëmbajtjes, fasha ripariane e lumit Drin është dëmtuar. Në këtë rast, për të zvogëluar riskun e përmytjeve si dhe për të parandaluar erozionin, është e nevojshme që të rehabilitohet fasha ripariane. Këto ndërhyrje mund të jenë në mbjellje të bimësisë, si dhe në raste të caktuara ndërhyrje në zhvendosje aktivitetesh, apo dhe ndërtesash.

**Kosto:** - **Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

#### **5.5.32 Mirëmbajtja e Vazhdueshme e Hidrovorëve**

Hidrovorët luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e sistemit hidrik në Lezhë. Për këtë qëllim, bashkia duhet të mirëmbajë hidrovorët dhe të kryejë riparimet e nevojshme në rast dëmtimesh. Hidrovorët duhet të jenë në gjendje pune si dhe të pajisur me gjeneratorë rezervë në rast dëmtimesh të rrjetit elektrik.

**Kosto:** - **Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

## 5.6 MASAT PËR OS4: NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, OPERACIONALE DHE PËRGATITJA PËR PËRBALLJEN E SITUATAVE EMERGJENTE

### 5.6.1 Hartimi, Monitorimi dhe Përditësimi i Planit të Emergjencave Civile

Si pjesë e këtij projekti, është përgatitur edhe plani i Emergjencave Civile. Ky plan, duhet të monitorohet dhe të përditësohet bazuar në parashikimet ligjore. Detyra për monitorimin dhe përditësimin e planit të emergjencave është e Drejtorisë së Emergjencave Civile në bashki.

**Kosto:** -

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.6.2 Hartimi i Planeve të Evakuimit në Ndërtesa të Rëndësisë së Veçantë dhe Vendosja e Sinjalistikës së Nevojshme

Në të gjitha ndërtesat publike duhet të hartohen dhe të vendosen planet e evakuimit dhe të pajisen me sinjalistikën e nevojshme. Në shumë raste, në shkolla apo institucione publike ekzistojnë planet e evakuimit por nuk ka sinjalistikën e duhur për të orientuar evakuimin e njerëzve.

**Kosto:** 56,250,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

### 5.6.3 Plotësimi i Nevojave me Pajisje për Rastet e Emergjencave

Bazuar në parashikimet e Planit të Emergjencave Civile duhet të bëhet plotësimi me pajisje për rastet e emergjencave

**Kosto:** Sipas planit

**Periudha e zbatimit:** 2021-2027

### 5.6.4 Ngritja e Sistemeve të Paralajmërimit të Hershëm

Bashkia Lezhë aktualisht nuk ka një sistem të formalizuar të Paralajmërimit të hershëm në rast të fatkeqësive natyrore. Ky sistem mungon fizikisht, në formën e alarmeve të vendosura në pika të ndryshme të bashkisë, ashtu si dhe elektronikisht. Duke marrë në konsideratë avancimin e teknologjisë dhe koston e ngritjes së sistemeve të tilla të alarmit, mundësia më e mirë është duke përdorur aplikacione të cilat instalohen dhe shpërndahen nëpërmjet telefonave. Sisteme të ngjashme janë ngritur dhe në vende të rajonit si për shembull Kosova<sup>30</sup>. Këto lloj sistemesh janë të lehta për tu përdorur, ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit në kohë reale, dhe në krijimin e databazave për rreziqet. Ky lloj sistemi do të ishte pilot dhe hera e parë që aplikohet në rastin e Shqipërisë. Sfida në këtë rast, është mirëmbajtja nga ana e bashkisë. Pas ndërtimit të arkitekturës së sistemit dhe aplikacionin, bashkia duhet të krijojë një databazë dhe duhet të mirëmbajë në mënyrë të herëpashërshme aplikacionin.

**Kosto:** 150,000,000 LEK

**Periudha e Zbatimit:** 2021-2027

30 <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/presscenter/articles/2013/05/28/mobile-app-to-reduce-the-risk-of-disasters.html>



# ZHVILLIMI I SKENARËVE

---



Ky kapitull bën një vlerësim cilësor të skenarëve të zhvilluar për secilin rrezik në Bashkinë Lezhë, duke konsideruar disa qasje veprimi:

- Të mos bëhet asgjë
- Të kryhen ndërhyrje afatmesme me kosto të ulët
- Të kryhen ndërhyrjet afatgjata me kosto të lartë

Në fund të këtij seksioni bëhet një vlerësim i efektshmërisë në territory të ndërhyrjeve të propozuara


### 6.1 PËRMBYTJET

#### Skenari 1

Ky skenar parashikon ndodhjen e njëhershme të përmbytjeve në gjithë territoret e ndikuara historikisht / potencialisht nga to. Ky skenar nënkupton përmbytje të 111.9 ha rrugë, 1356 Ha sipërfaqe urbane, dhe më tepër se 1/3 e popullsisë së ndikuar.

Ndikimi më i qënësishëm dallohet në njësitë Zejmen, Kolsh, Shënkoll dhe Lezhë, pra kryesisht sipërfaqet fushore të bashkisë.


FIG 12. Skenari 1 Përmbytjet–Nuk ndodh asgjë



## Skenari 2: Ndërhyrje afatmesme – kosto e ulët

Ky skenar parashikon ndërhyrje përmirësuese në kanalet dytësore dhe tretësore, si dhe rehabilitim të pritave malore dhe argjinaturave lumore. Nëse kjo ndërhyrje e integruar ndodh në masën 100%, risku i përmbytjeve në bashki ulet në mënyrë të ndjeshme, duke lejuar vetëm përmbytje të shkaktuara nga batica detare, me periodicitet një herë në 15 vite, apo më shumë. Por në bazë të këtij skenari, vazhdojnë të përmbyten zonat ligatinore të fundosura, sidomos zona e Torovicës.

FIG 13. Skenari 2 Përmbytjet– Ndërhyrje afatmesme- kosto e ulët




Burimi: Autorët

### Skenari 3: Ndërhyrje afatgjatë – kosto e lartë

Këto ndërhyrje përfshijnë investime të kushtueshme në përforsim të infrastrukturës teknike kritike. Të tilla janë investime në përforsimin e digave të rezervuarëve, ndërtimi i dallgëpritëseve detare, si dhe ndërhyrje në hidrovore, duke ngritur nivelin e operimit të tyre. Këto janë ndërhyrje ambicioze që tejkalojnë periudhën e zbatimit të këtij Plani, por do ishin të rendësishme për minimizimin me 90% të riskut nga përmbytjet.

Ky skenar vlen të realizohet pas realizimit të skenarit 2. I vetëm ai do arrinte të shmangte dukuritë e përmbytjes me probabilitet shumë të vogël (1 në 15 vite për baticat detare, 1 në 30 vite për përmbytje të digave të rezervuarëve, etj). Gjithsesi këto përmbytje nëse ndodhin do ishin fatale.

FIG 14. Skenari 3 Përmbytjet– Ndërhyrje afatgjatë – kosto e lartë




Burimi: Autorët

## 6.2 RREZIQET METEOROLOGJIKE

### Skenari 1

Ky skenar parashikon ndodhinë e stuhive të erës në pjesën fushore të bashkisë, si dhe stuhitë e dëborës në zonën kodrinore-malore. Ndikimi është l theksuar në njësitë Balldren e Shënkoll për ndikimin nga era, ku periodikisht stuhitë e erës pengojnë qarkullimin, dëmtojnë të mbjellat dhe mund të shkaktojnë dhe dëmtime të cative dhe serave, si dhe aksidente. Stuhitë e dëborës ndikojnë drejtpërdrejt në bllokim të qarkullimit dhe aktivitetit normal në Njësinë Ungrej për disa ditë. Si rrjedhojë, mosmarrja e masave do ndikonte jetueshmërinë normale të rreth 3000 personave, si dhe aktivitete bujqësore e ekonomike në gjithë bashkinë.


FIG 15. Skenari 1 Rreziqet meteorologjike – Nuk ndodh asgjë



### Skenari 2

Duke realizuar ndërhyrje të kufizuara, ndikimi I dukurive meteorologjike mund të minimizohet në masën 80%. Ndërhyrja më domethënëse është mirëmbajtja dhe pajisja me infrastrukturë ndihmëse të rrugës Kallmet-Ungrej, për të shmangur ngrirjen e aksit nga dëbora. Ndërhyrja e dytë përfshin masat për përforsimin e cative dhe strukturave të serave, si dhe objekteve të dëmtuara nga stuhitë / tërmeti në bashki, vecanërisht në fshatin Rrilë dhe në fushën e Torovicës. Ky investim përfshin studim e ndërhyrje në 1290 shtëpi që ndodhen në zonën e ndikimit të stuhive të erës. Këto ndërhyrje janë të rëndësishme për të kufizuar riskun meteorologjik në bashki.

FIG 16. Skenari 2 Ndërhyrje afatmesme- kosto e ulët




Burimi: Autorët

## 6.3 RREZIQET GJEOLGJIKE

### Skenari 1

Rreziqet gjeologjike për Bashkinë Lezhë përfshijnë dukurinë e rëzimit të gurëve dhe atë të rrëshqitjes së tokës. Aktualisht nga këto dukuri në bashki janë numëruar 4 fatalitete, por risku është i lartë për rreth 1500 banorë që ndodhen në zona me rrezik rrëshqitje, dhe 2400 në zona me rrezik rënie gurësh. Njësitë më të ndikuara nga kjo dukuri janë Kolshi dhe Zejmen, duke përfshirë dhe qytetin e Lezhës.

FIG 17. Skenari 1 Rreziqet gjeologjike – Nuk ndodh asgjë




Burimi: Autorët

### Skenari 2

Ndërhyrjet afatmesme të propozuara për minimizimin e rreziqeve gjeologjike adresojnë menaxhimin e rrëzimit të gurëve. Kjo propozohet të bëhet me shpërthime individuale për shkëmbinj të vecantë, dhe me vendosje të rrjetave të gurit në zona problematike, si rruga e Kënallës. Nëse ndërmerren këto masa, impakti pozitiv do ndjehej mbi 2445 ndërtesa, rreth 10 000 banorë, si dhe 53 km rrugë pa dëmtime dhe pa risk aksidentesh.

FIG 18. Skenari 2 Rreziqet gjeologjike - Ndërhyrje afatmesme- kosto e ulët




Burimi: Autorët



### Skenari 3

Kjo ndërhyrje adreson rrëshqitjen active të tokës në zonat problematike të qytetit të Lezhës, si dhe në fshatrat Pllanë, Zejmen dhe Spiten. Për të kryer ndërhyrjet është e nevojshme të bëhet një studim I thelluar gjeologjik, për të përcaktuar metodat optimale të ndërhyrjes. Këto investime në stabilizim të zonave do eliminonin riskun deri 100% për 1272 ndërtesa dhe 22 km rruge.

FIG 19. Skenari 3 Rreziqet gjeologjike - Ndërhyrje afatgjata – Kosto e lartë



Burimi: Autorët

## 6.4 ZJARRI


### Skenari 1

Ky skenar përfshin rrezikun e rënies së njëkohshme të zjarrit në gjithë pyjet e Bashkisë Lezhë, duke pasur parasysh drejtimin e levizjes së erës, dhe një rreze ndikimi 200-500 metra nga kufijtë e zones së zjarrit. Nëse nuk merren masa paraprake, rrezikohen të digjen 80% e sipërfaqes pjore të Bashkisë Lezhë, duke rrezikuar:

- 38 institucione arsimore
- 11 qendra shëndetësore
- 10320 ndërtesa
- 420 objekte shërbimesh, administrate, etj
- 220 ha infrastrukturë rrugore

Zona e ndikimit të zjarrit do arrijte 41 575 Ha, me ndikim të vecantë në Njësitë Kallmet dhe Ungrej.


FIG 20. Skenari 1 Rreziku nga zjarri – Nuk ndodh asgjë



## Skenari 2

Ndërhyrjet afatmesme parashikojnë 2 forma investimesh: pastrimin e nënpyllit dhe mirëmbajtjen e pyjeve, për të minimizuar përhapjen e shkëndijave; si dhe hapjen e rrugëve ushtarake, për të lehtësuar ndërhyrjet të forcave të MZSH në raste emergjence. Këto ndërhyrje do përmirësojnë situatën e ndikimit të zjarrit në masë 80%, duke minimizuar gjurmën e rrezikut në masë të konsiderueshme.

FIG 21. Skenari 2 Rreziku nga zjarri – Ndërhyrje afatmesme – Kosto e ulët




Burimi: Autorët

## 6.5 SIZMIKA

### Skenari 1

Aktualisht po merren masa për rahabilitimin dhe rindërtimin e banesave që janë dëmtuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Në qytetin e Lezhës po rihvillohen dy zona nëpërmjet Planeve të Detyruara vendore, duke akomoduar dëmet në strehim të shkaktuara vitin e shkuar. Ndërkohë, nuk po merren masa për përbalimin e dëmeve të mundshme nga tërmete të ardhshme. Këto dëme do prekin në mënyrë më domethënëse ndërtesat që ndodhen në zonat ish-kënetore me prirje për lëngëzim; si dhe ndërtesat me moshë mbi 30 vjecare, vecanërisht ato të ndërtuara informalisht. Ky rrezik, nëse nuk merren masa, prek 1732 ndërtesa në zona informale; rreth 3500 ndërtesa mbi 30 vjecare, 2100 ndërtesa të shtrira në zone me rrezik lëngëzimi, 121 ndërtesa shërbimesh, 20 ha zone industriale, etj.


FIG 22. Skenari 1 Rreziku sizmik – Nuk ndodh asgjë



## Skenari 2

Studimi i përgjithshëm i tipologjive të ndërtesave në Bashkinë Lezhë sugjeron që është e nevojshme të bëhet një studim i thelluar i gjithë objekteve që ndodhen në zone me rrezik lëngëzimi, veçanërisht ato që janë mbi 30 vjeçare. Ky studim do përfshinte diagnostikimin e minimum 300 ndërtesave, për të marrë më tej masa të qënësishme mbi

FIG 23. Skenari 2 Rreziku sizmik – Ndërhyrje afatmesme – Kosto e ulët




Burimi: Autorët

### Skenari 3

Skenari me kosto më të lartë nënkupton kryerjen e përforcimit sismik për gjithë objektet socio-kulturore të Bashkisë Lezhë, vecanërisht ato me moshë mbi 30 vjeçare, apo që ndodhen në truall të lëngëzueshëm. Aktualisht nga 55 objekte të rendësisë kulturore, 14 janë në kushte të rrezikut sismik. Përveç tyre, vlerësimi dhe përforcimi duhet të përfshijë objektet e tjera arsimore, shëndetësore, administrative, si dhe objektet e konsideruara të rrezikuara sipas skenarit 2. Ky investim do ulte riskun sismik për më shumë se 6000 objekte, duke ndikuar mbi jetueshmërinë e rreth 40 000 banorëve.

FIG 24. Skenari 3 Rreziku sismik – Ndërhyrje afatgjata – Kosto e lartë



Burimi: Autorët

# MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË



Bashkia Lezhë, përkatësisht Drejtoria e Emergjencave Civile, ngarkohet me monitorimin e zbatimit të strategjisë së ZRF. Bazuar në ligjin përkatës, strategjia ka një afat 5 vjeçar. Vlerësimi i riskut duhet të kryhet një herë në 3 vjet, ndërkohë që plani duhet të rishikohet gjithashtu një herë në 3 vjet. Kësisoj, për të kryer dhe një herë vlerësimet, bashkia duhet të kryejë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme.

Bashkia Lezhë, duhet të bëjë pjesë të buxhetit të saj dhe masat e ndryshme të cilat vijnë nga strategjia e ZRF dhe Planit të Emergjencave Civile. Përtej kësaj, sektorët e ndryshëm duhet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin për të zbatuar projekte të cilat ndikojnë pozitivisht në ZRF. Bashkëpunimi duhet të jetë si në nivel rajonal, ashtu edhe me qeverisjen qendrore, veçanërisht për projekte të cilat kanë përgjegjësi të përbashkët si menaxhimi i mjedisit. Gjithashtu, komuniteti duhet të angazhohet në zbatim të strategjisë.

Zbatimi i strategjisë së RRF në Bashkinë Lezhë përballet me rreziqe të ndryshme, të cilat mund të vijnë si rezultat i mungesës së kapaciteteve, mungesës së fondeve, mungesës së angazhimit të aktorëve publik dhe komunitetit etj. Bashkia duhet të ndërmarr masa institucionale për të zvogëluar rreziqet e paraqitura në Tabelën 2.

Bashkia Lezhë duhet të kryejë monitorimin vjetor të zbatimit të strategjisë. Për secilin prej aktiviteteve dhe masave të strategjisë, janë identifikuar një sërë treguesish për të bërë monitorimin dhe matjen e zbatimit të saj. Treguesit janë identifikuar në bazar aktiviteti ose mase dhe janë një listë fillestare. Bashkia Lezhë, dhe komisioni i Mbrojtjes Civile duhet që në vitet në vijim të pasurojnë listën e treguesve dhe ti përshtatin ato me kapacitetet e bashkisë për ti matur.

**TABELA 4. Indikatorët e Monitorimit**

Objekti	Masa	Tregues
<b>OS1</b> Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për ZRF	1.1 Ngritja e Grupeve Vullnetare	Nr Vullnetar të rinj në vit Nr Vullnetar / 1000 Banorë
	1.2 Trajnimi i Grupeve Vullnetare	Nr Trajnime Vullnetare në Vit Nr Vullnetar të Trajnuar Aktivitete trajnimi/ vit
	1.3 Trajnimi i Komunitetit	Nr Banorë të trajnuar/ 1000 Banorë
	1.4 Fushata Informimi Komuniteti	Nr fushata informimi
	1.5 Fushata Ndërgjegjësimi për pastrimin e kanaleve tretësore nga fermerët	Nr fermerë të lajmëruar/ 1000 fermerë Km linear kanale të pastruara (Kml K të pastruar (t1)- kml K të pastruar (t0))
	1.6 Fushata Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj zjarrit në pyje	Nr banorë të ndërgjegjësuar/ 1000 banorë Reduktimi i Nr të Zjarreve (Zjarre(t1)- Zjarre (t0))



Objektivi	Masa	Tregues
<b>OS1</b> Informimi, ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve komunitare për ZRF	1.7 Trajnim i Komunitetit për Shërbimet e Ekosistemit	Nr Trajnime ne fushen e Shërbimeve të Ekosistemit Nr Banorë të Trajnuar/ 1000 Banorë
	1.8 Menaxhimi i Ekonomive Pyjore nga komuniteti	Nr. Kontrata të nënshkruara Ha Pyje të menaxhuara nga komuniteti
<b>OS2</b> Ngritja e kapaciteteve institucionale, qeverisëse për ZRF	2.1 Trajnim i vazhduar Stafi i bashkisë për ZRF	Nr staf i bashkisë i trajnuar/ nr total staf bashkie
	2.2 Trajnim i vazhduar i Komitetit të Mbrojtjes Civile	Nr. Anëtarë të Komitetit të Mbrojtjes Civile të trajnuar në vit
	2.3 Rishikimi i PPV me fokus përshtatjen për ZRF	PPV e rishikuar dhe miratuar
	2.4 Rishikimi i Strategjive dhe Planeve Sektoriale me fokus ZRF	Nr. Plane ose Strategji rishikuara ose hartuara rishtazi që përfshijnë ZRF
	2.5 Ngritja dhe mirëmbajtja e databazës së ZRF në Bashkinë Lezhë	Databaza e ngritur
	2.6 Trajnimi i Stafit të Drejtorisë së Emergjencave Civile në përdorimin e GIS dhe mirëmbajtjen e databazës	Nr trajnime në vit për GIS (drejtoria e Mbrojtjes Civile)
<b>OS3</b> Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive	3.1 Pastrimi i Kanaleve Parësore	Kml Kanale parësore të pastruara (t1)- Kml kanale parësore të pastruara (t0) Kml Kanale parësore të pastruara/ Kml kanale parësore total
	3.2 Pastrimi i Kanaleve Dytësore	Kml Kanale dytësore të pastruara (t1)- Kml kanale parësore të pastruara (t0) Kml Kanale dytësore të pastruara/ Kml kanale parësore total
	3.3 Pastrimi i Kanaleve Tretësore	Kml Kanale dytësore të pastruara (t1)- Kml kanale parësore të pastruara (t0) Kml Kanale dytësore të pastruara/ Kml kanale parësore total
	3.4 Studim për Rehabilitimin dhe Ndërtimi i Pritave Malore	Studimi i Mbaruar
	3.5 Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Pritave Malore	Prita malore të rehabilituara (t1)/ prita malore totale S (ha) e përmbytur nga përrenj malorë (t1)/ S(ha) e përmbytur nga përrenj malorë (t0) në vit
	3.6 Studim mbi gjendjen e digave	Studimi i Përfunduar
	3.7 Përmirësimi i gjendjes së digave sipas studimit	Diga të Rehabilituara
	3.8 Studim mbi rivitalizimin e rezervuarëve për ujitje dhe për mundësinë e hapjes së rezervuarëve të rinj	Studimi i Përfunduar
	3.9 Përmirësim i gjendjes së rezervuarëve dhe krijimi i rezervuarëve të rinj	S (ha) tokë bujqësore e ujitur në vitin (t1)- S (ha) tokë bujqësore e ujitur në vitin (t0)
	3.10 Mirëmbajtja e Argjinaturave të Lumenjve	Lek të shpenzuar për mirëmbajtjen e argjinaturave të lumenjve

Objektivi	Masa	Tregues
	3.11 Mirëmbajtja e Argjinaturave Detare	Lek të shpenzuar për mirëmbajtjen e argjinaturave të detare
	3.12 Blerja e Pajisjeve për pastrimin e kanaleve	Pajisje të blera
	3.13 Studim sizmik për ndërtesat me moshë mbi 30 vjet	Nr. ndërtesa mbi 30 vjet të studiura/ Nr ndërtesa mbi 30 vjet në total
	3.14 Studim sizmik për ndërtesat me rëndësi të veçantë	Nr. ndërtesa me rëndësi të veçantë të studiura/ Nr. Ndërtesa me rëndësi të veçantë në total
	3.15 Studim sizmik për ndërtesat informale	Nr. Ndërtesa informale të studiura/ Nr total ndërtesash informale
	3.16 Studim sizmik për ndërtesat në zona me rrezik lëngëzimi	Nr. Ndërtesa në zona me rrezik lëngëzimi të studiura/ nr ndërtesa në total në zona me rrezik lëngëzimi
	3.17 Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes së strukturave bazuar në studimet e mëspërme	Nr. Ndërtesa të përforcuara / nr total ndërtesash të cilat kanë nevojë për përforcime
	3.18 Studim dhe Monitorim i Zonave me rrezik Rrëshqitje	Nr inclinometra të instaluar Studimi i përfunduar
	3.19 Marrja e masave për stabilizimin e rrëshqitjeve	Sipas studimit
	3.20 Studim mbi largimin e Shkëmbinjve/ Gurrëve me rrezik	Studimi i Përfunduar
	3.21 Marrja e masave për largimin e shkëmbinjve dhe gurrëve me rrezik	Sipas studimit
	3.22 Studim mbi menaxhimin e lagunës së Kune-Vain dhe menaxhimin e lagunës së Knallës	Plani i Menaxhimit i muratura
	3.23 Marrja e masave për përmirësimin e gjendjes në Laguna	Sipas planit të menaxhimit
	3.24 Pyllëzimi i Zonave Pyjore të Djegura	Sip (ha) zona pyjore të djegura të pyllëzuara (t1) – Sip (ha) pyjore totale të djegura
	3.25 Mirëmbajtja e Rrugës Lezhë- Ungrej	Lek/ vit të shpenzuara për mirëmbajtjen e Rrugës Lezhë- Ungrej
	3.26 Zgjerimi i Hapësirave të Gjelbra në Qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin	Sip m2 e hapësirave të gjelbra (t1) – Sip m2 e hapësirave të gjelbra (t0)
	3.27 Studim fizibiliteti për zvogëlimin e riskut nga rritja e nivelit të detit	Studimi i fizibilitetit i mbaruar
	3.28 Studim inxhinierik për gjendjen e infrastrukturave kritike (ura)	Studimi i Përfunduar
	3.29 Marra e masave per nderhyrje inxhinierike në ura	Ura të rehabilituara/ ura të cilat kanë nevojë për rehabilitim
	3.30 Rehabilitimi i Fashës Ripariene të Lumit Mat	Vegjetacion Riparian I mbjellur
	3.31 Rehabilitimi i Fashës Ripariene e Lumit Drin	Vegjetacion Riparian i mbjellur
	3.32 Mirëmbajtja e Vazhdueshme e Hidrovorëve	Lek të shpenzuar në vit për të mirëmbajtur hidrovorët

<b>OS4</b> Ngritja e kapaciteteve institucionale, operacionale dhe përgatitja për përballjen e situatave emergjente	4.1 Hartimi, Monitorimi dhe Përditësimi i Planit të Emergjencave Civile	Raporti Vjetor i Monitorimit i publikuar dhe i aksesueshëm  Plani i Emergjencave i Rishikuar
	4.2 Hartimi i Planeve të Evakuimit në ndërtesa të rëndësishme të veçantë dhe vendosja e sinjalistikës së nevojshme	Nr ndërtesa të rëndësishme të veçantë e plotësuar me plane evakuimi dhe sinjalistikë
	4.3 Plotësimi i nevojave me pajisje për rastet e emergjencave	Nr në dispozicion automjete zjarrfikëse, automjet shpëtimi, automjete gërmimi, automjete me kalueshmëri të lartë autoskallë, motorbarka, tenda, kontejnerë, thasë rëre, gjeneratorë, soba, sharra, pompa etj. sikurse edhe artikuj të ndihmës së parë për popullsinë e strehuar (krevatë portativë, batanije, çarçafë, jastëkë, dyshekë, shtroje plastike)
		Buxhet në LEK i shpenzuar në vit
	4.4 Ngritja e Sistemeve të Alarmit	Sistemi i ngritur  Nr. Përdorues Sistemi/ 1000 Banorë  Nr. Lajmërime nga Sistemi/ Nr fatkeqësi të ndodhura në vit

Shqipëria, si pjesë e aderimit në Kuadrin Sendai, ka përgjegjësitë e saja, si për marrjen e masave ashtu dhe për raportimin në plotësimin e objektivave. Aktualisht, ky lloj raportimi bëhet në nivel kombëtar, me të dhëna të cilat vijnë nga institucionet qendrore dhe autoritetet vendore. Në këtë kuadër, do të ishte frytdhënëse që bashkitë të krijojnë bazat e tyre të raportimit në lidhje me Kuadrin Sendai. Llogaridhënia është një nga elementët thelbësorë në zbatimin e kuadrit Sendai, e për këtë qëllim janë përgatitur një set me tregues të cilët përdoren për raportim. Ky set treguesish është përshtatur edhe për nivelin vendor, në rastin e Bashkisë Lezhë, si pilot për raportimin e njëjësive vendore. Tabela e mëposhtme jep indikatorët të cilët duhet të maten e raportohen:

**TABELA 5. Indikatorët për raportimin e kuadrit Sendai**

Qëllimi: Zvogëlimi i Fataliteteve nga Fatkeqësitë Natyrore				
Treguesi A		2020	2021	2023
1	Nr. i vdekjeve rezultat i fatkeqësive natyrore/ 10000 banorë			
2	Nr. persona të deklaruar të humbur rezultat i fatkeqësive natyrore/ 10,000 banorë			
Qëllimi: Zvogëlimi i personave të ndikuar nga fatkeqësitë natyrore				
Treguesi B		2020	2021	2023
1	Nr. persona të plagosur ose sëmurur në mënyrë të drejtpërdrejtë si rezultat i fatkeqësive natyrore/ 10 000 banorë			
2	Nr. persona të cilëve i është dëmtuar banesa në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fatkeqësitë natyrore			
3	Nr. persona të cilëve i është shkatërruar banesa në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fatkeqësitë natyrore			
4	Nr. persona të cilëve i është ndikuar jetueshmëria në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fatkeqësitë natyrore			

**Qëllimi: Zvogëlimi i humbjeve ekonomike për shkak të fatkeqësive natyrore**

Treguesi C	2020	2021	2023
1	Kosto ekonomike të drejtpërdrejta (LEK) për shkak të fatkeqësive natyrore në raport me GDP në nivel qarku		
2	Humbje të drejtpërdrejta në bujqësi (LEK) për shkak të fatkeqësive natyrore		
3	Kosto të drejtpërdrejta ekonomike (LEK) nga humbja e aseteve të tjera prodhuese për shkak të fatkeqësive natyrore		
4	Kosto ekonomike në sektorin e strehimit (LEK) për shkak të fatkeqësive natyrore		
5	Kosto ekonomike nga dëmtimi i infrastrukturave kritike (LEK) për shkak të fatkeqësive natyrore		
6	Kosto ekonomike nga dëmtimi i trashëgimisë kulturore (LEK) për shkak të fatkeqësive natyrore		
7	Kosot ekonomike nga djegia e pyjeve (LEK) për shkak të fatkeqësive natyrore		

**Qëllimi: Zvogëlimi i infrastrukturës kritike të dëmtuar për shkak të fatkeqësive natyrore**

Treguesi D	2020	2021	2023
1	Dëme të drejtpërdrejta në infrastrukturë kritike nga fatkeqësi natyrore		
2	Nr. i institucioneve arsimore të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësitë natyrore		
3	Nr. institucione shëndetësore të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësi natyrore		
4	Nr. infrastrukturë kritike (ura) të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësi natyrore		
5	Nr. infrastrukturë kritike (argjinatura) të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësi natyrore		
6	Nr. infrastrukturë kritike (hidrovore) të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësi natyrore		
7	Nr. infrastrukturë kritike (energjitike) të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësi natyrore		
8	Nr. infrastrukturë kritike (institucione publike) të dëmtuara ose shkatërruara nga fatkeqësi natyrore		

**Qëllimi: Përfshirrja e ZRF në qeverisjen e territorit**

Treguesi E	2020	2021	2023
1	% e Zbatimit të masave të Strategjisë së ZRF në Bashkinë Lezhë		
2	% e Zbatimit të masave të Planit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Lezhë		

**Qëllimi: Rritja e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në fushën e ZRF**

Treguesi F	2020	2021	2023
1	Mbështetje ndërkombëtare (LEK) në fushën e ZRF		
2	Mbështetje ndërkombëtare (LEK) për transferimin e teknologjisë në fushën e ZRF		
3	Mbështetje ndërkombëtare (LEK) për ngritjen e kapaciteteve në ZRF		

#### Qëllimi: Rritja e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në fushën e ZRF

- |   |  |
|---|--|
| 4 | Nr. marrëveshje bilaterale, rajonale, ndërkombëtare në fushën e ZRF          |
| 5 | Nr. Projekte ndërkombëtare (IPA) me bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e ZRF |

#### Qëllimi: Rritja e mbulimit dhe personave që kanë akses në sisteme të lajmërimit të hershëm

Treguesi G	2020	2021	2023
1	% e popullsisë së mbuluar nga sisteme lajmërimi të hershëm në Bashkinë Lezhë		
2	% e popullsisë së trajnuar për reagim në rast të një alarmi për fatkeqësi natyrore		

Dy tabelat e sipërpërmendura ndihmojnë Bashkinë Lezhë për të monitoruar zbatimin e strategjisë si dhe për të raportuar mbi impaktin e politikave të ndjekura. Çdo vit, Bashkia Lezhë duhet të përgatisë një raport të monitorimit të situatës. Raporti duhet të prezantohet në komisionin e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Lezhë si dhe duhet të dërgohet tek Prefekti i qarkut dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

#### 1- Hyrje (1 faqe)

Shkurtimisht prezantohet qëllimi i raportit, metodologjia e ndjekur për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.

#### 2- Ngjarje në Bashkinë Lezhë (1 faqe)

Shkurtimisht prezantohen raste të fatkeqësive natyrore që mund të kenë ndodhur gjatë vitit në Bashkinë Lezhë dhe përgjigjen që është dhënë nga autoriteti vendor

#### 3- Projekte në kuadër të ZRF (2 faqe)

Shkurtimisht prezantohen të gjitha projektet që ka zhvilluar (të përfunduara ose në vijim) që Bashkia Lezhë është duke aplikuar në fushën e ZRF.

#### 4- Raport i shkurtër mbi gjendjen e zbatimit të Strategjisë (2 faqe)

#### 5- Raport i shkurtër mbi gjendjen e ZRF në Bashkinë Lezhë (1 faqe)

#### 6- Konkluzione dhe Rekomandime (2-3 faqe)

Shkurtimisht jepen konkluzionet mbi atë që ka ndodhur. Cilat kanë qënë arritjet në fushën e ZRF dhe cilat kanë qënë mangësitë. Gjithashtu, jepet dhe një listë me ndërhyrje të mundshme ose rekomandime për të përmirësuar situatën.

#### 7- Aneks

- 1- Tabela e Monitorimit të Zbatimit të Strategjisë
- 2- Tabela e Monitorimit të ZRF në Bashkinë Lezhë

## REFERENCA

- ACP, (2014). *Korridori i Kaltër, (online)* <http://acp.al/projects/169/Korridori-i-kalter>. [Aksesuar: 27/07/2020]
- AKM, (2018). Raporti i Gjendjes në Mjedis 2018, Tiranë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- AKM, (2018b). Monitorimi i zhurmave Urbane në qytete të ndryshme, Tiranë: AKM
- AKPT & MZHU, (2016). Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, Tiranë: AKPT
- AKPT & MZHU, (2016b). Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, Tiranë: AKPT
- AKZM, (2020) *Harta e Zonave të Mbrojtura, (online)* [http://akzm.gov.al/qgis2ëeb\\_2019\\_05\\_13-09\\_58\\_25\\_161000/index.html](http://akzm.gov.al/qgis2ëeb_2019_05_13-09_58_25_161000/index.html) [Aksesuar: 27/07/2020]
- Aliaj, Sh., 2004. Seismic source zones in Albania. *Albanian Journal of Natural & Technical Sciences*, Nr. 2, 133-147
- Aliaj, Sh., 2006. The Albania orogen: convergence zone between Eurasia and the Adria Microplate, in N. Pinter et al., (eds.), *The Adria Microplate: GPS Geodesy, tectonics and hazards*, 133-149.
- Aliaj, Sh., Sulstarova, E., Muço, B., Koçiu, S., 2000. Seismotectonic Map of Albania in scale 1:500.000. Seismological Institute Tirana
- Aliaj, Sh., Adams, J., Halchuk, S., Sulstarova., E., Peçi, V. and Muço, B., 2004. Probabilistic seismic hazard maps for Albania. *13th World Conference on Earthquake Engineering. Vancouver, Canada, August 1-6, 2004, Paper NO 2469*.
- Aliaj, Sh., Koçiu, S., Muço, B., Sulstarova, E., 2010. Seismicity, Seismotectonics and Seismic Hazard Assessment in Albania. Publication of Academy of Sciences of Albania. Tirana, 2010.
- Aliaj, Sh., 2012. Neotektonika e Shqipërisë. Shtypshkronja KLEAN Tirane.
- Altea & Geostudio 2000, (2002). The geological, engineering and geotechnical survey for the Milot - Lezha Road. Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2004). The geological, engineering and geotechnical survey for Lezha Bridges, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2005) The geological, engineering and geotechnical survey for Milot-Rreshen Road, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2007) The geological, engineering and geotechnical survey for Lezhe- Shkoder- Hani Hotit Road, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2009) The geological engineering survey for the new electrical line 400 kV from Monrenegro up to Tirana, performed by "Altea & Geostudio 2000" for the company "Dalekovod", Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2020). The geological, engineering and geotechnical survey for the railway from Vora up to Hani Hotit, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Bashkia Lezhë, UTS-01, (2016) Plani i Përgjithshëm Vendor, Lezhë: Bashkia Lezhë*
- Bashkia Lezhë, UTS-01, (2016b) Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit të Përgjithshëm Vendor, Lezhë: Bashkia Lezhë*
- Bashkia Lezhë, 2018. Plani i Emergjencave Civile, Lezhë: Bashkia Lezhë.*
- Bashkia Lezhë, 2019. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis të Bashkisë së Lezhës, Lezhë: Bashkia Lezhë
- Charleston A., (2008), "Seismic Design for Architects". Elsevier Ltd Jordan Hill, Oxford
- Davoudi, S., 2019. *Resilience, Uncertainty, and Adaptive Planning. Annual Review of Territorial Governance in the Eastern Balkans, 1(1), pp. 120-128.*
- Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance, Part 1: General rules, seismic actions and rules for buildings. *CEN 2003*
- Guri M. (2015) "Kërkime mbi teknika bashkekohore për forcimin e ndërtesave me murature". PhD thesis
- Informal Meeting of EU Ministers Responsible for Urban Matter, 2016. The EU Urban Agenda Pact of Amsterdam, Amsterdam: European Union.*

- INSTAT, 2011. Censusi i Popullsisë dhe Banesave, Tiranë: INSTAT
- INSTAT, 2014. Popullsia dhe Dinamikat e Saj, Horizonte të Reja Demografike?, Tiranë: INSTAT
- INSTAT, 2019. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, Tiranë: INSTAT
- Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, 2017. Evidentimi i Rreziqeve Natyrore në Shqipëri, Tiranë: IGJ*
- Instituti i Monumenteve të Kulturës, 2020. Lista e Monumenteve të Kulturës në Shqipëri
- Lancellota, R., 2006. Geotechnical Engineering, Turin: Department of Structural Engineering, Technical University of Turin
- Le Tissier, M. et al., 2013. Identification and Implementation of Adaptation Response Measures in the Drini – Mati River Deltas, Tiranë: UNDP.*
- Look, B., 2006. Handbook of Geotechnical Investigation and Design Tables, Neë York: Taylor & Francis
- Klubi Ekologjik Lezhë, 2018. Buletini mjedisor i Lezhës 2018, Lezhë: Klubi Ekologjik Lezhë.
- Kondi I. (2013) "Perdorimi i fibrave polimere (Fiber reinforced polymer- FRP) per perforcimin dhe pershtatjen sizmike te strukturave beton arme". PhD thesis
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2019. Strategjia e Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit, Tiranë: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2019b. Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2017-2020, Tiranë: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
- Muço, B., 1994. Focal mechanism solutions of earthquakes for the period 1964-1988. *Tectonophysics*, 231.
- Muço, B., Kiratzi, A., Aliaj, Sh., Sulstarova, E., Koçiu, S., Peçi, V., Scordilis, E., 2004. Probabilistic Seismic Hazard Assessment in Albania. *NATO Science for Peace Programme, Final Report about the Project "Seismotectonics and Seismic Hazard Assessment in Albania"*
- Qarku Lezhë, (2018). Plani i Emergjencave Civile, Lezhë: Qarku Lezhë
- RAC-SPA, 1995. Protocol Concerning Special Protected Areas and Biological Diversity in the Mediterranean, Tunis: RAC-SPA.
- Sadigh K., C.-Y. Chang, J.A. Egan, F. Makdisi, and R.R. Youngs (1997). Attenuation relationships for shallow crustal earthquakes based on California strong motion data. *Seismological Letters* 68 (1), 180-189.
- Spudich, P., Joyner, E.B., Lindh, A.G., Boore, D.M., Margaris, B.M. and Fletcher, J.B., 1999. SSEA99: A revised ground motion prediction relation for use in extensional tectonic regimes. *Bulletin of the Seismological Society of America* 89 (5), 1156 -1170.
- Sulstarova, E., Muço, B., Aliaj, S., Kuka, N., & Duni, L. (2003). Tërmetet, Rreziku Sizmik dhe Rreziku Sizmik në Shqipëri. Tiranë: IGJEUM
- Sulstarova E., Muço B., Koçiu S. (2006). Katalogu i tërmeteve të Shqipërisë me  $M_s \geq 4.5$ . Arkivi i Institutit Sizmologjik, Tiranë.
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2017. Studim Gjeologjik për Digat e Rezervuarëve, Tiranë: SHGJSH
- Shkupi, D., Aliaj, Sh., Muço, B. Lleshi, B., Mylius H.G., Toloczyki, M., 2005. The Geohazard Map of Albania, scale 1: 200 000. Tirana 2005
- Toto, R., 2020. Building Resilience for Local Governments in Albania: Legal and Institutional Challenges. MetroPOLIS, Co-PLAN Resilience Series, Policy Paper, 1(1).*
- Toto, R. et al., 2020. Reagimi i Qeverive Vendore ndaj Emergjencës së COVID-19 në Shqipëri: Janar 2020-Prill 2020. MetroPOLIS, Co-PLAN Resilience Series, Policy Paper, 1(3).*
- UN Habitat, 2016. Axbenda e Re Urbane, Tiranë: Shqipëroi: Ministria e Zhvillimit Urban.*
- UNDRR, 2019. Global Assessment Report on Disaster Risk Reduction, Geneva: United Nations Office for Disaster Risk Reduction (UNDRR).*
- UNISDR, 2015. Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015–2030., Geneva: United Nations Office for Disaster Risk Reduction.*

## REFERENCA LIGJORE

### Ligje

Ligj Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”  
 Ligj Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”  
 Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 91/2013, dt 28/02/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”  
 Ligj Nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 9385, dt 4/05/2005, “Për pyjet dhe shërbimin Pyjor”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 9244, dt. 17/06/2004, “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”, i ndryshuar  
 Ligj Nr.24/2017 ”Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”  
 Ligj Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.  
 Ligj Nr. 9290, dt 7.10.2004 “Për Produktet e ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr.9825, datë 1.11.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”  
 Ligj Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficientësinë e Energjisë”, i ndryshuar  
 Ligj Nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”  
 Ligj Nr. 7/2017 “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”,  
 Ligj Nr. 8378, datë 22.7.1998 i Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.10 488  
 Ligj Nr.8102, datë 28.3.1996 Për Kuadrin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura; i azhurnuar me: Ligjin nr.9352, datë 03.03.2005; Ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 (i ndryshuar me ligjin nr.9845, datë 17.12.2007); Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008

### VKM

VKM Nr. 686, 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar  
 VKM Nr. 408, dt 13/05/2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar  
 VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

### Akte Normative

Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore” i miratuar me Ligjin nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”



